

RAPORTI VJETOR 2024

**INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË
SHQIPËRI**



Adresa : Rruga e Saraçëve, “Selvia”; www.iskk.gov.al, e-mail:info@iskk.gov.al

Përmbajtja

I. PASQYRË PËRMBLEDHËSE E AKTIVITETIT TË ISKK GJATË VITIT 2022

i. Misioni.....	3
ii. Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për ISKK.....	4
iii. Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.....	4
iv. Konkluzionet.....	8

II. AKTIVITETET

1. KONFERENCA/ EKSPOZITA/ ËORKSHOP-e

1.1 Konferenca/ ekspozita/ ëorkshop-e/ organizuar nga ISKK.....	00
1.2 Konferenca/ ekspozita/ ëorkshop-e/ në bashkëpunim.....	00
1.3 Pjesëmarrje/ kontribute në konferenca/projekte/aktivitete të kujtesës.....	00

2. STUDIME

2.1 Projekte studimore.....	00
2.2 Projekte studimore/ dokumentare.....	00

3. PROJEKTE

3.1 Projekte informuese-sensibilizuese.....	00
3.2 Projektet dëshmuuese.....	00
3.3 Projekte edukimi.....	00
3.4 Projekte promovuese.....	00

4. BOTIME.....

5. MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI.....

6. PARTNERITETE.....

6.1 Partnerë vendas.....	00
6.2 Partnerë ndërkombëtarë.....	00

III. MENAXHIMI BUXHETOR.....00

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore.....00

2. Gjendja financiare e ISKK për vitin 2022.....00

IV. BORDI DREJTUES

1. Vendime të Bordit Drejtues.....00

V. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN/PROBLEMATIKAT.....00

1. Problematikat.....00

2. Shpërndarja e botimeve.....00

3. ISKK dhe mediat.....00

VI. REKOMANDIME.....00

6.1 Rekomandime për Kuvendin e Shqipërisë.....00

VII. VIZIONI PËR VITIN 2023.....00

i. Misioni

Misioni dhe qëllimi i punës së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit është grumbullimi, studimi, analizimi, evidentimi i fakteve dhe informimi i publikut në lidhje me periudhën komuniste në Shqipëri, në të gjitha aspektet e tij. Sipas nenit 5, të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, i ndryshuar, detyrat e këtij instituti janë:

- a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;
- b) analizon, studion dhe dokumenton krimet e kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit;
- c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;
- ç) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;
- d) studion dhe vlerëson veprimtarinë kriminale të Partisë Komuniste të Shqipërisë, më pas të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera, të krijuara në mbështetje të ideologjisë së saj;
- dh) analizon shkaqet dhe rrugët e vendosjes së regjimit komunist, dokumentet, që vërtetojnë përfshirjen e personave shqiptarë a të huaj, që mbështetën ardhjen e këtij regjimi, si dhe të atyre, të cilët bënë rezistencë kundër këtij regjimi;
- e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;
- ë) evidenton personat, që kanë qenë pjesë e organeve apo autoriteteve vendimmarrëse, përgjegjëse për propagandën komuniste, për aktet administrative dhe vendimet, të cilat kanë çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, në veprime represioni, në jetën shoqërore dhe kulturore, përfshirë luftën e klasave, kolektivizimin, luftën kundër fesë, izolimin nga Perëndimi, pamundësinë për t'u informuar dhe censurën në art, kulturë e shkencë, si dhe kufizimin e furnizimit me ushqime, përmes tallonave të ushqimit;
- f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;
- g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;
- gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;
- h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;

- i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;
- j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri;
- k) bashkëpunon me institucionet homologe të huaja

ii. Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për ISKK, 5 qershor 2024

Më 5 qershor 2024, Kuvendi i Shqipërisë miratoi rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2023”, e cila ishte shoqëruar me 9 rekomandime për punën e ISKK.

Bazuar në këtë rezolutë, Kuvendi i Shqipërisë rekomandoi që ISKK të përmirësonte punën në këto drejtime:

1. *Të prezantojë studimet e kryera para audiencave të ekspertëve, akademikëve dhe aktorëve të ndryshëm të të drejtave të njeriut për të shkëmbyer gjetjet e hulumtimeve mbi periudhën komuniste dhe për nxitjen e debatit shkencor e atij publik mbi këto hulumtime.*
2. *Të konkretizojë bashkëpunimin me Autoritetin për Informimin mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit për pasurimin e databazës me të dhëna statistikore të viktimave të komunizmit në Shqipëri në tria kategoritë: ekzekutim, burgim dhe internim, si dhe t'i bëjë sa më parë të aksesueshme për qytetarët.*
3. *Në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të ofrojë një lidhje të drejtpërdrejtë me historinë e komunizmit nëpërmjet leksioneve ndërvepruese në shkolla, si dhe vizita të të rinjve në vendet e kujtesës (ish-burgje politike, kampe pune, kampe internimi, muze, etj.)*
4. *Në kuadër të transparencës, të publikohen në faqen zyrtare të institucionit vendimet e Këshillit Shkencor, si dhe procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Shkencor dhe Bordit Drejtues.*
5. *Të organizojë konferenca dhe debate publike për trashëgiminë materiale të komunizmit dhe për aspekte të caktuara të saj, si: estetika e ambjentit në përgjithësi, arkitektura, planifikimi urban dhe veprat monumentale.*
6. *Në bashkëpunim me historianë dhe ekspertë të shkencave didaktike të hartojë dhe botojë një udhëzues praktik për mësuesit me orientime didaktike për qasjen ndaj historisë së komunizmit.*
7. *Të inkurajojë një qasje analitike dhe të pavarur ndaj komunizmit tek të rinjtë përmes përfshirjes aktive në projekte krijuese, ekspozita dhe konkurse shkollore.*
8. *Të angazhohet në projekte, bashkëpunime me institucionet homologe jashtë vendit me qëllim përthithjen e eksperiencave më të mira në funksion të veprimtarisë së institucionit.*

9. *Të bashkëpunojë me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për të pasuruar koleksionin e muzeve të ndryshëm në vend me botimet e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit*

iii. Zbatimi i rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për ISKK

Me daljen e rezolutës së Kuvendi i Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2023”, 5 qershor 2024, në institucion nisi angazhimi për zbatimin e saj. Për këtë çështje Drejtori Ekzekutiv ka zhvilluar mbledhje me temë diskutimin e rezolutës, hartimin e një plani pune dhe ndjekjen e ecurisë për zbatimin e tyre në datat 18 qershor, 26 qershor, 31 korrik 2025. Në mbledhjen drejtorëve të datës 8 gusht 2025, u prezantua plani i punës i përfunduar për zbatimin e rekomandimeve. Disa nga rekomandimet kanë rezultate fikse dhe janë plotësuar, disa janë në formë orientimi tematik, të cilat gjenerojnë punë sistematike të orientuar në vazhdimësi.

Rekomandim nr. 1: Të prezantojë studimet e kryera para audiencave të ekspertëve, akademikëve dhe aktorëve të ndryshëm të të drejtave të njeriut për të shkëmbyer gjetjet e hulumtimit mbi periudhën komuniste dhe për nxitjen e debatit shkencor e atij publik mbi këto hulumtime.

Veprimtaria e ISKK gjatë vitit 2024 ka pasur në fokus dhe mendojmë se e ka zbatuar këtë rekomandim me organizimin e disa aktiviteteve:

- Konferencë shkencore ndërkombëtare, organizuar në Tiranë, në datat 13-14 nëntor 2024, me temë “Artet, letërsia dhe propaganda gjatë regjimit komunist”.
- Konferencë shkencore ndërkombëtare e organizuar nga Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit dhe Instituti për Hetimin e Krimeve të Komunizmit dhe Memories së Ekzilit Rumun (IICCMER) në Bukuresht, Rumani, nga datat 3-4 tetor 2024, me temë “35 vite pas rënies së regjimeve komuniste në Evropë”.

Punonjësit shkencorë të ISKK kanë mbajtur 19 kumtesa të mbajtura nëpër konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, 6 artikuj shkencorë. ISKK botoi vitin e kaluar 2 libra studimorë, revistën shkencore të ISKK-s, 3 libra dokumentues dhe 6 libra memuaristikë.

Po ashtu ISKK e ka realizuar këtë rekomandim edhe përmes projekteve të saj me natyrë informuese e sensibilizuese, si promovime librash, shfaqje të dokumentarëve që janë produksione të ISKK-s gjatë viteve, pjesëmarrjes në takimin vjetor të Platformës Europiane të Kujtesës dhe Ndërgjegjes, si dhe bisedat me audiencë studentore dhe akademike. Arkivi audiovizual me dëshmi të ish-të përndjekurve politikë shërbeu si bazë kryesore për realizimin dhe vënien në skenë të dramës dokumentare Lule Sajza, nga Teatri Kombëtar Eksperimental. Më 17 dhjetor 2024, ISKK shfaqti filmin “Revolta që tronditi diktaturën”, prodhim i ISKK, në aktivitetin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut, organizuar në Tiranë, në mjediset e AIDSSH. Filmi trajton ngjarjet e Revoltës së Spaçit e vitit 1973.

Rekomandim nr. 2: Të konkretizojë bashkëpunimin me Autoritetin për Informimin mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit për pasurimin e databazës me të dhëna statistikore të viktimave të komunizmit në Shqipëri në tria kategoritë: ekzekutim, burgim dhe internim, si dhe t'i bëjë sa më parë të aksesueshme për qytetarët.

Realizimi:

Më 27 qershor 2024, ISKK i dërgoi AIDSSH një email zyrtar që e vë në dijeni për përmbajtjen e rekomandimit 2 të Rezolutës së Kuvendit për ISKK. ISKK kërkoi njëkohësisht informacion për draft-marrëveshjen që të dy institucionet kanë nisur të diskutojnë që nga viti 2023. ISKK shprehu gatishmërinë për takim për të diskutuar në lidhje me përmbushjen e rekomandimit të Kuvendit. Pasi nuk morëm përgjigje, i dërguam AIDSSH shkresën nr. prot. 233, 16.09.2024, “ Mbi rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjen”. Shkresa kishte të njëjtën përmbajtje si emaili i datës 27.6.2024.

Takimi u organizua në datën 11 dhjetor 2024 në ambjentet e ISKK. Aty u diskutua që rekomandimet e Kuvendit në lidhje me bashkëpunimin mes ISKK dhe AIDSSH të jenë pjesë e hyrjes dhe e bazës ligjore të marrëveshjes.

ISKK dhe AIDSSH janë prej dy vjetësh në fazën e diskutimit të një draft-marrëveshjes, e cila vonohet për shkak të pengesave që vendos AIDSSH. Draftin fillestar e përgatiti AIDSSH dhe ia dërgoi ISKK, i cili e ktheu me vërejtjet e tij, më 12 janar 2024.

Sipas projekt marrëveshjes së AIDSSH, bashkëpunimi mes dy institucioneve synon organizimin e veprimtarive të përbashkëta, bashkëpunim në fushën e kërkimi shkencor dhe studimeve të përbashkëta, dhe anashkalon qëllimin e krijimit të AIDSSH për të lehtësuar aksesin publik në arkivin e ish-Sigurimit të Shtetit. Po e citojmë të plotë nenin 1 të projekt-marrëveshjes hartuar nga AIDSSH:

“Përmes kësaj marrëveshjeje palët angazhohen në një bashkëpunim afatgjatë me këto objektiva:

- a) Realizimin dhe koordinimin e veprimtarive të përbashkëta sipas përcaktimeve të nenit 4 [ky nen ka procedurat e bashkëpunimit];*
- b) Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në kuadër të kërkimit shkencor, realizimit të studimeve të përbashkëta jo vetëm mbi ish-Sigurimin e Shtetit dhe të periudhës së komunizmit, por edhe mbi persona të historisë së kohës, mbajtës të funksioneve politike, për aq sa bëhet fjalë për informacione që i përkasin rolit të tyre në historinë e kohës dhe ushtrimit të funksioneve, si dhe zbardhjen e krimeve të komunizmit dhe për tematika që lidhen me fushën e veprimtarisë së palëve, nëpërmjet sjelljes së lehtësirave dhe thjeshtimit të procedurave për informimin dhe të aksesimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit në masën dhe për qëllime të parashikuara nga ligji nr. 45/2015, i ndryshuar dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji përkatës organik;*
- c) Bashkëpunim dhe koordinim edhe me kontribut të studiuesve të tretë në veprimtari dhe nisma të ndryshme.”*

Interesi i bashkëpunimit të ISKK me AIDSSH ka të bëjë me aksesin në dokumentet e Sigurimit të Shtetit. Për ISKK kjo duhet të jetë pika kryesore e marrëveshjes dhe jo studimet.

ISKK e ka detyrim ligjor studimin e veprimtarisë së ish-Sigurimit. ISKK është i obliguar nga ligji nr. 10242, datë 25.02.2010, neni 5, pika e, që thotë: *[Instituti] grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist.*”

Ky detyrim ligjor përmbushet me akses të plotë në dokumentet që administrojnë AIDSSH dhe jo me studimet që dëshiron të bëjë AIDSSH, në bashkëpunim ose jo me ISKK.

AIDSSH u kërkon studiuesve të ISKK, kur kërkojnë dokumente, të deklarojnë temën për të cilën ata punojnë. Kjo kërkesë bëhet në injorim të plotë të nenit 55 të Ligjit Nr. 9154, 6.11.2003, “Për arkivat”, i cili thotë: *“Kërkuesi i një dokumenti nuk është i detyruar të paraqesë arsye për t’u lejuar që ta shfrytëzojë atë.”*

ISKK e kupton ngarkesën që puna jonë kërkimore hap për AIDSSH por ne jemi të gatshëm të punojmë vetë, duke mos angazhuar punonjës shtesë të AIDSSH. Ligji për arkivat parashikon dhe vetëshërbim, aty ku është e mundur. Kjo metodë pune parashikohet nga neni 54, pika 3, e Ligjit Nr. 9154, 6.11.2003, “Për arkivat”, i cili thotë: *“Autoriteti arkivor shtetëror, kur është e nevojshme, ofron vetëshërbim.”*

Sa i përket anonimizimit të dokumenteve mund të themi se është një pengesë e tepërt. ISKK është institucion shtetëror, që ka arkivin e tij, ashtu si dhe AIDSSH. Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nuk janë më të kategorisë sekret dhe për rrjedhojë duhet t’i vihen në dispozicion ISKK pa kufizime. Çështja e të dhënave personale, që mbron anonimizimi i dokumenteve, është e zgjidhur nga Kuvendi i Shqipërisë, kur nxori Ligjin Nr. 10242, 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri.” Ky ligj parashikon që ISKK jo vetëm të ketë akses në të dhëna personale, por dhe t’i përdorë ato. Ky ligj parashikon gjithashtu që çdo institucion që ka dokumente, si në rastin e AIDSSH, është i detyruar t’i vendosë ISKK në dispozicion pa vonesë dhe pa pagesë. Po e citojmë të plotë nenin 6 të Ligjit Nr. 10242:

“1. Instituti është i autorizuar të përdorë të dhëna personale, kur është e domosdoshme, për përmbushjen e detyrave, duke garantuar privatësinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Të gjitha strukturat dhe organet shtetërore, njësitë e qeverisjes vendore, organizatat, tërësisht ose pjesërisht buxhetore, organizatat që financohen nga qeverisja vendore, arkivat dhe të gjitha njësitë apo strukturat e tjera, që disponojnë dokumente e materiale arkivore, që i përkasin periudhës së komunizmit dhe që mund t’i shërbejnë realizimit të veprimtarisë së institutit, janë të detyruara t’ia vënë ato në dispozicion dhe t’i ofrojnë institutit asistencën e nevojshme, pa pagesë dhe pa vonesë të pajustificuar. Instituti ka të drejtë të bëjë kopje të dokumenteve dhe të materialeve arkivore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat.”

AIDSSH nuk duhet të vëjë kufizime për ISKK, sepse ISKK është institucion shtetëror dhe nuk mund të paragjykohet si qytetarët e thjeshtë në mbrojtjen e të dhënave personale (sensitive) etj.

Të dhënat personale në ISKK mbrohen si në çdo institucion, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Sa i përket të drejtës së ISKK për të marrë dokumente që përmbajnë të dhëna personale kemi dhënë shpjegime dhe në raportin vjetor të vitit kaluar, në pjesën e titulluar: “Sqarim për çështjen e të dhënave personale.” Aty kemi cituar dhe pjesë nga qëndrimi zyrtar i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shprehur në një mosmarrëveshje të ngjashme mes ISKK dhe Ministrisë së Drejtësisë. Komisioneri është shprehur: *“Transmetimi i të dhënave sensitive për kërkimet shkencore bëhet vetëm kur ekziston një interes i rëndësishëm publik. Të dhënat personale përdoren vetëm nga persona të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Zyra e Komisionerit vlerëson se përhapja e të dhënave drejt ISKK-së është në përputhje me kriterin ligjor për përpunimin e të dhënave....”*

Edhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave shfaqti nuk dha dokumente në disa raste me pretendimin se kishin të dhëna sensitive ose personale, por pas argumentimit të ISKK pranoi argumentet e ISKK, të cilat vërtetohen me shkresën e ISKK për DPA, Nr. prot. 272, datë 12.11.2024, “Kërkesë për përmbushjen e detyrimeve ligjore gjatë shërbimit të dokumenteve të kërkuar nga studiuesit dhe specialistët e ISKK”, dhe nga shkresa e DPA për ISKK, Nr. 11057/2, datë 27.11.2024, “Kthim përgjigje shkresës suaj 272 prot, datë 12.11.2024, mbi kërkesën për përmbushjen e detyrimeve ligjore gjatë shërbimit të dokumenteve të kërkuar nga studiuesit dhe specialistët e ISKK”. DPA konkludon në shkresën e saj se vendosja në dispozicion të ISKK të dokumenteve me të dhëna personale “është në përputhje me kriterin ligjor për përpunimin e të dhënave personale.” Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është organi më i lartë i rrjetit arkivor kombëtar.

Tjetër arsye pse u vonua dakordësimi për një draft përfundimtar të marrëveshjes është se qasja juridike e AIDSSH për këtë marrëveshje ishte e tipit kontraktual, dhe jo e përgjithshme, marrëveshje si frymë bashkëpunimi. Aktualisht ISKK po diskuton së brendëshmi draftin më të fundit të marrëveshjes, që doli në pjesën më të madhe si rezultat i diskutimeve të datës 11 dhjetor, e sjellë me e-mail në ISKK në datën 28 janar 2025.

Pavarësisht problematikave, ISKK ka bashkëpunuar me AIDSSH në simpoziumin “Nga e kaluara në përkujtim –kufijtë e diktatures në vitet 1944-1991”, organizuar në qytetin e Pogradecit më 28 gusht 2024, aktivitet që parashikohet të organizohet edhe në Shkodër në vitin 2025.

Rekomandim nr. 3: Në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të ofrojë një lidhje të drejtpërdrejtë me historinë e komunizmit nëpërmjet leksioneve ndërvepruese në shkolla, si dhe vizita të të rinjve në vendet e kujtesës (ish-burgje politike, kampe pune, kampe internimi, muze, etj.)

Realizimi:

ISKK e ka politikë institucionale punën me të rinjtë. ISKK ka bashkëpunuar me institucionet arsimore, shtetërore dhe private, në projekte dhe aktivitete të ndryshme në fushën e arsimit, dhe ka bashkëpunuar me organizata rinore të shoqërisë civile në aktivitete të larmishme. Pas

firmosjes së marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit (2023) ISKK. Vitin e kaluar, kjo marrëveshje u përfshi si detyrim për zbatim në një udhëzim të Ministrisë së Arsimit. Në Udhëzimin e përbashkët mes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, d.t 13/07/2024, për vitin shkollor 2024-2025, në sistemin arsimor parauniversitar, në Nenin 16, pika “a”, theksohet zbatimi nga Drejtoritë Arsimore i Marrëveshjes së lidhur mes Ministrisë së Arsimit dhe ISKK më 15/02/2023 “Për kordinimin e veprimtarive të përbashkëta institucionale për informimin e nxënësve mbi krimet e komunizimit të kryera në Shqipëri në periudhën 1944-1990”

Si rezultat i marrëveshjes dhe udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, ISKK arriti të organizojë biseda, leksione dhe shfaqje të ekspozitave të saj në 18 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, publike e jo-publike, përfshirë ato në Tiranë, Durrës, Rrëshen, Lezhë, Shkodër, Ballsh e Elbasan, si më poshtë:

1. Hapja e ekspozitës “Fëmijët pas telave me gjemba” në Shkollën 9-vjeçare Mihal Grameno
2. Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën”. dhe e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën Sinan Tafaj
3. Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën 9-vjeçare Faik Konica
4. Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën” në Gjimnazin Faik Konica
5. Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën”. dhe e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në gjimnazin Qemal Stafa
6. Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën”. dhe e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën 9- vjeçare Nënë Tereza Rrëshen
7. Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në gjimnazin Ahmed Dakli Elbasan
8. Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën” dhe bisedë me maturan të gjimnazin “Oso Kuka, Shkodër
9. Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën 9 vjeçare “Xheladin Fishta”, Shkodër
10. Bisedë me fëmijët e shkollës 9-vjeçare "Nënë Tereza", në Rrëshen
11. Bisedë me nxënës në qytetin e Ballshit
12. Ekspozita: “Rrathët e ferit” në Qendrën Kulturore të Bashkisë Mirditë
13. Bisedë me nxënësit e shkollës Ismail Klosi
14. Bisedë me nxënësit e shkollës Dervish Hekali në Ballsh
15. Diskutim me nxënësit e shkollës së mesme jopublike “Ibrahim Kodra”
16. Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën artistike "Jan Kukuzeli"
17. Bisedë në shkollën jo-publike TES mbi Havzi Nelën

Kjo politikë e ISKK do të vazhdojë, në planin vjetor të vitit 2025 janë përfshirë një numër aktivitete me të rinjtë dhe një numër aktivitete në shkolla e arsimit parauniversitar. Në ISKK zhvillojnë praktika studentë nga universitete të ndryshme.

Rekomandim nr. 4:

Në kuadër të transparencës, të publikohen në faqen zyrtare të institucionit vendimet e Këshillit Shkencor, si dhe procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Shkencor dhe Bordit Drejtues.

Si një kërkesë e përsëritur kjo ndër vite po ju informojme se në zbatim të pikës 1, të Nenit 14, të Ligjit Nr.10242, 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” i ndryshuar, shprehimisht thuhet se: “Këshilli Shkencor i institutit është organ këshillimor i bordit të institutit dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, studiues të njohur nga bota akademike dhe shoqëria civile.” Këshilli Shkencor është organ këshillimor pranë pranë Bordit Drejtues dhe jo organ vendimarrës. Këshilli Shkencor nuk merr vendime. Ai jep mendim, kur Bordi Drejtues e shikon të nevojshme. Një procedurë që Këshilli e këshillon Bordin Drejtues vazhdimisht është procesi i botimit. Anëtarët e Këshillit i përcjellin mendimin e tyre Bordit Drejtues lidhur me librat dhe artikujt që ISKK i propozon Bordit çdo vit për botim. Anëtarët e Këshillit Shkencor e përcjellin mendimin e tyre përmes disa formateve standard që ka përgatitur instituti, dhe ata i rekomandojnë Bordit Drejtues botimin ose jo të një materiali të propozuar për botim. Bazuar në këshillat e Këshillit Shkencor, Është Bordi Drejtues ai i cili merr vendim për miratimin ose jo të veprave që i propozohen për botim.

Në kuadër të transparencës dhe në zbatim të rekomandimeve të mëparshme të Kuvendit, ISKK ka të publikuar në faqen zyrtare Vendimet e Bordit Drejtues. Në zbatim të këtij rekomandimi nisur nga data 01.06.2024 në këtë faqe gjenden të publikuar të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të Bordit Drejtues dhe Këshillit Shkencor në linkun e mëposhtëm:

<https://www.iskk.gov.al/programi-i-transparences/>

Rekomandim nr. 5: Të organizojë konferenca dhe debate publike për trashëgiminë materiale të komunizmit dhe për aspekte të caktuara të saj, si: estetika e ambjentit në përgjithësi, arkitektura, planifikimi urban dhe veprat monumentale.

ISKK u dërgoi gjithë bashkive të Republikës një shkresë me nr. prot. 245, datë 23.09.2024, me anë të së cilës kërkonte informacion për trashëgiminë materiale të komunizmit që eksistonte në territorin nën administrimin e tyre.

Informacioni për të cilin ishte interesuar ISKK përfshinte “llojin e veprës, vendodhjen, datën e krijimit, motivacionin e krijimit, vendimin për krijimin e saj.”

Nga 61 bashki që u dërgua kërkesa, kanë kthyer përgjigje 28 prej tyre.

Bashkitë që kanë kthyer përgjigje kanë dhënë informacion monumentet, lapidarët, emrat e rrugëve, institucioneve arsimore dhe joarsimore si dhe foto të ndryshme të tyre.

Bashkitë që nuk kanë dhënë informacion janë:

1. Bashkisë Malësi E Madhe
2. Bashkisë Tiranë
3. Bashkisë Durrës

4. Bashkisë Vlorë
5. Bashkisë Berat
6. Bashkisë Dibër
7. Bashkisë Gjirokastrë
8. Bashkisë Krujë
9. Bashkisë Maliq
10. Bashkisë Kuçovë
11. Bashkisë Divjakë
12. Bashkia Vau-Dejë
13. Bashkisë Shijak
14. Bashkisë Rrogozhinë
15. Bashkisë Dimal
16. Bashkisë Peqin
17. Bashkisë Mat
18. Bashkisë Mirditë
19. Bashkisë Selenicë
20. Bashkisë Gramsh
21. Bashkisë Roskovec
22. Bashkisë Himarë
23. Bashkisë Tropojë
24. Bashkisë Dropull
25. Bashkisë Has
26. Bashkisë Skrapar
27. Bashkisë Tepelenë
28. Bashkisë Pukë
29. Bashkisë Konispol
30. Bashkisë Këlcyrë
31. Bashkisë Fushë-Arrëz
32. Bashkisë Libohovë
33. Bashkisë Pustec

Informacioni i mbledhur do të përpunohet, analizohet për të njohur gjendjen dhe për të vazhduar me plotësimin e mëtejshëm të rekomandimit të Kuvendit me konferenca dhe debate publike. Ju sjellim në vëmendje, se ISKK e ka zhvilluar një konferencë mbi arkitekturën, planifikimin urban dhe veprat monumentale gjatë regjimit komunist në vitin 2022, për të cilën është raportuar me detaje në vitin 2023. Ndërsa në vitin 2024 ISKK organizoi konferencën vjetore me temë “Artet, letërsia dhe propaganda gjatë diktaturës komuniste”, me pjesëmarrjen 24 studiuesve më në zë në fushën e letërsisë dhe historisë së komunizmit shqiptar. Në këtë konferencë pati dhe ligjërata që trajtonin çështjen e verpave të artit.

Rekomandim nr. 6: Në bashkëpunim me historianë dhe ekspertë të shkencave didaktike të hartojë dhe botojë një udhëzues praktik për mësuesit me orientime didaktike për qasjen ndaj historisë së komunizmit.

ISKK ka nisur procesin e shqyrtimit të teksteve shkollore me qëllim njohjen e nivelit të pasqyrit të historisë së diktaturës komuniste në përgjithësi dhe të krimeve të komunizmit në veçanti, për të dalë me rekomandime për pasqyrimin më të plotë të kësaj periudhe historike. Shqyrtimi i teksteve ka nisur të bëhet nga specialistët e ISKK, por në vazhdimësi synojmë të formojmë një grup pune me specialistë dhe nga institucione të tjera për të pasur një qasje sa më të ekuilibruar dhe më gjithëpërfshirëse në aspektin e qasjeve të ndryshme historike. Ky është veç fillimi i një procesi më të gjatë që përfshin dhe përgatitjen e teksteve për historinë e komunizmit që mund të përdoren si lexime plotësuese, por dhe për bashkëpunimin për tekstet shkollore në përmbushje të parashikimeve të pikës j, neni 5, të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojaat e Komunizmit në Shqipëri”.

Rekomandim nr. 7. Të inkurajojë një qasje analitike dhe të pavarur ndaj komunizmit tek të rinjtë përmes përfshirjes aktive në projekte krijuese, ekspozita dhe konkurse shkollore.

Në kuadër të këtij rekomandimi, përveç angazhimit të nxënësve të arsimit parashkollor me anë të bisedave, leksioneve e shfaqjes së ekspozitave të ISKK-s, Sektori i Edukimit u angazhua me shkollat 9-vjeçare të rrethit të Mirditës dhe organizoi ekspozitën Rrathët e ferit, me punimet me rikrijimet artistike të skicave të kampit me tela e gjemba të Tepelenës, me autor Lekë Previzin. Një projekt i tillë nisi vitin e kaluar dhe me Shkollën e Mesme Artistike Jan Kukuzeli në Durrës, i cili do të mbyllet me një ekspozitë të punimeve të nxënësve të arteve figurative të bazuar në historitë e persekutimit gjatë regjimit komunist që janë publikuar nga ISKK në kolanën “Zërat e Kujtesës”. Ekspozita do të hapet gjatë vitit 2025.

ISKK ka përgatitur një numër ekspozitash dhe dokumentarësh, të cilët hapen nëpër shkolla të ndryshme dhe shoqërohen me leksione që trajtojnë në mënyrë analitike historinë e regjimit komunist. Ja disa prej këtyre veprimtarive që u realizuan gjatë vitit 2024:

1. Hapja e ekspozitës “Fëmijët pas telave me gjemba” në Shkollën 9-vjeçare Mihal Grameno
2. Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën” dhe e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën Sinan Tafaj
3. Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën 9-vjeçare Faik Konica
4. Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën” në Gjimnazin Faik Konica
5. Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën”. dhe e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në gjimnazin Qemal Stafa
6. Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën”. dhe e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën 9-vjeçare Nënë Tereza Rrëshen
7. Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në gjimnazin Ahmed Dakli Elbasan

8. Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën” dhe bisedë me maturantë në gjimnazin “Oso Kuka, Shkodër
9. Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën 9 vjeçare “Xheladin Fishta”, Shkodër
10. Ekspozita: “Rrathët e ferrit” në Qendrën Kulturore të Bashkisë Mirditë
11. Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën artistike "Jan Kukuzeli"

Rekomandim nr. 8. Të angazhohet në projekte, bashkëpunime me institucionet homologe jashtë vendit me qëllim përthithjen e eksperiencave më të mira në funksion të veprimtarisë së institucionit.

Gjatë vitit 2024, ISKK ka bashkëpunuar me një numër institucioneve dhe organizatash vendase dhe ndërkombëtare.

ISKK ka shtuar ndjeshëm bashkëpunimin me institucione të huaja. Në vazhde të punës së nisur vitin e kaluar, gjatë vitit 2024 ISKK ka nënshkruar 5 memorandume me institucione ndërkombëtare. Detajet për këto marrëveshje janë dhënë në këtë raport te pjesa me titull: “5. Marrëveshje bashkëpunimi”.

Gjatë vitit 2024 Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit dhe Instituti për Hetimin e Krimeve të Komunizmit dhe Memories së Ekzilit Rumun (IICCMER) organizojnë konferencën e përbashkët ndërkombëtare “35 vite pas rënies së regjimeve komuniste në Evropë”, e cila mbahet në Bukuresht, Rumani, nga datat 3-4 tetor.

Në konferencë morën pjesë studiues dhe historianë nga ish vendet komuniste të Lindjes, ndërsa Shqipëria u përfaqësua nga drejtori ekzekutiv i ISKK, z. Çelo Hoxha, zv. drejtoresha e ISKK znj. Armanda Hysa dhe studiuesja Brisejda Lala. Të ftuar nga ISKK, për të referuar, ishin edhe historianët Prof. As. Enriketa Papa, Departamenti i Historisë, Universiteti i Tiranës, Prof. As. Klejdi Këlliçi, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës dhe Dr. Mentor Beqa, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durres. Në këtë konferencë u shfaq filmi shqiptar “Vdekja e Kalit”, me regji të Saimir Kumbaros, produksion i vitit 1992, si dhe u libri i historianit Uran Butka, “Bomba në ambasadën sovjetike”, përkthyer në gjuhën rumune. Të dy këto produksione u prezantuan nga drejtori ekzekutiv i ISKK, Z. Celo Hoxha. Përkthimi dhe botimi i librit të z. Butka u realizua nga IICCMER në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me ISKK, nënshkruar në vitin 2023.

Në muajin maj 2024 ISKK në bashkëpunim me Ambasadën e Hungarisë në Shqipëri hapën në Tiranë, në mjediset e ambasadës, ekspozitën "European Gulag" shoqëruar me një panel diskutimi me temë “Përballja me diktaturën komuniste,” ku ishin të ftuar, Rajmund Fekete, drejtor i Institutit Kërkimor për Komunizmin në Hungari, Jonila Godole, drejtoreshë e IDMC dhe anëtare e bordit të Platform of European Memory and Conscience (PEMC) dhe Çelo Hoxha, drejtor ekzekutiv i ISKK.

Këtë vit një grup pune i ISKK zhvilloi një vizitë pune në SHBA, më datat 4-9 dhjetor 2024. Grupi përbëhej nga Drejtori Ekzekutiv, Çelo Hoxha; Përgjegjësjë e Sektorit të Kërkimit shkencor, Brisejda Lala, dhe Specialistja e Projekteve Audiovizuale, Juliana Uznova (Kurti). Qëllimi i vizitës ishte nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi me Federatën “Vatra”, me synimin e bashkëpunimit të dy palëve për mbledhjen e dëshmive nga ish-të persektuarve politikë të regjimit komunist që jetojnë në SHBA, dhe bashkëpunimin në aktivitete të tjera, që kanë lidhje me historinë e komunizimit.

ISKK mori pjesë edhe në Konferencën Ndërkombëtare me temë “Krimet e Totalitarizmit- Drejtësia dhe Kujtesa në shek XXI” në kuadër të takimit të përvitshëm të Platformës Europiane të Kujtesës dhe Ndërgjegjes. Në këtë konferencë morrën pjesë shumë studiues të njohur nga vende të ndryshme, të cilët kanë në fokus regjimet totalitare.

Së fundi, në kuadër të Shpalljes së 22 Nëntorit festë kombëtare, ISKK në bashkëpunim me “Muzeun e Alfabetit të gjuhës Shqipe - Manastir” hapi një ekspozitë mbi persekutimin e figurave që organizuan Kongresin nga regjimi Komunist, në qytetin e Manastirit.

Rekomandim nr. 9. Të bashkëpunojë me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për të pasuruar koleksionin e muzeve të ndryshëm në vend me botimet e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.

Në zbatim të këtij rekomandimi, Drejtori Ekzekutiv ka nxjerrë urdhërin Nr. prot. 322, datë 31.12.2024, “Urdhër për shpërndarjen e botimeeve të ISKK në muze”.

Në zbatim të këtij vendimi i është shkruar zyrtarisht Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për të identifikuar në mënyrë zyrtare muzetë dhe për ta vënë në dijeni për përmbajtjen e rekomandimit 9.

iv. Konkluzionet

E ushtruar në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse, veprimtaria e ISKK gjatë vitit 2024 u përqëndrua kryesisht në:

1. Realizimin e një konference shkencore për artin dhe letërsinë e realizmit socialist, e cila kishte qëllim nxjerrjen në pah, përmes një debati shkencor, pasojat e propagandës në arte dhe në letërsi, gjatë regjimit komunist, si dhe për të evindetuar pasojat e kësaj propagande. Disa nga çështjet kryesore që trajtoi kjo konferencë ishin:
 - Vendosja e arteve dhe letërsisë nën kontrollin e regjimit komunist
 - Organizimi strukturor i organeve të kontrollit mbi artet dhe kulturën
 - Objekti, qëllimi dhe misioni i veprimtarisë së organizatave kulturore (Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, etj.)
 - Marrëdhëniet e artistëve dhe shkrimtarëve me regjimin

- E drejta e shprehjes dhe censura
 - Roli i arteve në krijimin e narrativave historike në shërbim të regjimit
 - Kontributi i arteve dhe letërsisë në formimin e njeriut të ri
2. Përkujtimi i ngjarjeve të rëndësishme të qëndresës antikomuniste gjatë regjimit komunist, siç ishte Revolta e të burgosurve politikë në kamp-burgun e Qafë-Barit më 22 maj 1984. Kjo ngjarje u përkujtua me realizimin e disa veprimtarive të ndryshme:
 - Një ekspozitë me dokumente
 - Një vizitë pelegrinazh në Qafë-Bari, me ish-vuajtës të dënimit në atë kamp dhe me studentë të degës Histori të Universitetit të Tiranës
 - Botimin e një libri me kujtime dhe dokumente që tregojnë aspekte të jetës në kamp-burgun e Qafë-Barit, si puna e detyruar, rezistenca e të burgosurve dhe përpjekjet e tyre në kërkim të lirisë (arratisjet), Revolta, etj., dhe informimi i publikut për këto çështje
 3. Informimin e publikut, sidomos brezin e ri, për jetën e fëmijëve në internim dhe në burgje gjatë regjimit komunist, ku mungonin kushtet më minimale të jetesës dhe që binte në kundërshtim me propagandën e kohës dhe konventat ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve; statistika mbi numrin e fëmijëve që jetuan në kampe dhe vende internimi; histori të jetuara etj.
 4. Studimin e jetës së përditshme nën diktaturë, të institucioneve shkencore nën imponimin ideologjik e politik, si dhe mbi ngjarjet e viteve 1990-1991.
 5. Mbledhjen dhe përgatitjen e për botim të ligjeve represive të regjimit komunist, si dëshmi e dhunës së strukturuar shtetërore ndaj qytetarëve.
 6. Prezantimin e punës së ISKK para një audience evropiane duke bashkëpunuar me Platformën Evropiane të Kujtesës dhe Ndërgjegjes, përmes realizimit të projekteve të përbashkëta – ekspozita dhe forume – me partnerët tanë ndërkombëtarë.
 7. Studimin e veprimtarisë së Sigurimit të Shtetit në fillimet e tij, kur kjo strukturë e paligjshme quhej Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit, 1944-1946.
 8. Mbledhjen e dëshmive të ish të dënuarve për arsye politike, botimin e tyre dhe informimin e publikut për jetën në burgje, internim, dënim dhe forma të tjera persekutimi.
 9. Dokumentimin e dhunës së ushtruar ndaj qytetarëve nga Divizioni i Mbrojtjes së Popullit, në periudhën 1947-1949 dhe informimin e publikut për veprimtarinë e kësaj strukture të armatosur të paligjshme, në vijim të vëllimit I, i cili është botuar tashmë dhe mbulon periudhën 1944-1946.
 10. Botimin e artikujve studimorë në lidhje me çështje të jetës së popullsisë shqiptare nën Jugosllavinë komuniste, të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në tekstet shkollore, si dhe mbi aspekte të tjera të regjimit diktatorial komunist.
 11. Rritjen e aksesit publik mbi historinë e komunizmit në Shqipëri, përmes publikimit online të botimeve të ISKK dhe publikimit të aktiviteteve, në faqen zyrtare, në rrjetet sociale dhe media.

12. Rritjen e aksesit publik përmes promovimit të gjërë të veprave të ISKK dhe shpërndarjes së tyre falas në të gjitha bibliotekat e vendit.
13. Zgjerimin e bashkëpunimit me institucione të tjera homologe jashtë vendit përmes aktiviteteve të përbashkëta: forume, konferenca shkencore, etj.
14. Rritjen e efikasitetit të aktivitetit të Institucionit, përmes zgjerimit të bashkëveprimit me institucionet të tjera, universitete apo qendra studimore.
15. Ndërkombëtarizimin e historisë së komunizmit në Shqipëri, përmes botimeve jashtë shtetit, ligjërimit në konferenca ndërkombëtare dhe zgjerimit të rrjetit të aktiviteteve dhe partnerëve ndërkombëtarë.
16. Pasurimin e database-s me të dhëna statistikore dhe cilësore të viktimave të komunizmit në Shqipëri, në të gjitha kategoritë: ekzekutim, burgim, internim, dëbim.
17. Vitin e kaluar ISKK identifikoi numrin total të personave të persekutuar gjatë regjimit komunist në të gjitha kategoritë (vrasje, ekzekutim, burgosje, internim, dëbim), bazuar në të dhënat e Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist, 12 vëllime, botim i ISKK. Kjo shifër është: 46.572 persona. (Kjo shifër mund të jetë më e lartë, sepse dokumentacioni nuk ka qenë në rregull, por deri tani kaq janë mundur të identifikohen).
18. Vitin e kaluar u identifikuan dhe të vrarët nga komunistët gjatë periudhës 1 janar 1942-29 nëntor 1944. Shifra e tyre është 2254 persona. Për tipologjinë e tyre kemi dhënë shpjegime në shkresën për Kuvendin nr. prot. 277, datë 19.11.2024.

Statistika

Viti 2024 ka qenë një vit i mbushur me veprimtari për ISKK. I përkthyer në statistika, është si më poshtë:

- Konferenca shkencore: 1.
- Ekspozita: 3.
- Konferenca/ ekspozita/ workshop-e/ në bashkëpunim – 2:
 - Dy projekte ndërkombëtare:
 - ✓ një konferencë
 - ✓ një ekspozitë.
- Pjesëmarrje e kontribute në aktivitete të kujtesës: 8.
- Pjesëmarrje në takim ndërkombëtar me institucione që veprojnë në fushën e kujtesës: 1.
- Pjesëmarrje në aktivitete të tjera (konferenca/ trajnime/ leksione):
 - ✓ 19 kumtesa.
 - ✓ 8 artikuj shkencorë.
- Projekte studimore: 1.
- Projekte dokumentare/ arkivore: 5
- Projekte informuese/sensibilizuese: 4.
- Projekte dëshmuere: 1.

- Projekte promovuese: 3.
- Botime – 12 tituj:
 - ✓ Studime 2
 - ✓ Revistë shkencore: 1.
 - ✓ Dokumente 5
 - ✓ Kujtime 4
- Biseda dhe veprimtari nëpër shkollat e arsimit parauniversitar: 17
- Memorandume bashkëpunimi me institucione të tjera: 9:
 - ✓ *Memorandume bashkëpunimi me institucione brenda vendit: 3.*
 - ✓ *Memorandume bashkëpunimi ndërkombëtare: 6.*
- Pasqyrimi në media, tituj artikujsh dhe emisione të evidentuar: 32.
- Buxheti është realizuar 92%.
- Ankesa nga publiku: 0
- Raporte dhe rekomandime për institucione të tjera: raporte 2, rekomandime 11.

II. AKTIVITETET

1. KONFERENCA/ EKSPOZITA/ WORKSHOP-e

1.1 Konferenca/ ekspozita/ workshop-e/ dokumentarë/ organizuar nga ISKK

1.1.1

TITULLI I PROJEKTIT	Konferencë shkencore: “Artet, letërsia dhe propaganda gjatë diktaturës komuniste”.
KOHA E REALIZIMIT	13-14 Nëntor 2024
PËRMBAJTJA	Bazuar në planin vjetor të aktivitetit të ISKK për vitin 2024, në datat 13-14 nëntor 2024, u organizua në Tiranë konferenca shkencore me temë “Artet, letërsia dhe propaganda gjatë regjimit komunist”. Konferenca kishte qëllim nxjerrjen në pah, përmes një debati shkencor, pasojat e propagandës në arte, sidomos në letërsi, gjatë regjimit komunist, si dhe për të evindetuar pasojat e kësaj propagande dhe në ditët e sotme. ISKK kishte të ftuar studiues nga fusha të sociologjisë, historisë, studiues letërsie dhe kritikë arti, që e trajtojnë në mënyrë shkencore këto çështje. Nga 26 të ftuar në Konferencë për të paraqitur kumtesat shkencore, nuk u paraqitën për të mbajtur kumtesën vetëm dy prej aplikuesve. Nga

kumtesat e mbajtura 6 (gjashtë) ishin studiues nga stafi i ISKK. Grupi i punës siguroi në kohë organizimin. Konferenca u zhvillua e ndarë në 3 sesione në ditë. Në hapje të konferencës tema u mbajt nga Drejtori i “Conrad Adenauer” në Shqipëri, dr. Thomas Kunze, punimi i të cilit pati edhe përkthimin simultan nga gjermanishtja në shqip. Ndërkohë, tre prej pjesmarrësve i paraqitën punimet e tyre në Zoom (Prof. As. Dr. Lili Sula, dr. Yzedin Hima dhe Msc. Ylli Prebiba).

Nga 6 seanca të konferencës, tre prej tyre u drejtuan nga ekspertët, Enis Sulstarova, Anila Mullahi dhe Mentor Beqa, që u kontaktuan nga ISKK që nga përgatitja dhe kualifikimi i pjesmarrësve e deri në dhënien e përfundimeve të punimeve të konferencës. Ndërsa tre sesione u drejtuan nga stafi i ISKK, Armanda Hysa, Agim Baçi dhe Brisejda Lala. Konkluzionet e konferencës u bënë nga Drejtori Ekzekutiv i ISKK, Çelo Hoxha.

Foto nga konferenca shkencore




1.1.2.

TITULLI I PROJEKTIT	Ekspozita “40 vjet nga revolta e Qafë-Barit”
KOHA E REALIZIMIT	21 – 28. 05. 2024


PËRMBAJTJA	ISKK hapi në ambientet e muzeut "Shtëpia me Gjethe" ekspozitën kushtuar përkujtimit të 40 vjetorit të Revoltës të ish të burgosurve politikë që vuanin dënimin në repartin 311 në Qafë - Bari në Pukë. Ekspozita, e bazuar në dokumente arkivore origjinale, solli fakte të reja mbi historikun e revoltës dhe represionin e ushtruar nga organet e regjimit ndaj të burgosurve politikë. Në hapjen e ekspozitës disa ish të dënuar dhe dëshmitarë të kësaj Revolte rrëfyan momente të kësaj revolte që erdhën si pasojë e dhunës dhe kushteve të rënda të punës me të cilën përballeshin çdo ditë padrejtësisht të burgosurit. Kjo ngjarje pati jehonë të madhe në vend dhe tronditi autoritetet e kohës. Ekspozita u përgatit nga specialistët e Sektorit të Kërkimit Shkencor në ISKK, Dr. Brisejda Lala, Dr.k. Florin Zyberaj, Msc. Leonard Dervishaj. <i>Foto nga ekspozita</i> <u>Baza ligjore:</u> <i>Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 5, neni 15.</i>
GRUPI I PUNËS	Dr. Brisejda Lala, Dr.k. Florin Zyberaj, Msc. Leonard Dervishaj.

1.1.3

TITULLI I PROJEKTIT	Çelja e ekspozitës: “Letra nga ferri”
KOHA E REALIZIMIT	29 Tetor 2024
PËRMBAJTJA	Sektori i Edukimit dhe Komunikimit Publik realizoi ekspozitën “Letra nga ferri”, e cila paraqiti letra të të burgosurve politikë gjatë kohës së vuajtjes së dënimit në burgjet e diktaturës. Ekspozita u ndërtua nëpërmjet tre linjave: 1. Letra fizike origjinale, të të burgosurve drejtuar familjarëve të tyre. 2. Posterë që paraqesin letra protestash dhe anikiminesh të të burgosurve drejtuar instancave të larta të regjimit. 3. Raporte të institucioneve hetimore mbi kushtet dhe gjendjen në burgje. 4. Përpunime audio-vizuale të cilat përftojnë elementë emocionalë mbi jetën në burgjet shqiptare. Ekspozita u hap në mjediset e Piramidës në Tiranë dhe qëndroi në shërbim të publikut tre ditë. Ajo u vizitua nga qytetarë, studiues dhe ish-tëpërdejkur, por edhe grupe studentësh e gjimnazistësh, të cilët u njohën me materiale që i ndeshnin për herë të parë. Ajo pati një jehonë të gjerë në media, duke zënë kronikat e lajmeve të të gjithë televizioneve të rëndësishme të vendit, si dhe një sërë rubrikash special në disa televizione, por edhe në gazeta e portale. Nëpërmjet ekspozimit të materialeve dokumentare të nxjerra nga arkivat shtetërorë, por edhe letra personale të ruajtura nga individë, ky aktivitet paraqiti regjimin komunist nga perspektiva e vuajtjes, ashtu siç është instaluar ajo gjatë kohës së vuajtjes. Ai paraqiti gjithashtu agresivitetin e regjimit si dhe jetën e të burgosurve, reagimet dhe ndjeshmëritë e tyre. Gjithashtu letrat bartin shpesh reagime të guximshme të protagonistëve kundër vetë regjimit dhe komunizmit, çfarë ofron një realitet interesant, të paekspozuar shumë deri tani. Materialet u grumbulluan nga arkivi i shtetit, pas një pune të gjatë kërkimore, si dhe nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me të persekutuar, të cilët kontribuan me letra të ruajtura prej tyre në vite.

	 <i>Foto nga ekspozita</i>
Grupi i punës	Ergys Martiri, Violeta Murati

1.1.4

TITULLI I PROJEKTIT	Hapja e Ekspozitës: "Persekutimi komunist i hartuesve të alfabetit shqip dhe familjarëve".
KOHA E REALIZIMIT	15-22 Nëntor 2024
PËRMBAJTJA	Në kuadër të Shpalljes së 22 Nëntorit ditës së Kongresit të Manastirit, ISKK në bashkëpunim me "Muzeun e Alfabetit të gjuhës Shqipe - Manastir" hapi një ekspozitë mbi persekutimin e figurave që organizuan Kongresin nga regjimi 

	dëshmime, dosjeve hetimore gjyqësore janë ekspozuar për herë të parë për publikun, materiale që tregojnë sesi regjimi nuk kurseu as familjarët e atyre që bënë shtetin dhe kombin shqiptar, çfarë tregon nivelin e kriminalitetit të tij. Ajo pati një mbulim të madh mediatik, për të cilën folën të gjitha televizionet shqiptare në Maqedoninë e Veriut, madje disa prej tyre transmetuan edhe intervista me përfaqësues të ISKK-së. <i>Foto nga ekspozita</i> 
Drejtues Projekti	Dorina Daiu

1.2 Konferenca/ ekspozita/ workshop-e/ në bashkëpunim

1.2.1

TITULLI I PROJEKTIT	Konferenca ndërkombëtare “35 vite pas rënies së regjimeve komuniste në Evropë” (35 years after the fall of communist regimes in Europe), Organizatorë: IICCMER (Instituti për Hetimin e Krimeve të Komunizmit dhe Memories së Ekzilit Rumun) dhe ISKK (Instituti i Studimeve për Krimet dhe
------------------------	---

	Pasojat e Komunizmit) Bukuresht, 3 dhe 4 tetor 2024
PËRMBAJTJA	Përshkrimi i projektit Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit dhe Instituti për Hetimin e Krimeve të Komunizmit dhe Memories së Ekzilit Rumun (IICCMER) organizojnë konferencën e përbashkët ndërkombëtare “35 vite pas rënies së regjimeve komuniste në Evropë”, e cila mbahet në Bukuresht, Rumani, nga datat 3-4 tetor. Në konferencë morën pjesë studiues dhe historianë nga ish vendet komuniste të Lindjes, ndërsa Shqipëria u përfaqësua nga drejtori ekzekutiv i ISKK, z. Çelo Hoxha, zv. drejtoresha e ISKK znj. Armanda Hysa dhe studiuesja Brisejda Lala. Të ftuar nga ISKK, për të referuar, ishin edhe historianët Prof. As. Enriketa Papa, Departamenti i Historisë, Universiteti i Tiranës, Prof. As. Klejdi Këllici, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës dhe Dr. Mentor Beqa, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durres. Fjala e hapjes u mbajt nga dy drejtuesit e instituteve respektivë z. Çelo Hoxha dhe z. Florin –Daniel Sandru. Konferencën e përshëndeti edhe ambasadorja e Shqipërisë në Rumani, zj. Enkeleda Mërkuri. Konferenca u zhvillua në pesë sesione: Sesioni 1: Kalimet e paligjshme të kufirit dhe vrasjet në kufi. Bashkëpunimi Ndërkombëtar për ndjekjen penale të autorëve; Sesioni 2: Hapat drejt fundit të regjimeve komuniste. Procesi i Helsinkit dhe aktivizmi Për Të Drejtat e Njeriut; Sesioni 3: Revolucioni(et) dhe rënia e shteteve federale. Sesioni 4: Post-komunizmi (2): Drejtësia Tranzicionale, njohja publike dhe dëmshpërblimet Sesioni 5: Post-komunizmi (1): Tranzicioni, Muzetë dhe Memorialet. Në mbyllje të konferencës u shfaq filmi shqiptar “Vdekja e Kalit”, me regji të Saimir Kumbaros, produksion i vitit 1992, si dhe u libri i historianit Uran Butka, “Bomba në ambasadën sovjetike”, përkthyer në gjuhën rumune. ISKK dhe IICCMER prej një viti organizojnë aktiviteve të përbashkëta, sipas një marrëveshjeje dypalëshe të nënshkruar në tetor 2023. Në këtë hark kohor janë kryer disa takime, organizuar konferenca, si dhe janë këmbyer vizita mes dy vendeve. Në tetor 2023, një delegacion nga IICCMER, kryesuar nga presidenti Daniel- Florin Sandru morën pjesë në forumin e organizuar nga ISKK, “Përballja me të shkuarën komuniste dhe politikën e kujtesës sot - ndërmjet kërkimit dhe politikë-bërjes”.



Thursday, October 3rd

9.30 - 10.00

Opening Remarks:

Dragos Mihai Hotea, State Secretary, Romanian Government
 H.E. Enkelelda Mërkuri, Ambassador of the Republic of Albania in Romania
 Çelo Hoxha, Executive director of the Institute for the Studies of Communist Crimes and Consequences in Albania
 Florin-Daniel Sandru, Executive president of the Institute for the Investigation of Communist Crimes and the Memory of the Romanian Exile

10.00 - 11.40

Session 1: Illegal Border Crossings and Killings on the Border: International Cooperation for the Prosecution of Perpetrators
Chair: Dalia Báthory

Kamil Nedvedický, Deputy director, The Institute for the Study of Totalitarian Regimes, Czech Republic: *Victims of the Iron Curtain in a Wider Context*
 Armanda Hyse, Deputy director, Institute for the Study of Communist Crimes and Consequences, Albania: *A Discussion on Prohibited Migration in Communist Albania*
 Gerhard Salter, Head of Department, Berlin Wall Foundation, Germany: *The GDR Border Regime, the Death Cases and the Border Soldiers: Criminal Prosecution after 1989 and its Legal Challenges*
 Luciana Jinga, Researcher, the Institute for the Investigation of Communist Crimes and the Memory of the Romanian Exile, *Romanian Killings on Romanian Border during Communism*

Chris Law, PhD student, Newcastle University/Berlin Wall Foundation: *Oral Histories of the CD/7 Border Regime: Reflections, Perspectives, and Challenges in Reunited Germany*

11.40 - 12.00: Coffee break

12.00 - 13.30

Session 2: Steps towards the End of the Communist Regimes: The Helsinki Process and Human Rights Activism
Chair: Luciana Jinga

Çelo Hoxha, Executive director of the Institute for Studies of Crimes and Consequences of Communism in Albania: *Albania: The Fall of the Communist Regime in Albania: Causes, Events and Paradoxical Protagonists*
Brisejda Lala, Researcher, Institute for the Studies of Communism: *Crimes and Consequences in Albania, Albania: The International Pressure towards the Violation of Human Rights in Albania*
Mioara Anton, Director, The Nicolae Iorga Institute of History - The Romanian Academy, Romania: *The Crisis of the Ceaușescu Regime in the 1980s: Human Rights in Foreign Office Assessments*
Dalia Băthory, Researcher, Institute for the Investigation of Communist Crimes and the Memory of the Romanian Exile, Romania: *Contestation and Political Prisoners*

13.30 - 15.00: Lunch

15.00 - 17.30

Film Screening:
The Death Of The Horse, Directed by Saimir Kumbard
Albania, 1992
BOOK Presentation:
The Bomb and the Soviet Embassy in Tirana by Ujan Butka (Romanian edition)
Discussions

Friday, October 4th

10.00 - 11.00

Session 3: Revolution(s) and the Fall of Federative States
Chair: Armanda Hysa

Atdhe Hetemi, Executive director at the Institute for Crimes Committed During the War in Kosovo: *Kosovo: The Institute for Crimes Committed During the War in Kosovo: Mission and Objectives*
Peter Jašek, Researcher, The Nation's Memory Institute, Slovakia: *Velvet Revolution in Slovakia and the Fall of Communist Regime, Six Weeks that Changed our History*
Sorin Bocancea, Professor, Petre Andrei University of Iași, Romania: *Civil-Military Dialectics in the Romanian Revolution*

11.00 - 11.15 Coffee Break

11.15 - 12.45

Session 4: Post-communism (2): Transitional Justice, Victimhood, Public Recognition and Compensations
Chair: Çelo Hoxha

Enriketa Pandejmonj (Papa), Professor, Department of History, University of Tirana: *Albania Beyond the Berlin Wall: Memory and Justice in Post-Communist Albania*
Ladislav Kudrna, Director, the Institute for the Study of Totalitarian Regimes, Czech Republic: *Czechs Come to Terms with Communist Past*
Ekaterina Bonecheva, Member of the Committee for Disclosing the Documents and Announcing Affiliation of Bulgarian Citizens to the State Security and Intelligence Services of the Bulgarian National Army, Bulgaria: *State Security and Underground Musical Groups during Communism*

Mentor Beqa, Professor, Aleksander Moisiu University, Albania: *Decommunization and Transitional Justice in Post-Communist Albania and Romania: A Comparative Analysis*

Josef Halla, Researcher & Michal Keim, Head of Department of research and education, The Nation's Memory Institute, Slovakia: *Reconciliation of Grievances or How We Coped with the Totalitarian Past in Slovakia*

12.45 - 14.00 Lunch

14.00 - 15.20

Session 5: Post-communism (II): Transition, Museums and Memorials

Chair: Enriketa Pandejmonj

Klejd Këlliçi, Professor, Faculty of Social Sciences, University of Tirana, Albania: *The Martyr's Cemetery in Tirana as a Site of Controversial Post-Communist Memory*

István Bandi, Researcher, Historical Archives of the Hungarian State Security, Hungary: *A Comparative Analysis of the Romanian and Hungarian Models: CNSAS and ABTL*

Katharina Zeiher, Curator, Deutsches Historisches Museum, Berlin, Germany: *Towards a New Narrative: Divided Germany and the Post-1989 Transformation Period in the Museum's Permanent Exhibition*

Florin-Daniel Șandru, Executive president, the Institute for the Investigation of Communist Crimes and the Memory of the Romanian Exile, Romania: *The Românii Săraci Memorial*

15.20 - 15.30

Concluding Remarks



	 <i>Foto nga konferenca</i> <u>Baza ligjore:</u> <i>Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 5, neni 15.</i>
GRUPI I PUNËS	<u>Grupi i punës:</u>

1.2.2

TITULLI I PROJEKTIT	Ekspozita paneuropiane “European Gulag”
KOHA E REALIZIMIT	10 maj 2024
PËRMBAJTJA	Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri (ISKK) në bashkëpunim me Ambasadën e Hungarisë në Shqipëri hapën në Tiranë, në mjediset e ambasadës, ekspozitën "European Gulag" shoqëruar me

një panel diskutimi me temë “Përballja me diktaturën komuniste,” ku ishin të ftuar, Rajmund Fekete, drejtor i Institutit Kërkimor për Komunizmin në Hungari, Jonila Godole, drejtoreshë e IDMC dhe anëtare e bordit të Platform of European Memory and Conscience (PEMC) dhe Çelo Hoxha, drejtor ekzekutiv i ISKK.

Ekspozita “European Gulag” është realizuar nga organizata Platforma Evropiane e Kujtesës dhe Ndërgjegjes, anëtare të së cilës janë entitete që merren me çështjet e kujtesës dhe të regjimeve totalitare, ku bëjnë pjesë dhe ISKK, IDMC, dhe Instituti Kërkimor për Komunizmin në Hungari. Ekspozita është realizuar me mbështetjen e Fondacionit Kombëtar Polak (Polish National Foundation).

Paneli diskutoi tema të ndryshme me fokus përballjen me të shkuarën. Mesazhi i folësve ishte që komunizmi është ende gjallë në vendet tona dhe në Evropë (z. Fekete), trajtimi me sukses i të shkuarës ka nevojë për bashkëpunim institucional të gjerë (z. Hoxha), dhe puna informuese dhe edukuese me brezin e ri është kyç në parandalimin e regjimeve totalitare (znj. Godole).

Në ekspozitë morën pjesë të ftuar nga trupat diplomatike në Shqipëri dhe institucione të ndryshme shtetërore.





1.3 Pjesëmarrje/ kontribute në konferenca/projekte/aktivitete të kujtesës

1.3.1

TITULLI I PROJEKTIT	Promovimi i librit “Bomba në ambasadën sovjetike” në gjuhën rumune dhe shfaqja e filmit “Vdekja e Kalit”
KOHA E REALIZIMIT	4 tetor 2024
PËRMBAJTJA	Në konferencën ndërkombëtare “35 vjet nga rënia e regjimeve komuniste në Europë” organizuar nga IICCMER dhe ISKK në Bukuresht, më 3 dhe 4 tetor 2024, u shfaq filmi shqiptar “Vdekja e Kalit”, me regji të Saimir Kumbars, produksion i vitit 1992, si dhe u libri i historianit Uran Butka, “Bomba në ambasadën sovjetike”, përkthyer në gjuhën rumune. Të dy këto produksione u prezantuan nga drejtori ekzekutiv i ISKK, Z. Celo Hoxha. Përkthimi dhe botimi i librit të z. Butka u realizua nga IICCMER në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me ISKK, nënshkruar në vitin 2023.





1.3.2

TITULLI I PROJEKTIT	Pelegrinazh përkujtimor në kuadër të 40 – vjetorit të Revoltës së Qafë-Barit
KOHA E REALIZIMIT	22 maj 2024
PËRMBAJTJA	Përshkrimi i projektit Në kuadër të aktiviteteve përkujtimore për 40-vjetorin e Revoltës së Qafë-Barit, si një nga momentet e rezistencës së heronjve anti-diktaturë në kampet e burgjet më famëkeq të punës së detyruar në Shqipërinë komuniste e më gjerë, ISKK organizoi më 22 maj 2024 vizitën pelegrinazh në ngrehinën kamp-burg të Qafë-Barit. ✓ Organizimi i kësaj vizite pati 3 qëllime kryesore: - Të ndihmojë në përcjelljen e kujtesës mbi kampin e Qafë-Barit në përgjithësi, e mbi këtë ngjarje në veçanti - Të kontribuojë në të kuptuarit e thelbit të diktaturës komuniste - Të mediatizojë sa më gjerë jehonën përkujtimore të kësaj ngjarjeje ✓ Zv. Drejtoresha ekzekutive e ISKK, Armanda Hysa, dhe përgjegjësi i

	Sektorit të Edukimit Ergys Martiri, shoqëruan të ftuarit në këtë aktivitet, ku morën pjesë ish-të përndjekur politikë, përfaqësuar nga Shoqata e Ish-të Përndjekurve Politikë Antikomunistë me në krye zotin Et’hem Fejzullari, si dhe studentë të Universitetit të Tiranës. Në fjalën e saj zonja Hysa theksoi rëndësinë që ka Revolta e Qafë-Barit, si reminishencë dhe celebrim i asaj të Spaçit, për historinë e rezistencës antikomuniste. Ajo u përkujtoi, sidomos studentëve të pranishëm, se rruga e gjatë dhe e vështirë që këtë ditë u përshkrua përmes makinave komode, në diktaturë është bërë nga të afërmit e ish të burgosurve politikë në këmbë, në mëshirë të motit dhe të mjeteve të rralla. Zoti Fejzullari tregoi përvojën e tij personale si i internuar që foshnjë dhe foli mbi keqtrajtimin dhe kushtet e vështira jo vetëm në kampet burgje, por edhe në kampet e internimit. Më pas zoti Bedri Blloshmi, ish i dënuar politik, që një pjesë të dënimit e ka kaluar në Qafë-Bar, u tregoi pjesëmarrësve në aktivitetet qelitë, dhomat e izolimit duke u folur për disa nga torturat dhe format më famëkeqe të keqtrajtimin të makinerisë shqypëse të diktaturës komuniste shqiptare ndaj të burgosurve politikë.
	
Grupi i punës	Armanda Hysa, Ergys Martiri, Daniela Runa

1.3.3

TITULLI I PROJEKTIT	Promovimi i librit të Nebil Cikës “Biri i armikut”
---------------------	--

KOHA E REALIZIMIT	13 prill 2024
PËRMBAJTJA	Përshkrimi i projektit ISKK promovoi librin "Biri i Armikut" të gazetarit, publicistit dhe një prej drejtuesve dhe zërave më të fortë antikomunistë, Nebil Çikës. Promovimi u zhvillua në prani të familjarëve, kolegëve dhe miqve të tij në njëvjektorin e largimit të tij nga kjo botë. Drejtori Ekzekutiv i ISKK, Çelo Hoha, duke theksuar veprimtarinë e Nebil Çikës, u shpreh se ai ishte një gur i rëndësishëm në rrugëtimin për të gdhendur të vërtetën e shoqërisë shqiptare në të shkuarën gjatë diktaturës komuniste. Ligjëruesit në takim, Brahim Shima, Roland Bejko, Artan Murrizi dhe Lavdërim Lita, folën për për kontributin e tij në media, politikë dhe në mbështetjen e kauzës së ish të përndjekurve komunistë. Në fund, familjarët e Çikës shprehën falënderimin për ISKK, për organizimin e aktivitetit që ishte njëkohësisht edhe në përkujtim njëvjektorit të largimit të tij nga kjo jetë!  <u>Baza ligjore:</u> <i>Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 5, neni 15.</i>

1.3.4

TITULLI I PROJEKTIT	Aktivitetet për kujtimor kushtuar 22 intelektualëve të ekzekutuar nga regjimi komunist nën akuzën e rreme të hedhjes së bombës në Ambasadën Sovjetike
KOHA E REALIZIMIT	26 shkurt 2026
PËRMBAJTJA	Përshkrimi i projektit ISKK kreu homazhe në monumentin kushtuar 22 intelektualëve të ekzekutuar nga regjimi komunist më 26 shkurt të vitit 1951, nën akuzën e rreme të hedhjes së bombës në Ambasadën Sovjetike, në Varrezat e Dëshmorëve. Në këtë aktivitet folën drejtori ekzekutiv i ISKK, Z. Celo Hoxha, Z. Uran Butka dhe z. Gëzim Peshkëpia, që njëkohësisht është edhe anëtar i Bordit të ISKK. 



1.3.5

TITULLI I PROJEKTIT	Vizitë bashkëpunimi pranë Federatës “Vatra”, NY, SHBA
KOHA E REALIZIMIT	4 – 9 dhjetor 2024
PËRMBAJTJA	Duke u bazuar në planin vjetor të aktiviteteve të ISKK për vitin 2024 një grup pune i ISKK zhvilloi një vizitë pune në SHBA, më datat 4-9 dhjetor 2024. Grupi përbëhej nga Drejtori Ekzekutiv, Çelo Hoxha; Përgjegjësjë e Sektorit të Kërkimit shkencor, Brisejda Lala, dhe Specialistja e Projekteve Audiovizuale, Juliana Uznova (Kurti). Qëllimi i vizitës ishte nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi me Federatën “Vatra”, me synimin e bashkëpunimit të dy palëve për mbledhjen e dëshmive nga ish-të persektuarve politikë të regjimit komunist që jetojnë në SHBA, dhe bashkëpunimin në aktivitete të tjera, që kanë lidhje me historinë e komunizmit. Vizita dhe misioni i saj u krye në zbatim të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë. Kuvendi i rekomandon ISKK, me rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2022”, <i>“të intensifikojë bashkëpunimin me shoqatat vendase dhe të diasporës për mbledhjen e dëshmive që janë jashtë kufijve, si një burim potencial për zgjerimin e arkivës audio-vizuale apo kolanës së botimeve.”</i>

	Marrëveshja u nënshkrua më datë 8 dhjetor 2024, në selinë Vatrës në Nju Jork, mes Drejtorit Ekzekutiv të ISKK-së, Çelo Hoxha, dhe kryetarit të Federatës Vatra, Elmi Berisha. Marrëveshja është depozituar në protokoll me nr. prot. 107/17, datë 10 dhjetor 2024. Palët biseduan për mënyrat e bashkëpunimit. Vatra do të angazhohet në identifikimin e personave për t'u intervistuar dhe t'i ndihmojnë të vendosin kontakt me ISKK- në. Delegacioni i ISKK zhvilloi dhe një vizitë në shkollën shqipe “Gjergj Fishta”, në Long Island në Nju Jork. Nënësve të shkollës iu dhuruan kopje të librit për fëmijë “Kundër rrymës”, një libër bazuar në jetën shkencëtares Sabiha Kasimati, vranë nga regjimi komunist pa gjyq, më 26 shkurt 1951. Vizita e delegacionit të ISKK në SHBA u përcoll nga mediet e diasporës dhe u pasqyrua në rrjetet sociale. 
GRUPI I PUNËS	Çelo Hoxha, Brisejda Lala, Juliana Uznova

1.3.6

TITULLI I PROJEKTIT	Kujtesa si përgjegjësi
KOHA E REALIZIMIT	14 Maj 2024

PËRMBAJTJA	Të martën, 14 Maj 2024, drejtues dhe specialistë të ISKK, morën pjesë në takimin me regjisorin gjerman Thomas Grimm nga Zeitzeugen-TV në Berlin, organizuar nga Fonadacioni Konrad-Adenauer-Stiftung Tiranë, në zyrat e IDMC. Qëllimi i takimit ishte njohja me përvojën gjermane, trajtimin e të shkuarës totalitare si dhe metodat e dokumentimit të historisë bashkëkohore. Tema e takimit ishte "Kujtesa si përgjegjësi". Në takim merrnin pjesë një numër organizatash që merren me trajtimin e të shkuarës gjatë regjimit komunist, si IDMC, ISKK, Kujto, Shoqata e Mësuesve të Historisë, përfaqësues të ish- të përndjekurve politik, etj.. ISKK është institucioni kryesor, publik, në Shqipëri që trajton të shkuarën totalitare dhe mbledh kujtimet e ish-të përndjekurve politikë. Përveç që u njohën me përvojën gjermane, përfaqësuesit e ISKK treguan për përvojën e tyre në mbledhjen e dëshmive. 
GRUPI I PUNËS	Grupi i ISKK përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv, Dr. Çelo Hoxha, Përgjegjësi i Sektorit të Kërkimit Shkencor, Dr. Brisejda Lala, studiuesi DR(c). Florin Zyberaj dhe specialistja për mbledhjen e dëshmive, projekti "Zërat e kujtesës", Juliana Kurti.

1.3.7

TITULLI I PROJEKTIT	Promovimi i librit “Gjyqet e nomeklaturës komuniste”
KOHA E REALIZIMIT	23 shkurt 2024

PËRMBAJTJA	Drejtori Ekzekutiv i ISKK, Çelo Hoxha, mori pjesë në prezantimin e librit “Gjyqet e nomeklaturës komuniste”, botim i IDMC. Libri është përmbledhje dokumentare e vendimeve gjyqësore të dhëna ndaj zyrtarëve të lartë të diktaturës komuniste, në vitet 1993-1996. Mes të dënuarve ishin dhe ish-sekretari i parë i PPSH, Ramiz Alia, dhe e veja e diktatorit Enver Hoxha, Nexhmije Hoxha. Libri është i pajisur me një analizë hyrëse dhe të dhëna statistikore për gjyqet. Libri është përgatitur për botim nga Çelo Hoxha, Jonila Godole dhe Kastriot Dervishi. Në takimin e sotëm z. Hoxha foli për kontekstin juridiko-historik të krimeve të regjimit komunist. Pamje nga prezantimi i librit “Gjyqet e nomeklaturës komuniste”
GRUPI I PUNËS	Çelo Hoxha

1.3.8

TITULLI I	Pjesëmarrje në forumin "Ruajtja e historisë së persekutimit komunist"
-------------------------	---

PROJEKTIT	në Shqipëri - sfidat dhe mundësitë"
KOHA E REALIZIMIT	22 shkurt 2024
PËRMBAJTJA	Drejtori Ekzekutiv z. Çelo Hoxha mori pjesë në forumin "Ruajtja e historisë së persekutimit komunist në Shqipëri - sfidat dhe mundësitë", organizuar nga IDMC, në kuadër të Ditëve të Kujtesës. Z. Hoxha prezantoi, në seancën e dytë, për të pranishmit punën e ISKK në lidhje me mbledhjen e dëshmive të viktimave të regjimit komunist. ISKK ka bërë rreth 200 intervista, që janë rreth 300 orë regjistrime, prej të cilave janë botuar rreth 70 intervista, me një volum prej rreth 3000 faqe, në 9 vëllime, të kolanës Zërat e Kujtesës. Seanca e dytë e forumit u moderua nga historiania B. Lala, përgjegjëse e sektorit të studimeve në ISKK. Në forum morën pjesë shumë studiues të huaj dhe vendas.

	
GRUPI I PUNËS	Çelo Hoxha, Brisejda Lala

1.3.8

TITULLI I PROJEKTIT	Pjesëmarrje në takimin vjetor të PEMC – Platforma Europiane e Memorjes dhe Koshiençës
---------------------	---

KOHA E REALIZIMIT	15 – 17 maj 2024
PËRSHKRIMI	Platforma Europiane e Memories dhe Koshiencës organizoi takimin e përvitshëm të mbledhjes së Këshillit të Anëtarëve të saj në 15-17 Maj 2024, në Vilnius, Lithuani. ISKK, si anëtare e saj, është ftuar të marrë pjesë edhe në Konferencën Ndërkombëtare me temë “Krimet e Totalitarizmit- Drejtësia dhe Kujtesa në shek XXI”. Në këtë konferencë morrën pjesë shumë studiues të njohur nga vende të ndryshme, të cilët kanë në fokus regjimet totalitare. Në ditën e dytë datë 16 Maj, u zhvillua mbledhja e anëtarëve të PEMC, ku u diskutuan ccështje të rëndësishme si zgjedhja e Presidentit të PEMC. Marek Mutor u zgjodh me votim si President i Platformës për një mandate të mëtejshëm. Së dyti u diskutua anëtarësimi i anëtarëve të rinj në Platformë si edhe ndryshime të disa prej amendamenteve të statusit. Në ditën e tretë vizituam Memorialin e Paqes së Tuskulenait, Vilnus si edhe zhvilluam një takim me Drejtorin e Qendrës së Kërkimit të Genocidit dhe Rezistencës në Lituani. Drejtori i kësaj Qendre, Arunas Babnys shprehu dëshirën e nënshkrimit të një marrëveshje me ISKK. Gjatë takimeve edhe përfqësues të Memorialit të Viktimave të Komunizmit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.  Pamje nga një seancë e mbledhjes së PEMC

1.3.9 – Pjesëmarrje në konferenca e simpoziume

Çelo Hoxha

1. Pjesëmarrje në konferencën “Artet, letërsia dhe propaganda gjatë diktaturës komuniste”, organizuar nga ISKK, Tiranë, 13-14 nëntor 2024.
Ligjërata e mbajtur: “Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, ose ndërmarrja shtetërore e prodhimit të organizuar të propagandës në shërbim të regjimit komunist.”
2. Pjesëmarrje në konferencën “35 years after the fall of communist regimes in europe – 35 vite nga rënia e regjimeve komuniste në evropë”, organizuar nga IICCMER dhe ISKK, Bukuresht, 3-5 tetor 2024.
Ligjërata e mbajtur: “The fall of the communist regime in Albania: causes, events and paradoxical protagonists” [Rënia e regjimit komunist Së shqipëri: shkaqet, ngjarjet dhe protagonistët paradoksalë]

Armanda Hysa

1. Pjesëmarrje në Konferencën e 11-të të InASEA-s (International Association of South-East European Anthropology) “IN, OUT AND IN BETEEN.” *TRANSNATIONAL AND INTERNAL MIGRATION IN SOUTHEAST EUROPE – Brenda, jashtë dhe midis. Emigrimi transnacional dhe i brendshëm i Evropës Juglindore organizuar në Prishtinë, më 19-22 shtator 2024, me kumtesën me temë “Escapees, refugees, migrants or defectors? A discussion on prohibited migration in communist Albania – Të arratisur, refugjatë, emigrantë apo dezertorë? Diskutim mbi emigrimin e ndaluar në Shqipërinë Komuniste”.*
2. Pjesëmarrje në Konferencën e 12-të shkencore ndërkombëtare “Ohër-Vodici 2024” “Promotion of the “Soft Poëer”, Culture, Cultural Heritage, Environment, Tourism or other Human Dimension measures for Sustainable and Inter-Cultural Developments” – “Promovimi i “fuqisë së butë”; kultura, trashëgimia kulturore, ambjenti, turizmi dhe përmasa të tjera humane për zhvillime të qëndrueshme ndërkulturore”, Ohër, Maqedonia e Veriut, 17- 19 janar 2024, me kumtesën “On the dark cultural heritage of communist dictatorship in Albania and contemporary memory policies” (Mbi trashëgiminë kulturore të errët të diktaturës komuniste dhe politikat bashkëkohore të kujtesës në Shqipëri)
3. Pjesëmarrje në simpoziumin “Nga e kaluara në përkujtim –kufijtë e diktatures në vitet 1944-1991” (AIDSSH dhe partnerët) me kumtesën *Mbi emigrimin e ndaluar në Shqipërinë Komuniste*
4. Pjesëmarrje në konferencën “35 years after the fall of communist regimes in europe – 35 vite nga rënia e regjimeve komuniste në evropë”, organizuar nga IICCMER dhe ISKK, Bukuresht, 3-5 tetor 2024.
Ligjërata e mbajtur: “A discussion on prohibited migration in communist Albania” [Diskutim mbi emigracionin e ndaluar në Shqipëri].

Agim Baçi

1. Pjesëmarrje në konferencën vjetore të ISKK-s “Artet, letërsia dhe propaganda gjatë diktaturës komuniste” (13-14 nëntor 2024) me kumtesën “Manipulimi dhe propaganda në romanin “Mërgata e qyqeve” të Nasho Jorgaqit.”

Brisejda Lala

- Pjesëmarrje në konferencën “35 years after the fall of communist regimes in europe – 35 vite nga rënia e regjimeve komuniste në evropë”, organizuar nga IICCMER dhe ISKK, Bukuresht, 3-5 tetor 2024.
Ligjërata e mbajtur: “The international pressure towards the violation of human rights in Albania” [Presioni ndërkombëtar për shkeljen e të drejtave të njeriut në Shqipëri].

Leka Ndoja

1. Pjesëmarrje në konferencën vjetore të ISKK-s “Artet, letërsia dhe propaganda gjatë diktaturës komuniste” (13-14 nëntor 2024) me kumtesën “Realizmi socialist dhe kritika shqipe e diasporës.”

Ergys Martini

1. Pjesëmarrje në konferencën vjetore të ISKK-s “Artet, letërsia dhe propaganda gjatë diktaturës komuniste” (13-14 nëntor 2024) me kumtesën “E qeshura totalitare: Vështrim mbi marrëdhënien e pushtetit me humorin gjatë regjimit komunist në Shqipëri.”

Florin Zyberaj

1. Pjesëmarrjen në konferencën ndërkombëtare në UNIEL me temë: “Krijimi i Divizionit të Mbrojtjes së Popullit në Shqipëri: baza ideologjike dhe konteksti politik”, organizuar nga Universiteti i Elbasanit, 10 maj 2024.
2. Pjesëmarrje në konferencën “Çështje të historisë bashkëkohore shqiptare”, më 29 janar 2024, organizuar nga Departamenti i historisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, me temë: “Represioni komunist në Shqipëri, 1944-1946”.
3. Pjesëmarrjen në Konferencën Ndërkombëtare: IX-International European Conference on Interdisciplinary Scientific Research, Janury 19-21, 2024/ Valencia, Spain, me temë: “*The establishment of the repressive system in post-ËËII communist Albania*”.
Pjesëmarrja në konferencë ka qënë në bashkëpunim me specialistin Leonard Dervishi.
Autori i parë është Florin Zyberaj.
4. Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare: VIII International Scientific and Practical Conference «Eorld science priorities», February 08 - 09, 2024, Vienna. Austria, me temë: “State Security (Sigurimi) under the optics of The Albanian public”

5. Pjesëmarrje në konferencën “Dritëhije të regjimit komunist”, më 27. 09. 2024, organizuar nga Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”, me temë: “Roli i Drejtorisë të Mbrojtjes së Popullit në internimet e pasluftës 1945-1946”.

Damiano Aliaj

1. Ligjërime të kumtesës *Koncepti i agjitacionit dhe propagandës: Nga përhapja e ideve tek ndërtimi i botës paralele*, në konferencën e organizuar nga ISKK, “Artet, Letërsia dhe propaganda gjatë diktaturës komuniste”, Nëntor 2024.

Violeta Murati

1. Pjesëmarrje në konferencën vjetore të ISKK-s “Artet, letërsia dhe propaganda gjatë diktaturës komuniste” (13-14 nëntor 2024) me kumtesën “Zyrtarizimi i realizmit socialist: Konferenca e tretë e Lidhjes së Shkrimtarëve 1949”

Leonard Dervishi

1. Pjesëmarrës në International European Conference on Interdisciplinary Research, e zhvilluar në Universitetin e Valencias, në bashkëpunim me Z. F. Zyberaj, me temën “The Establishment of the Repressive System in Post-ËËII Communist Albania”, në 21 janar 2024.
2. Pjesëmarrës në Konferencën e Elbasanit, me temën “Politikat “Staliniste” në Ekonominë Shqiptare Gjatë Regjimit Komunist 1945-1956”, në 10 maj 2024.

1.3.8 – Artikuj shkencorë

Çelo Hoxha

- Artikull shkencor: “Çështje të ligjshmërisë së pushtetit gjatë regjimit komunist në Shqipëri”, revista *memoria* 5-6 (2024), fq. 7-24.
- Artikuj në anglisht, publikuar nga Instituti i Kujtesës Historike të Estonisë, në protalin e tyre: *Communist Dictatorship in Albania (1944-1992)*. Artikulli gjendet në adresën: <https://communistcrimes.org/en/countries/albania>
- Intervistë e botuar nga Instituti i Studimeve të Regjimeve Totalitare të Çekisë: “Kampet e internimit gjatë regjimit komunist në Shqipëri (1944-1991)”, në revistën *Securitas Imperii*, 44, (2024), 83-94.
- Dr. Çelo Hoxha mori pjesë në përgatitjen për botim të projektit historik “Të rënë e Luftës II Botërore”, i cili u realizua me mbështetjen e Universitetit Evropian të Tiranës. Libri është një përpjekje për të zbardhur çështjen e shumë debatuar të të vrarëve gjatë Luftës II Botërore në Shqipëri.
Libri u përgatit nga një grup autorësh: Prof. Dr. Nevila Nika, Dr. Florian Çullhaj, Prof. Asoc. Marenglen Kasmi, Dr. Çelo Hoxha dhe Prof. Asoc. Hasan Bello.

Dr. Hoxha përgatiti kapitullin me temë “Të vrarët nga komunistët, 1 janar 1942-29 nëntor 1944”, fq. 27-36.

Libri u promovua nga Center for Openess and Dialogue (Qendra për Hapje dhe Dialog), pranë Këshillit të Ministrave, me pjesëmarrjen e kryeministrit Edi Rama, më 28 nëntor 2024.




Kopertina e librit



Pamje nga promovimi

Brisejda Lala

- Artikull shkencor, botuar nga nga Instituti i Studimeve të Regjimeve Totalitare të Çekisë: “Kampet e internimit gjatë regjimit komunist në Shqipëri (1944-1991)”, në revistën *Securitas Imperii*, 44, (2024), 60-76.



Kopetina e revistës dhe faqja e

parë

Florin Zyberaj

- Botimi i artikullit shkencor me titull: “Veprimtaria e komisionit qendror për kriminelët e luftës 1944-1945” në Buletinin Shkencor, Seria e shkencave shoqërore dhe edukimit, në Universitetin e Elbasanit (UNIEL), Viti XXV, nr. 58, 2024/1, fq. 205-215. ISSN: 2221-5956.
- Botimin e artikullit shkencor me titull: “Legjislacioni dhe mjetet e dhunës së pushtetit në Shqipërinë e pasluftës 1944-1946”, në revistën *Studime Albanologjike*, 1 (2024): fq. 75-103. ISSN: 2305-3828; ISSN online 2959-9695.
- “*The establishment of the repressive system in post-WWII communist Albania*” [Vendosja e sistemit shtypës në Shqipërinë komuniste pas Luftës II Botërore]. Botuar në:
 - IX-International European Conference on Interdisciplinary Scientific Research, January 19-21, 2024/ Valencia, Spain, Abstract Book, Editors: Assist. Prof. Dr. Sinan Özyurt, Assoc. Prof. Dr. Mehmet Emin Kalg, by IKSAD Publishing House, Issued: 06.02.2024, 263. ISBN: 978-625-367-634-6.
Abstrakti dhe titulli gjenden në adresën:
https://www.eucongress.org/_files/ugd/614b1f_83592efd348b4e8d9bf0ef5202d4ceff.pdf.
 - IX-International European Conference on Interdisciplinary Scientific Research, January 19-21, 2024/ Valencia, Spain, Full Texts Book, Editors: Assoc. Prof. Dr. Jose R. Hernandez-Carrion, Assoc. Prof. Dr. Mehmet Emin Kalg, by IKSAD Publishing House, Issued: 15.02.2024, 831- 839. ISBN: 978-625-367-637-7.
Artikulli i plotë gjendet në adresën:
https://www.eucongress.org/_files/ugd/614b1f_ed38b7f6dedd4f07a35905b39af221b3.pdf.

- “State Security (Sigurimi) under the optics of The Albanian public” [Sigurimi i Shtetit nën optikën e publikut shqiptar], botuar: World science priorities Proceedings of the VIII International Scientific and Practical Conference 08-09 February 2024, Publisher: «World of Conferences», Vienna. Austria 2024, 126-133. ISBN: 978-92-44513-88-0.

Gjendet në adresën:

<https://doi.org/10.5281/zenodo.10668605>; https://conference-w.com/wp-content/uploads/2024/03/AUS_V_0809022024.pdf; <https://zenodo.org/records/10668605>

Damiano Aliaj

- Botim i artikullit *Neni 73*: “Për një analizë të agjitacionit dhe propagandës në Kodin Penal të 1952”, revista *memoria* 5-6 (2024), fq. 55-72.

2. STUDIME

2.1 Projekte studimore/ dokumentare

2.1.1

TITULLI I PROJEKTIT	Përmbledhje dokumentesh: “Roli i divizionit të mbrojtjes së popullit për shuarjen e rezistencës antikomuniste. 1947-1949/dokumente, Vol. II.”
KOHA E REALIZIMIT	Shkurt 2022- Dhjetor 2026
PËRMBAJTJA	Gjatë vitit 2024, është punuar për vëllimin e dytë mbi veprimtarinë e Divizionit të Mbrojtjes së Popullit. Përshkrimi i projektit: Ky volum dokumentar është vijim i volumit të mëparshëm. Studimi fillon me shkrirjen e komandave të qarqeve për mbrojtjen e popullit dhe krijimi i një sërë regjimentesh që kanë funksionuar në vitin 1947-1948. Pra, në vitin 1947, Divizioni i Mbrojtjes së Popullit organizohet në njësi operative me një struktur të re organike sipas urdhërit të datës 17 shkurt 1947 të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, ku Komandat e qarqeve dhe ato të rretheve suprimohen dhe në vend të tyre formohen regjimentet dhe repartet e tjera autonome. Në këtë volum jepen të dhëna shumë të rëndësishme mbi aktivitetin e divizionit në ndjekjen e kundërshtarëve

	politikë që kundërshtonin regjimin komunist. Divizion gjatë ekspeditave ndëshkimore ndaj kundërshtarve të qeverisë, bëri edhe survejime, arrestime, pushkatime pa gjyq, torturime, burgosje të ashtuquajturve «kriminel lufte» etj. Këto bëheshin në kuadrin e zbulimin politik, mbrojtjes së pushtetit të qeverisë, kundërspiunazhin dhe për mbrojtjen e ushtrisë etj. Studimi mbyllet me shkrijen e divizionit në vitin 1949. Përmes dokumenteve AMPB, AQSH, AQFA, ky studim arkivor i nisur gjatë vitit 2022, synon evidentimin e rolit të “Divizionit të Mbrojtjes së popullit”, në ndjekjen dhe eliminimin e elementëve dhe grupeve antikomuniste, kryesisht grupeve të “të arratisurve”, gjatë periudhës 1947-1948. Në mënyrë kronologjike, dokumentohen operacionet e zhvilluara në Dibër, Kukës, Mirditë, Shkodër, Durrës, Elbasan, dhe trajtimi i familjeve dhe popullsisë së këtyre zonave. Ky studim ofron të dhëna të rëndësishme edhe mbi dezertimet në radhët e ushtrisë, si formë pakënaqësie ndaj instalimit përmes forcës i këtij regjimi të ri. <u>Baza ligjore:</u> <i>Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 5, neni 15.</i>
GRUPI I PUNËS	Florin Zyberaj (autor i studimit)

2.1.2

TITULLI I PROJEKTIT	Përmbledhje me dokumente mbi “Gjykatat Ushtarake (1944-1950)”
KOHA E REALIZIMIT	Janar 2023- Dhjetor 2025
PËRMBAJTJA	Përshkrimi i Projektit Studimi mbi gjyqet ushtarake do të ndalet në aspekte të akuzimit dhe dënimit të personave në mënyrë informale nga gjykatat ushtarake dhe speciale të krijuara me urdhër të organeve të pushtetit për dënimin e atyre idnividëve që u akuzuan për krime lufte, tradhëti dhe bashkëpunim me armikun. Gjatë veprimtarisë së

	tyre këto orane vepruan në mënyrë formale dhe informale duke akuzuar dhe përfshirë në listat e tyre shumë kundërshtarë të regjimit diktatorial duke eliminuar çdo lloj forme të komunizmit në vend. Në vitet e para të pasluftës u krijuan komisionet hetuese për krime lufte, të cilat do të përgatishnin dosjet e të akuzuarve. Ky studim ka për synim të hedhë dritë mbi krimet e kryera nga ana e komunistëve duke përdorur argumentin e tradhëtisë ndaj atdheut nëpërmjet ngritjes së gjyqeve ushtarake të cilat morën vendime dhe dënuan me vdekje dhe burgim shumë persona të pafajshëm. Plani: Janar 2023- Dhjetor 2025 Faza I: Mbledhje e dokumentave Janar- Dhjetor 2023 Faza II: Zbardhje e dokumentave Janar- Dhjetor 2024 Faza II: Analiza dhe përfundimi i studimit Janar- Dhjetor 2025 <u>Baza ligjore:</u> <i>Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 5, neni 15.</i>
GRUPI I PUNËS	Brisejda Lala (autore)

2.1.3

TITULLI I PROJEKTIT	Politikat ekonomike të regjimit komunist 1944-1948
KOHA E REALIZIMIT	Janar 2024 - dhjetor 2026
PËRMBAJTJA	Përshkrimi i projektit Me përfundimin e Luftës së II Botërore, do të niste reforma ekonomike nga regjimi komunist shqiptar për të ndërtuar ekonominë e re socialiste, që t'i përgjigjej superstrukturës së re ideologjike. Periudha 1944-1948 do të ishte faza e parë e ndërtimit të ekonomisë së kontrolluar, sipas modelit

	sovjetik, me ndihmën dhe asistencën jugosllave. E propaganduar nga historiografia komuniste shqiptare, si periudha e rindërtimit të vendit, ajo ishte faza ku u hodhën bazat socialiste në ekonomi, e eliminimit të ekonomisë kapitaliste dhe tregut të lirë, e goditjes dhe grabitjes së pronës private nëpërmjet konfiskimit, sekuestrimit, shtetëzimit, kolektivizimit, reformës agrare etj. Tema “<i>Politikat ekonomike të regjimit komunist 1944-1948</i>” do të trajtojë në mënyrë analitike fillimin e hedhjes së bazave socialiste në ekonomi, kuadrin ligjor dhe ideologjik mbi të cilën u ndërtua ekonomia socialiste, goditjen ndaj pronës private, hedhjen e bazave të ekonomisë së komanduar, kolektivizmin dhe kuadrin e marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare në këtë periudhë. <u>Baza ligjore:</u> <i>Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 5, neni 15.</i>
GRUPI I PUNËS	Leonard Dervishi

2.1.4

TITULLI I PROJEKTIT	Projekt kërkimor- shkencor dhe dokumentues “Institucionalizimi i shkencave në Shqipëri në kushtet e represionit politik dhe ideologjik 1945 - 1972”.
KOHA E REALIZIMIT	Faza e parë, viti 2021-22, konsiston në mbledhjen e materialeve arkivore mbi Institutin e Shkencave, deri në krijimin e Akademisë së Shkencave. (Është realizuar) Faza e dytë 2023-2024 konsiston në përpunimin dhe përgatitjen për botim të përmbledhjes së dokumenteve mbi këtë çështje. (Është realizuar dhe vëllimi është botuar në kolanën 2024) Faza e tretë 2024-2026 do të jetë faza e shkrimit dhe botimit të një studimi monografik me temën specifike “Shkrimi i Historisë së Shqipërisë në maketin e vitit 1959 – mes manipulimit dhe ideologjisë”

PËRMBAJTJA	Përshkrimi i projektit Kërkimet arkivore hapin një fushë më të gjerë për të rikonstruktuar strukturat shtypëse dhe kontrolluese shtetërore mbi mendimin dhe shkencën në një dimension makro historik e social, duke dëshmuar se uniformizimi dhe kontrolli shtetëror e politik është shtrirë e degëzuar në përmasa shumë më të gjera dhe në pamje të parë, të padukshme. Qëllimi kryesor Synimi kryesor i këtij projekti është të dëshmojë prmes të dhënave dokumentare se ajo që quajmë rëndom ‘vëmëndje dhe investim shtetëror’ në fushën e shkencave ishte më së shumti kontroll i rreptë ideologjik mbi shkencën dhe represion mbi studiuesit. Pyetje të tjera kërkimore: Cilat ishin pasojat e represionit ideologjik dhe politik mbi vetë produktin shkencor? Cilat ishin arritjet reale shkencore në kohën e marrë në shqyrtim? Sa të lirë ishin studiuesit shqiptarë në komunikim me kolegët dhe literaturën e huaj? Çfarë intensiteti kishin marrëdhëniet me jashtë? <u>Baza ligjore:</u> <i>Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 5, neni 15.</i> Afatet 2025-2026 - përgatitja e monografisë.
GRUPI I PUNËS	Armanda Hysa

2.1.5

TITULLI I PROJEKTIT	“Ligje dhe akte represive gjatë komunizmit në Shqipëri:1945-1990”, vëll. II.
KOHA E	Janar 2021 – Dhjetor 2022. Përfunduar vëllimi i parë në dhjetor 2022.

REALIZIMIT	Janar 2023 – Dhjetor 2024, përfunduar vëllimi II dhe III.
PËRMBAJTJA	Përshkrimi i projektit Ky studim përfshin gjetjen, mbledhjen, radhitjen dhe botimin e akteve ligjore dhe nënligjore represive të krijuara gjatë regjimit komunist, të botuara ose të fshehta. Qëllimi i projektit Botimi i ligjeve represive të krijuara gjatë regjimit komunist dhe informimi i publikut <u>Baza ligjore:</u> <i>Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 5, neni 15.</i>
GRUPI I PUNËS	Leka Ndoja

2.1.6

TITULLI I PROJEKTIT	Projekt arkivor-studimor “Tortura si mekanizëm i dehumanizimit të kundërshtarit politik në Shqipërinë komuniste”
KOHA E REALIZIMIT	Dhjetor 2024
PËRMBAJTJA	Objekti: Kërkimi arkivor dhe mbledhja e çdo informacioni që tregon mekanizmat e dhunës të përdorur nga insitucionet represive të regjimit komunist ndaj kundërshtarëve politikë të tij. Qëllimi: Gjetja, mbledhja, publikimi i dokumenteve që dëshmojnë mekanizmat e dhunës të përdorur nga insitucionet represive të regjimit komunist ndaj kundërshtarëve politikë të tij, dhe informimi i publikut. Përshkrimi i projektit Studimi përfshin periudhën e viteve 1945-1960. Ky studim do të bazohet

	kryesisht në dokumente arkivore të AQSH-së dhe AIDSSH-së, nga literatura dytësore bibliografike, si dhe nga dëshmitë e persekutuarve politikë. Studimi fillon me vendosjen e regjimit komunist, si dhe me spastrimin e vendit nga kundërshtarët politikë. Specifikisht do të trajtohen torturat që janë aplikuar, llojet, si dhe shembuj nga përdorimi i tyre sipas rrethanave. Gjerësisht do të jepen të dhëna edhe për dhunimin e të dënuarve në burgje dhe kampet e ndryshme, fakt ky i pranuar edhe nga vetë Byroja politike. Përgatitje për botim në kolanën 2025. <u>Baza ligjore:</u> <i>Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 5, neni 15.</i>
GRUPI I PUNËS	Brunilda Doçi, Armanda Hysa

3. PROJEKTE

3.1 Projekte informuese-sensibilizuese

3.1.1

TITULLI I PROJEKTIT	Hapje ekspozite në Bibliotekën Kombëtare të qytetit të Lezhës
KOHA E REALIZIMIT	14 Maj 2024
PËRMBAJTJA	ISKK organizoi në Bibliotekën Kombëtare të Lezhës hapjen e ekspozitës “Fëmijët pas telave me gjemba”. Ekpozita u vizitua nga nxënës, mësues të cilët u njohën me përfshirjen e fëmijëve në vendet e vuajtjes së dënimit gjatë regjimit Komunist. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi dhe sensibilizimi i të rinjve me krimet e komunizmit edhe ndaj fëmijëve. Fillimisht ekspozita iu prezantua nxënësve të klasave të VIII-ta dhe të X-ta në

Shkolla “Hydajet Lezha” dhe “nxënësve të klasave IX-ta dhe të X-ta të Shkollës “Gjergj Kastrioti” nga Koordinatorja e Edukimit Znj *Dorina DAIU*, e cila iu përgjigj dhe pyetjeve të hapura të nxënësve.

Ekspozita qëndroi e hapur në ambjentet e Bibliotekës Kombëtare në Lezhë përgjatë gjithë ditës.

ISKK dhuroi për Bibliotekën e shkollës 17 tekste, të natyrës memoristikë, por edhe libra studimorë, revista shkenore si dhe 3 numra të revistët “Memoria”.

Baza ligjore:

Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të nenit 5 të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.



Foto: Pamje nga aktiviteti në bibliotekën e Lezhës

3.1.2

TITULLI I KONFERENCËS	Shfaqje filmi në aktivitetin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut
KOHA E REALIZIMIT	17 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA	ISKK prezantoi në mjediset e AIDSSH, në një aktivitet në bashkëpunim me Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut filmin e realizuar prej saj “Revolta që tronditi diktaturën” i cili trajton ngjarjet e Revoltës së Spaçit e vitit 1973. Të pranishëm ishin të përndjekur politikë, qytetarë, studiues, përfaqësues organizatash shqiptare dhe ndërkombëtare, si dhe përfaqësues të trupit diplomatik në Tiranë. Filmi u prit me mjaft interes, dhe përcolli emocion tek të pranishmit. Pas transmetimit të tij, u fol mbi procesin e zbardhjes dhe dënimit të krimeve të komunizmit dhe vështirësitë e hasura në këtë proces. I pranishëm në këtë aktivitet, ambasadori i BE-së Gonzato përcolli me vëmendje shqetësimet e ngritura nga z. Mërtiri, duke u shprehur i hapur dhe interesuar për të ofruar mbështetjen e tij për eliminimin e pengesave, si dhe për hapjen e rrugës për të përcjellë më shumë të vërtetat mbi të shkuarën komuniste të Shqipërisë.
Pjesëmarrës	 <i>Foto: Pamje nga prezantimi i filmit “Revolta që tronditi diktaturën”</i>

3.1.3

TITULLI I PROJEKTIT	Shfaqja e dramës dokumentare “Lule Sajza”
KOHA E REALIZIMIT	21 mars 2024

PËRMBAJTJA

Teatri Eksperimental solli në skenë dramën dokumentare “Lule Sajza”, një dramatizim i bazuar në dëshmi të ish-të përndjekurve politikë që kanë vuajtur në kampin e internimit të Tepelenës, 1949-1953.

Dëshmitë në të cilat bazohte teatri janë mbledhur nga Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, të cilat iu vunë në dispozicion autorëve të teatrit, si pjesë e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Prej më shumë se një dekadë, ISKK mbledh dëshmitë audiovizuale të të përndjekurve politikë të regjimit komunist, të cilat pastaj transkriptohen dhe botohen si pjesë e projektit “Zërat e Kujtesës”. Deri tani janë botuar 10 vëllime.

Regjisorit të teatrit “Lule Sejza”, Endri Çela, iu krijua mundësia për të konsultuar e përdorur materialin arkivor të ISKK-s, ndërsa ai i dha jetë kësaj vepre dramatike, i dha shpirt dhe frymë “Zërave të kujtesës”.

Shfaqja e teatrit dokumentar “Lule Sejza” u vendos për herë të parë në skenë më 21 mars të këtij viti.



Foto: Poster i filmit “Lule Sajza”



Foto: Pamje nga shfaqja e filimit “Lule Sajza”

3.2 Projektet dëshmuese

3.2.1

TITULLI I PROJEKTIT	Pasurimi i arkivës audiovizuale të dëshmive të ish-persekutuarve politikë
KOHA E REALIZIMIT	Janar - Dhjetor 2024

PËRMBAJTJA	Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 është punuar për realizimin e intervistave me të protagonistë që kanë vuajtur persekutimin gjatë regjimit komunist, si dhe zbardhjen dhe përgatitjen e tyre për procesin e botimit në kolanën “Zërat e Kujtesës. Personat e intervistuar tregojnë kalvarin e vuajtjeve të tyre personale dhe familjarëve të tyre. Intervistat realizohen në formë video-regjistrimesh të cilat bëhen pjesë e Arkivës audio-vizuale të ISKK-, që është një projekt afatgjatë i nisur që në vitin 2012, i cili bazohet në marrjen e dëshmive të të mbijetuarve nga burgjet dhe kampet e diktaturës, dhe që plotëson një pjesë të madhe të informacionit në mungesë të dokumentacionit zyrtar. Ky faktor dhe distanca e gjatë kohore nga ngjarjet, e bëjnë këtë projekt një nga prioritetet e ISKK-së Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 11 intervista të cilat shkojnë në 17 orë filmime. Të intervistuarit janë, Kujtim Kaziu, Bujna Jakova, Ismail Veliu, Erzen Tarelli, Sulejman Kodra, Guri Velçani, Mahir Siqeca, Rajmonda Sata, Lili Hysenbegasi, Luan Llupa, Kujtim Murataj. Përsa i përket transkriptimit për “Zërat e Kujtesës” (vëllimin X) janë realizuar 11 intervista të cilat disa kanë qenë intervista në arkivën e ISKK-së të marra gjatë vitit 2023 dhe disa intervista të marra në vitin 2024 me një kohëzgjatje totale prej 18 orë të cilat janë zbardhur në 130 faqe format A4. Personat e intervistuar të përfshirë në vëllimin X “Zërat e Kujtesës” janë: Arjan Boriçi, Astrit Jegeni, Gëzim Çela, Bujana Jakova, Shkëlqim Abazi, Iljaz Kajo, Elena Çami, Minella Çami, Vasil Orgocka, Ismail Veliu, Lutfi Kelmendi. Përsa i përket përgatitjes për botim “Zërat e Kujtesës” (vëllimin XI) për vitin 2024 janë transkriptuar tre intervista. Personat e intervistuar janë: Erzen Tarelli, Kujtim Kaziu, Guri Velçani. Këto intervista janë realizuar gjatë vitit 2024 dhe zgjasin rreth 5 orë material video të cilat janë zbardhur në 30 faqe format A4. Personat e intervistuar që do të përfshihen në vëllimin XI “Zërat e Kujtesës” janë: Kujtim Kaziu, Stavri Risto, Erzen Tarelli, Sulejman Kodra, Guri Velçani, Mahir Siqeca, Rajmonda Sata, Lili Hysenbegasi, Luan Llupa, Kujtim Murataj, Gjon Sefgjini. Për realizimin e intervistave, ISKK ka zgjeruar gjeografinë e tyre, duke shkuar në një sërë rrethesh, në të cilat është marrë kontakt me të intervistuarit. Ato janë realizuar në rrethe si: Durrës, Berat, Fushë-Krujë, Laç, Shkozë, Lushnjë, Vlorë, Pogradec. Gjithashtu, gjatë vitit 2024 është punuar edhe në drejtim të gjetjes së kontakteve të reja për vijimin e këtij programi në vazhdim. Kështu, janë kontaktuar një sërë personash për tu përfshirë në program për vitin 2025, gjë për të cilën është marrë edhe konfirmim prej tyre. Personat e kontaktuar janë: Ndreka Nikolla (Laç), Bros Sefgjini (Milot), Vitor Deda (Rrëshen), Gjet Kadeli
------------	---

	(Mamurras), Babuç Kurti (Vlorë), Sehavet Çika (Tiranë), Ismet Teli (Tiranë), Haki Hoxhaj, Mit'hat Jaho (Itali), Gjeko Beci (Shkodër), Neshat Bilali (Tiranë), Mislli Çenoaliaj (Vlorë). Pjesë e këtyre video-regjistrimeve janë rrëfimet e hollësishme mbi jetën në internime ku dëshmitë tregojnë jetën e vështirë, diskriminimin si dhe përfshirjen e banorëve të fashatrave në luftën e klasave, duke bërë që, përveç shtetit, edhe vetë banorët të bëheshin pjesë e persekutimit, për shkak të indoktrinimit të thellë me psikozën e armikut. Përveçse e shfytëzueshme nga studjuesit, kjo arkivë po transkriptohet dhe zbardhet gradualisht; deri tani janë botuar 9 volume me dëshmi, si pjesë e kolanës “Zërat e kujtesës”. Ndërkohë, pjesë nga videoregjistrimet, janë planifikuar të shfaqen nëpër shkolla, si pjesë e projekteve tona bashkëpunuese me arsimin. Përdorimi i dëshmive audio-vizuale, është provuar si një mjet i fuqishëm në rritjen e efikasitetit të komunikimit, përmes konkretizimit të historisë, përcjelljes së mesazheve morale, vetë-ndërgjegjësimi dhe memorizimit të historisë. Baza ligjore: <i>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, sipas të cilit ISKK:</i> <i>f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;</i> <i>g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;</i> <i>e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist.</i>
REALIZUES I PROJEKTIT	Juljana Uznova Kurti

3.3 Projekte edukimi

3.3.1

TITULLI I PROJEKTIT	Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në Shkollën 9-vjeçare Mihal Grameno
KOHA E REALIZIMIT	18.04.2024 – 23.04.2024
PËRMBAJTJA	ISKK organizoi në shkollën 9-vjeçare “Mihal Grameno” hapjen e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba”, më 18.04.2024. Ekspozita u vizitua nga nxënës, mësues të cilët u njohën me përfshirjen e fëmijëve në vendet e vuajtjes së dënimit gjatë regjimit Komunist. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi dhe sensibilizimi i të rinjve mbi të shkuarën komuniste dhe krimet e saj të cilat nuk kanë kursyer as fëmijët. Fillimisht ekspozita iu prezantua nxënësve të klasave të 8-ta nga Brisejda Lala, e cila iu përgjigj dhe pyetjeve të hapura të nxënësve. Ekspozita qëndroi e hapur në ambjentet e shkollës në shërbim të nxënësve deri në datë 23.04.2024. ISKK dhuroi për Bibliotekën e shkollës 17 tekste, të natyrës memoristikë, por edhe libra studimorë, revista shkenore si dhe 3 numra të revistët “Memoria”. <u>Baza ligjore:</u> <i>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të nenit 5 te Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.</i>

	 <i>Foto: Pamje nga ekspozita në shkollën Mihal Grameno, Tiranë</i>
REALIZUES PROJEKTI	Brisejda Lala

3.3.2

TITULLI I PROJEKTIT	Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën”. dhe e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën Sinan Tafaj
KOHA E REALIZIMIT	18.04.2024 - 25.04.2024
PËRMBAJTJA	ISKK organizoi në gjimnazin “Sinan Tafaj” hapjen e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” dhe shfaqjen e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën”. Aktivitetet u zhvilluan në dy ditë. Në ditën e parë u hap ekspozita, ndërsa në tjetrën u shfaq filmi dokumentar. <i>Dita e parë ë 23.04.2024</i> Ekpozita u vizitua nga nxënës, mësues të cilët u njohën me përfshirjen e fëmijëve në vendet e vuajtjes së dënimit gjatë regjimit Komunist. Fillimisht ekspozita iu prezantua nxënësve të klasave të XII të cilët e zhvillojnë historinë si lëndë me zgjedhje (60 nxënës). Ajo u prezantua nga Koordinatorja e

	Edukimit Dorina Daiu, e cila iu përgjigj dhe pyetjeve të hapura të nxënësve. Përgjegjësi i sektorit Ergys Mërtiri diskutoi me nxënësit fatin e bashkëmoshatarëve të tyre, vuajtjet dhe të jetuarit në damkën e armikut. <i>Dita e dytë 24.04.2024</i> Koordinatorja e Edukimit Dorina Daiu u prezantoi nxënësve të klasave të XI-ta ekspozitën “Fëmijët pas telave me gjemba”, ndërsa më pas u shfaq filmi dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën”. Pas shfaqjes së filmit, Përgjegjësi i Sektorit të Edukimit Ergys Mërtiri zhvilloi një bashkëbisedim me nxënësit ku foli për Revoltën e Spaçit, mënyrën se si u zhvillua ajo, mesazhin që ajo na përcjell sot dhe nevojën që ka shoqëria për të përkujtuar ngjarje si kjo si dhe në përgjithësi krimet e komunizmit si dhe efektin e regjimit totalitar në ditët e sotme. Ekspozita qëndroi e hapur në ambjentet e shkollës në shërbim të nxënësve për 3 ditë, deri në datë 25.04.2024. ISKK dhuroi për Bibliotekën e shkollës 17 tekste, të natyrës memoristikë, por edhe libra studimorë, revista shkenore si dhe 3 numra të revistët “Memoria”. <u><i>Baza ligjore:</i></u> <i>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të nenit 5 të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.</i> Foto  <i>Foto: Pamje nga aktiviteti</i>
REALIZUES PROJEKTI	Agim Baçi, Ergys Martiri, Dorina Daiu

3.3.3

TITULLI I PROJEKTIT	Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën 9-vjeçare Faik Konica
KOHA E REALIZIMIT	29.04.2024
PËRMBAJTJA	ISKK organizoi në shkollën 9- vjeçare jo publike “Faik Konica” hapjen e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba”. Ekspozita u vizitua nga nxënës, mësues të cilët u njohën me përfshirjen e fëmijëve në vendet e vuajtjes së dënimit gjatë regjimit Komunist. Ekspozita përmban dokumente, ngjarje dhe imazhe që ilustronë vuajtjet e fëmijëve në kampet e e punës dhe ato të internimit. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi dhe sensibilizimi i të rinjve me krimet e komunizmit edhe ndaj fëmijëve. Kjo ekspozitë iu prezantua nxënësve të klasave të IX të cilët sipas kurrikulës së historisë merren me studimin e Historisë së Shqipërisë. Ekspozita u prezantua nga Koordinatorja e Edukimit Dorina Daiu, e cila iu përgjigj dhe pyetjeve të hapura të nxënësve. Përgjegjësi i sektorit Ergys Mërtiri diskutoi me nxënësit fatin që kishin bashkëmoshatarët e tyre, vuajtjet dhe të jetuarit në damkën e regjimit komunist ISKK dhuroi për Bibliotekën e shkollës 17 tekste, të natyrës memoristikë, por edhe libra studimorë, revista shkenore si dhe 3 numra të revistët “Memoria”. <u>Baza ligjore:</u> <i>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të nenit 5 të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.</i>

	 <i>Foto: Pamje nga ekspozita në shkollën e mesme Faik Konica</i>
REALIZUES PROJEKTI	Ergys Martiri, Dorina Daiu

3.3.4

TITULLI I PROJEKTIT	Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën” në Gjimnazin Faik Konica
KOHA E REALIZIMIT	<i>30.04.2024</i>
PËRMBAJTJA	ISKK organizoi në gjimnazin jo publik “Faik Konica” takimin me nxënësit e klasës së XI. Në gjimnazin jo publik “Faik Konica” Tiranë në datë 30.04.2024. Përgjegjësi i Sektorit të Edukimit Ergys Mërtiri shfaqti filmin dokumentar mbi “Revoltën e Spaçit” mbi të cilin u zhvillua edhe një bashkëbisedim me nxënësit e kësaj shkolle ku ai foli për burgjet dhe kampet e komunizmit, duke u ndalur tek Revolta e Spaçit, historinë e saj, mesazhin që ajo përcjell dhe nevoja që ka shoqëria jonë për të përkujtuar këtë ngjarje. ISKK dhuroi për Bibliotekën e shkollës 17 tekste, të natyrës memoristikë, por edhe libra studimorë, revista shkenore si dhe 3 numra të revistët “Memoria”. <u>Baza ligjore:</u> Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të nenit 5 te Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e

	<i>Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.</i> 
REALIZUES PROJEKTI	Ergys Martiri, Dorina Daiu

3.3.5

TITULLI I PROJEKTIT	Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën”. dhe e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në gjimnazin Qemal Stafa
KOHA E REALIZIMIT	10.05.2024
PËRMBAJTJA	ISKK organizoi në gjimnazin “Qemal Stafa” Tiranë hapjen e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” si dhe shfaqjen e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën. Ekpozita u vizitua nga nxënës, mësues të cilët u njohën me përfshirjen e fëmijëve në vendet e vuajtjes së dënimit gjatë regjimit Komunist. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi dhe sensibilizimi i të rinjve me krimet e komunizmit edhe ndaj fëmijëve. Ekspozita iu prezantua nxënësve të klasave të XII-ta nga Koordinatorja e

	Edukimit Dorina Daiu, e cila iu përgjigj dhe pyetjeve të hapura të nxënësve. Gjithashtu, nxënësit patën mundësi të shikonin dhe filmin dokumentar “Revolta që tronditi Diktaturën”, pas shfaqjes së të cilit u zhvillua edhe një bisedë me Përgjegjësin e Sektorit të Edukimit dhe Informimit Publik, Ergys Martiri, i cili foli për Revoltën e Spaçit dhe qendrimin që shoqëria duhet të mbajë ndaj të shkuarës së saj. Ekspozita qëndroi e hapur përgjatë gjithë ditës. ISKK dhuroi për Bibliotekën e shkollës 17 tekste, të natyrës memoristikë, por edhe libra studimorë, revista shkenore si dhe 3 numra të revistët “Memoria”. <u>Baza ligjore:</u> <i>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të nenit 5 të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.</i>  <i>Foto: Pamje nga aktiviteti</i>
REALIZUES PROJEKTI	Ergys Martiri, Dorina Daiu

3.3.6

TITULLI I PROJEKTIT	Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën”. dhe e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën 9- vjeçare
------------------------	---

	Nënë Tereza, Rrëshen
KOHA E REALIZIMIT	09.05.2024
PËRMBAJTJA	ISKK organizoi në shkollën 9-vjeçare “Nënë Tereza” Rrëshen hapjen e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba”. Ekpozita u vizitua nga nxënës, mësues të cilët u njohën me përfshirjen e fëmijëve në vendet e vuajtjes së dënimit gjatë regjimit Komunist. Ekspozita iu prezantua nxënësve të klasave të IX-ta nga Koordinatorja e Edukimit Dorina Daiu, e cila iu përgjigj dhe pyetjeve të hapura të nxënësve. Nxënësit patën mundësi të shikonin dhe filmin dokumentar të Ergys Matiri, “Revolta që tronditi Diktaturën”. Ekspozita qëndroi e hapur përgjatë gjithë ditës. ISKK dhuroi për Bibliotekën e shkollës 17 tekste, të natyrës memoristikë, por edhe libra studimorë, revista shkenore si dhe 3 numra të revistët “Memoria”. <u>Baza ligjore:</u> <i>Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të nenit 5 të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.</i>  <i>Foto: Pamje nga aktiviteti në shkollën Nënë Tereza, Rrëshen</i>
REALIZUES PROJEKTI	Ergys Martiri, Dorina Daiu

TITULLI I PROJEKTIT	Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në gjimnazin Ahmed Dakli Elbasan
KOHA E REALIZIMIT	09.05.2024
PËRMBAJTJA	ISKK organizoi në gjimnazin “Ahmet Dakli” Elbasan hapjen e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba”. Ekspozita u vizitua nga nxënës, mësues të cilët u njohën me përfshirjen e fëmijëve në vendet e vuajtjes së dënimit gjatë regjimit Komunist. Ekspozita iu prezantua nxënësve të klasave të X-ta dhe të XI-ta nga Koordinatorja e Edukimit Dorina Daiu, e cila iu përgjigj dhe pyetjeve të hapura të nxënësve. Ekspozita qëndroi e hapur përgjatë gjithë ditës. ISKK dhuroi për Bibliotekën e shkollës 17 tekste, të natyrës memoristikë, por edhe libra studimorë, revista shkenore si dhe 3 numra të revistët “Memoria”. <u>Baza ligjore:</u> Realizimi i këtij projekti, përputhet me detyrat e ngarkuara ndaj institucionit në bazë të nenit 5 të Ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010, për “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.
REALIZUES PROJEKTI	Dorina Daiu

3.3.8

TITULLI I PROJEKTIT	Shfaqja e filmit dokumentar “Revolta që tronditi diktaturën” dhe bisedë me maturantë në gjimnazin “Oso Kuka, Shkodër
KOHA E REALIZIMIT	22.10.2024

PËRMBAJTJA	ISKK organizoi në Shkodër në një takim me maturanët e gjimnazit "Oso Kuka", ku u fol mbi propagandën dhe krimet e komunizmit, si dhe u shfaq filmi mbi revoltën e Spaçit “Revolta që tronditi diktaturën”. Violeta Murati, specialiste e botimeve në ISKK, diskutoi mbi propagandën gjatë komunizmit, duke shpjeguar sesi përtej saj, jeta e shumë njerëzve ishte zhytur nën frikë dhe terror. Ajo shpejtoi edhe punën e Institutit mbi zbardhjen e të kaluarës duke u ndalur më konkretisht tek librat e kolanës së ISKK-së për vitin 2024 dhe mënyrën sesi këta libra mund të shfrytëzoheshin për procesin mësimor në shkollë. Ergys Martiri, përgjegjës i sektorit të Edukimit në ISKK, prezantoi filmin “Revolta që tronditi diktaturën”, duke folur mbi guximin e atyre që organizuan këtë revoltë përballë një regjimi vrasës si ai i Enver Hoxhës. Ai u ndal gjithashtu në perceptimin e lirisë në kushtet e një burgu si ai i Spaçit si dhe mbi nevojën për përkujtimin e ngjarjeve të tilla në mënyrë që shoqëria të rigjejë sistemin e duhur të vlerave për të mbajtur qendrim ndaj të kaluarës, si dhe për të vlerësuar dhe orientuar drejt të ardhmen. Ai tha se një shoqëri që nuk njeh dhe vlerëson si duhet të shkuarën është e destinuar të mbetet e pa zhvilluar dhe e paafte të kërkojë dhe të gjejë drejtësi, çfarë shpjegon edhe vonesat e mëdha të tranzicionit postkomunist në Shqipëri. Në fund, ISKK i dhuroi bibliotekës së shkollës kolanën e plotë të librave të saj për vitin 2024.
REALIZUES PROJEKTI	Ergys Martiri, Dorina Daiu

3.3.9

TITULLI I PROJEKTIT	Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën 9 vjeçare “Xheladin Fishta”, Shkodër
KOHA E REALIZIMIT	22.10.2024
PËRMBAJTJA	ISKK prezantoi në Shkodër, në shkollën shkollës 9 vjeçare "Xheladin Fishta" ekspozitën “Fëmijet pas telave me gjemba”. Koordinatorja e ISKK për edukimin, Dorina Daiu bisedoi me nxënësit e klasave të VIII-ta, mbi jetën e fëmijëve në diktaturë, ku mjaft bashkëmoshatarë të tyre u diskriminuan dhe bullizuan me një dirigjim nga strukturat e regjimit. Daiu

	u tregoi nxënësve se si bashkëmoshatarë të tyre përballeshin me veçimin nga të tjerët, me diskrimnimin dhe mosvlerësimin, si dhe mungesën e prespektivës, pasi ata ishin të mbuluar nga damka e të konsideruarit fëmijë të armiqve. I pranishëm ishte edhe studiuesi i ISKK, Damian Aliaj, i cili në fjalën e tij theksoi rëndësinë e të kuptuarit të ekspozitës në raport me përgjegjësinë kolektive dhe individuale të çdo veprimi të artikuluar politikisht. Fenomeni historik i diskutuar duhet parë si çështje ekzistenciale në të njëjtën kohë që mësohet si informacion historik-dokumentar. Po ashtu, ai theksoi vazhdimësinë e kohës që lidh ngjarjet e regjimit komunist me pasojat e pandërprera në shoqëri, e që vetëm nëpërmjet punës kërkimore, edukimit dhe vetëdijes qytetare mund të interpretohen në mënyrën e duhur në të ardhmen. Në lidhje me kërkimin e tij specifik mbi agjitacionin dhe propagandën si figurë e veprës penale dhe lirinë e fjalës në kontekstin e regjimit komunist, z. Aliaj shpjegoi rëndësinë e qartësisë juridike në formulimin e secilit ligj dhe mungesën e një kriteri të tillë në vetë nenin mbi agjitacionin dhe propagandën. Pamundësia për të përcaktuar kufizimet e duhura në një nën të tille na zbulon, por edhe shpjegon, ndërthurjen e politikës me juridiken duke e cënuar fjalën e shprehur çdo herë që ndryshon sfondi në të cilin operonte regjimi diktatorial. <i>Foto: Pamje nga ligjërata e studiuesit Damiano Aliaj</i>
REALIZUES PROJEKTI	Dorina Daiu, Damiano Aliaj

3.3.10

TITULLI I PROJEKTIT	Bisedë me fëmijët e shkollës 9-vjeçare "Nënë Tereza", në Rrëshen
KOHA E REALIZIMIT	23.10.2024
PËRMBAJTJA	Drejtori Ekzekutiv i ISKK, Dr. Çelo Hoxha, mbajti një leksion në shkollën 9-vjeçare "Nënë Tereza", në Rrëshen, me temë "Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri, në kontekstin e Luftës së Dytë Botërore." Historiani Hoxha trajtoi në këtë takim me nxënësit e kësaj shkolle tre çështje kyesore: • Ndikimi konfliktit ndërkombëtar në politikën e brendshme shqiptare. • Organizimi politik dhe ushtarak i shqiptarëve, lufta civile • Çlirimi i Shqipërisë: kalimi nga një regjim ushtarak nën një regjim ushtarak më brutal. Në takim morën pjesë edhe mësues historie nga shkollat e tjera të Bashkisë së Mirditës.  <i>Foto: Pamje nga aktiviteti në shkollën Nënë Tereza, Rrëshen</i>
REALIZUES PROJEKTI	Çelo Hoxha, Dorina Daiu

3.3.11

TITULLI I PROJEKTIT	Ekspozita: “Rrathët e ferrit” në Qendrën Kulturore të Bashkisë Mirditë
KOHA E REALIZIMIT	1 Nëntor 2024
PËRMBAJTJA	ISKK, në bashkëpunim me Bashkinë e mirditës hapi ekspozitën "Rrathët e Ferrit" në Qendrën Kulturore të Bashkisë Mirditë! Kjo ekspozitë ishte konceptuar me piktura të fëmijëve të cilët paraqisnin momente nga vuajtjet e të burgosurve në kampet e diktaturës. Punimet e nxënësve ishin nga shkollat nëntëvjeçare "Nënë Tereza" dhe "Pashko Vasa" si dhe gjimnazit të Rrëshenit. Ky aktivitet u realizua në përmbushje të marrëveshjes midis ISKK dhe së Bashkisë së Mirditës. Pikturat e fëmijëve ishin bazuar në librin me të njëjtin titull si ekspozita të një prej të mbijetuarve të ish kampeveve të internimit dhe burgjeve komuniste, Lekë Previzi.  <i>Foto: Pamje nga ekspozita, Rrëshen</i>
REALIZUES PROJEKTI	Dorina Daiu

3.3.12

TITULLI I	
-----------	--

PROJEKTIT	Bisedë me nxënës në qytetin e Ballshit
KOHA E REALIZIMIT	4 Nëntor 2024
PËRMBAJTJA	Përgjegjësja e Sektorit të Kërkimit Shkencor në ISKK, Dr. Brisejda Lala, mbajti një leksion në shkollën “Ismail Klosi”, në qytetin e Ballshit. Dr. Lala foli mbi sistemin e internimit dhe dëbimit në Shqipërinë komuniste. Ajo u ndal në aspekte sociale të jetës në internim, duke ndarë me nxënësit e kësaj shkolle përvoja të shumë fëmijëve që u persekutuan pasi ishin familjarë të kundërshtarëve të regjimit. Dr. Lala përshkroi kampet me tela me gjemba që ekzistuan deri në vitin 1954, si edhe jetesën në vende internimi.  <i>Pamje nga leksion në shkollën Ismail Klosi</i>
REALIZUES PROJEKTI	Dr. Brisejda Lala

3.3.13

TITULLI I PROJEKTIT	Bisedë me nxënësit e shkollës Dervish Hekali në Ballsh
KOHA E	

REALIZIMIT	4 Nëntor 2024
PËRMBAJTJA	Koordinatorja e Edukimit, Dorina Daiu, prezantoi sot përpara nxënësve të Gjimnazit "Dervish Hekali", në Ballsh, filmin "Revolta që tronditi diktaturën", një prodhim I ISKK-së. Gjatë prezantimit, u diskutuan ngjarjet më të rëndësishme të rezistencës shqiptare ndaj regjimit komunist – Revolta e Spaçit. Kjo revoltë ndodhi në Maj të vitit 1973 në burgun famëkeq të Spaçit, ku të burgosurit politikë u ngritën për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për t'i treguar botës padrejtesitë dhe brutalitetin e sistemit. Në këtë kontekst, u shpjegua rëndësia historike e ngjarjes dhe heroizmi i të burgosurve që sakrifkuan shumë për idealet e lirisë dhe drejtësisë. Përmes materialeve, diskutimeve dhe shembujve konkretë, nxënësit debatuan rreth rëndësisë së Lirisë dhe të drejtave njerëzore dhe se si shumë njerëz kanë bërë sakrifica të mëdha për t'i fituar. Ndërkohë, studiuesi Ma. Leonard Dervishi mbajti një leksion lishur me Revoltën e Qafë Barit (22 maj 1984). Në këtë leksion u trajtuan aspekte në lidhje me historikun e Qafë Barit, punën e detyruar dhe shfrytëzimin çnjerëzor të dënuarve për nxjerrjen e mineraleve. Z. Dervishi është një nga autorët e ekspozitës për burgun e Qafë Barit, që ISKK e hapi vitin e kaluar.
	

	 <i>Foto: Pamje nga aktiviteti në shkollën Dervish Hekali</i>
REALIZUES PROJEKTI	Dr(c). Dorina Daiu, Msc, Leonard Dervishi


3.3.14

TITULLI I PROJEKTIT	Diskutim me nxënësit e shkollës së mesme jopublike “Ibrahim Kodra”
KOHA E REALIZIMIT	11 maj 2024
PËRMBAJTJA	Vendosja e regjimit komunist dhe metodat represive të ish Sigurimit, që veptoi fillimisht si Divizion i Mbrojtjes së Popullit, në vitet e para të diktaturës, kanë qenë pjesë e bashkëbisedimit mes studiuesve nga ISKK dhe nxënësve të Shkollës Jo- Publike “Ibrahim Kodra” në Durrës me datë 11 Maj 2024. Përgjegjësjë e Sektorit të Studimit Shkencor, Brisejda Lala bëri një prezantim mbi kristalizimin e grupimeve politike në përfundim të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjen e regjimit komunist në vend. Specialisti i Studimeve, Florin Zyberaj u ndal në veprimtarinë e Divizionit të Mbrojtjes së Popullit dhe represionin e ushtruar nga organet e pushtetit menjëherë pas përfundimit të Luftës. Njohja e brezit të ri me periudhën e komunizmit është një ndër prioritetet e punës së ISKK.

REALIZUES PROJEKTI	Dr. Brisejda Lala, Dr(c). Florin Zyberaj
-----------------------	--

3.3.15

TITULLI I PROJEKTIT	Hapja e ekspozitës “Fëmijet pas telave me gjemba” në shkollën artistike "Jan Kukuzeli"
KOHA E REALIZIMIT	Dhjetor 2024
PËRMBAJTJA	Përgjegjësjë e Sektorit të Kërkimit Shkencor në ISKK, Dr. Brisejda Lala, prezantoi në shkollën artistike "Jan Kukuzeli" në Durrës ekspozitën “Fëmijet pas telave me gjemba”. Dr. Lala foli mbi jetën e fëmijëve në diktaturë, ku mjaft bashkëmoshatarë të tyre u persekutuan nga strukturat e regjimit pasi ata ishin familjarë të kundërshtarëve të regjimit. Kampet me tela me gjemba ekzistuan deri në vitin 1954. Më vonë shumë familje kaluan jetën e tyre në vendet e internimit. Ndërkohë, specialistja e ISKK-së, Juliana Uznova (Kurti) foli mbi përvojën e saj dhe intervistimin e personave që vuajtën gjatë regjimit komunist duke prezantuar edhe vëllimet e botuara nga ISKK, Zërat e Kujtesës. Znj. Uznova ndau me nxënësit e kësaj shkolle vështirësitë e punës së saj dhe emocionet që dëshmitarët ndajnë me të. Falenderojmë stafin dhe nxënësit e shkollës “Jan Kukuzeli” në Durrës për interesin rreth temës dhe angazhimin e tyre në projekte të ardhshme me ISKK- në të cilat do të zhvillohen në vitin në vazhdim.

	 <i>Foto: Pamje nga aktiviteti në shkollën e mesme artistike Jan Kukuzeli, Durrës</i>
REALIZUES PROJEKTI	Dr. Brisejda Lala, Juliana Uznova

3.3.16

TITULLI I	Bisedë në shkollën jo-publike TES mbi Havzi Nelën
------------------	---

PROJEKTIT	
KOHA E REALIZIMIT	7 mars 2024
PËRMBAJTJA	Studiuesi i ISKK, Dr (c). Florin Zyberaj ishte i ftuar tek shkolla “Tomorro’s Education System” për të folur mbi mësuesin Havzi Nela dhe persekutimin e tij nga regjimi komunist. Në fjalën e tij, Zyberaj theksoi se, Havzi Nela dha kontribut të çmuar në sistemin arsimor në edukimin dhe mësimin e fëmijëve. H. Nela punoi si arsimtar në fshatin Klos, Lojme, Shishtavec, Surroj, Krum dhe në Topojan. Gjatë orëve mësimore, Havziu shpesh recitonte poezitë e tij me personifikime të ndryshme. Ai pasqyronte gjendjen e mjerueshme të shqiptarëve nëpërmjet figurave letrare me një mjeshtëri të rrallë. Kontributi i Havzi Nelës në arsim sot përmendet në mënyrë sporadike. Jam i mendimit që ai dha kontributin e tij të padiskutueshëm në arsimimin e fëmijëve në zona me një varfëri e prapambetje të dukshme si në ekonomi ashtu edhe në nivelin arsimor, ku vështirësitë nuk ishin të vogla. Kontributi i Havzi Nelës nuk mund të mohohet asesi edhe në kulturë. Nuk duhet harruar fakti se Havzi Nela në Shishtavec ishte përgjegjës i Shtëpisë së Kulturës. Ai aty ka planifikuar dhe organizimin e aktiviteteve e festivaleve me karakter lokal. Madje, ai edhe vetë i binte fizarmonikës. Kishte zë të ëmbël dhe shpesh, sipas kujtimeve ia merrte vetë këngës. Në kohën kur ishte student në Pedagogjiken e Shkodrës, ishte organizator i aktiviteteve kulturore e artistike. Ishte recitues e këngëtar i talentuar, virtuoz në fyell e çifteli. Veç shkollës, ai ishte i pranishëm në koncerte artistike në qytetin e Shkodrës, në çdo manifestim kulturor, dhe ishte i pëlqyer masivisht nga të pranishmit në sheshet e aktiviteteve, që shpesh kërkonin me ngulmim në skenë “at bylbilin e Kukësit”. I tillë ishte Havzi Nela në Shkodër, e po i tillë edhe në Kukës. Dalja e tij hapur si kundërshtar i reformave të qeverisë komuniste, më 26 prill 1967, shënonn momentin deciziv në përndjekjen dhe dënimin e tij. Në harkun kohor nga viti 1968-1986, vuajti nëpër kampburgje të ndryshme si, në: Tiranë (1968), Elbasan (1968), Vlorë (fundi i vitit 1968 - 26 shtator 1970), Spaç (1970-1975), Rrëshen (1975), Burrel (1976-1979), Ballsh (1980-1983), Qafë-Bari (1983-1986). Në fund u internua në vitin 1986 (u arratisë nga vendvujtja më 13 qershor 1988) në Arrën të rrethit të Kukësit në një barakë, ne mes të pyllit. Kalvari i vuajtjes së Havzi Nelës u mbyll me varjen e tij në litar, më 10 gusht 1988, ora 3:30. Pasi tha fjalën e fundit u bë ekzekutimi.

	 <i>Foto: Pamje nga biseda e studiuesit Dr (c) Florin Zyberaj në shkollën TES</i>
REALIZUES PROJEKTI	Dr(c). Florian Zyberaj

3.4 Projekte promovuese

3.4.1

TITULLI I PROJEKTIT	Promovimi i Kolanës Vjetore të ISKK 2023
KOHA E REALIZIMIT	22 shkurt 2024
PËRMBAJTJA	Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit prezanton Kolanën e re të botuar gjatë vitit 2023. Përveç 10 librave të rinj, spikat vëllimi XII i "Fjalorit Enciklopedik të viktimave të terrorit komunist", i cili është një bazë të dhënash me informacione mbi të persekutuarit në Shqipëri gjatë periudhës së komunizmit. Që nga krijimi deri në fund të vitit 2024, ISKK-ja ka botuar 145 tituj me fokus diktaturën komuniste në Shqipëri. Veprat që u promovuan:

- “Fjalor Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist”, vëllimi 12. Botim i ISKK, me mbështetjen e KAS; prezantoi Dr. Çelo Hoxha.
- “Zërat e Kujtesës” Vol. 9; prezantoi Juliana Kurti.
- “Biri i Armikut”, autor Nebil Çika; prezantoi Dr. Çelo Hoxha.
- “Tregime memuaristike. Rrëfime nga birucat e komunizmit”, autor Autor Mark Alia; prezantoi Violeta Murati.
- “Ne mbijetuan”; prezantoi autori Musa Çapani.
- “25 vjet, 3 muaj, 15 ditë në burgjet komuniste”; autor Urim Elezi; prezantoi e bija, Urjolsa Elezi.
- “Koalicioni Demokratik, opozita e parë shqiptare e pasluftës”, autor Kastriot Dervishi; prezantoi Dr. Armanda Hysa.
- “Koopërativat bujqësore dhe disidenca e fshatarëve (1946-1991)”; prezantoi autori Xhafer Sadiku.
- “Baba Zylfo Turani, Martir i kombit”; prezantoi autori Syrja Xhelaj.
- Revista Shkencore “Memoria” 3-4, 2023; prezantoi Dr. Armanda Hysa.



Foto: pamje nga promovimi i kolanës së botimeve 2023

Baza ligjore:

Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 5, neni 15.

REALIZUES
PROJEKTI

Dr. Brisejda Lala

4. BOTIME

Gjatë vitit 2024, ISKK botoi 12 libra të zhanreve të ndryshme: 2 vepra studimore, 3 përmbledhje dokumentesh, 6 me kujtime nga persona të persekutuar gjatë regjimit komunist ose të afërm të tyre, dhe revista shkencore e ISKK, *memoria*, 5-6, me 9 artikuj.

Vitin e kaluar u përmbyll një nga projektet më të rëndësishme të ISKK në fushën e botime, i titulluar “Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist. Më 2023 u botua vëllimi i tretë i shtesave. Botimi ka 12 vëllime, 4870 faqe në total. Enciklopedia është burimi më i besueshëm për identifikimin e viktimave të komunizmit, sepse është realizuar në përputhje me metodat shkencore. Referuar Fjalorit, në Shqipëri janë persekutuar, në forma të ndryshme – vrasje, ekzekutim, burgosje, internim, dëbim, 46.572 persona. Në *Fjalor* ka disa njësi (emra) që mund të jenë të dubluara, por janë një numër i papërfillshëm. Kjo ka ndodhur për arsye se ka dokumente ku i njëjti person shfaqet me emrin e babait si mbiemër, gjë që ndodhte në traditën shqiptare, dhe në dokumente të tjera është gjetur me mbiemrin e familjes. Aty ku kemi mundur t’i identifikojmë i kemi shmangur këto dublime, por ka raste që janë botuar. Sidoqoftë, kjo është në shifra minimale dhe do të shmanget në variantin *digital*.


Mendojmë që pas plotësimit, në të ardhmen, të ketë një botim tjetër, të plotësuar.

Në vazhdim këto botime prezantohen shoqëruar me të dhëna të detajuara: titull, autor, abstrakt, foto.

4.1. BOTIME

4.1.1

Revista shkencore “Memoria” – nr.5-6, 2024	
Botim i ISKK 2024	
PËRMBAJTJA	Dy numrat revistës studimore “<i>memoria</i>” për vitin 2024 janë botuar së bashku dhe i janë dedikuar kujtesës dhe politikave në regjimin komunist kryesisht në fushën e ligjshmërisë së pushtetit, gjendjen e popullatës shqiptare nën Jugosllavinë komuniste, etj. Revista përmban këto tema: • “Çështje të ligjshmërisë së pushtetit gjatë regjimit komunist në Shqipëri”, me autor Dr. Çelo Hoxha • Odisea e antropologut Jakov Milaj: nga periudha formuese në Shkodër tek përndjekja komuniste, nga Xherardo Nikjari • Padrejtësitë dhe diskriminimi i shqiptarëve të Maqedonisë gjatë

	periudhës së komunizmit (1945-1990), nga Dr. Ali Sadiku • Neni 73/Për një analizë të agjitacionit dhe propagandës në kodin penal të vitit 1952, nga Damiano Aliaj. • Interpretimi i monumentit “Lulja e gurit” dhe ligjërimi publik për kampin e Jasenovacit në Jugosllavinë socialiste, me autor Dr. Inxhi Brisku. • Objektet e kultit ortodoks gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, nga Dr. Thoma Shkira • Ndikimi i Partisë Komuniste të Jugosllavisë në lindjen dhe përhapjen e komunizmit në Shqipëri (1924-1944), nga Xhafer Sadiku • Historia e marrëdhënieve të qeverisë komuniste shqiptare dhe asaj jugosllave në vitet 1945 – 1990, trajtuar në tekstet shkollore, nga Dr. Vojsava Kumbulla • Bashkëpunimi dhe konflikti në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike, nga Dr. Noela Mahmutaj 
--	---

4.1.2

TITULLI	Zërat e kujtesës, vëll X

AUTORI	Përgatiti: Juliana Uznova-Kurti
PËRMBAJTJA	Projekti i ISKK, libri me dëshmi dhe intervista “Zërat e kujtesës”, vëllimi 10, përfshin 11 intervista me: Arjan Boriçi, Astrit Jegeni, Bujana Jakova, Elena Çami, Gëzim Çela, Iljaz Kajo, Ismail Velu, Shkëlqim Abazi, Lutfi Kelmendi, Minella Çami, Vasil Orgocka. 

4.1.3

TITULLI	Historia e internimit në Shqipërinë komuniste 1944-1990: Fëmijët pas telave me gjemba
AUTORI	Brisejda Lala
ABSTRAKTI	Studimi trajton një temë të rëndësishme që përputhet tërësisht me objektivin e studimit të ISKK. Ai jep një kontribut të rëndësishëm për njohjen dhe dokumentimin e krimeve të regjimit komunist. Libri hulumton sistemin e internimeve dhe debimeve, duke përfshirë si legjislacionin edhe praktiken e zbatimit të tij. Behet fjalë për një studim të mirefillt shkencor që ofron analiza dhe fakte mjaft të vlefshme dhe të formuluar kuptueshëm edhe për lexuesit jashtë shkencës. Libri hapet me një parathenie që orienton lexuesin

mbi temen, rendesine, synimet, burimet, metodologjine dhe strukturen e studimit. Autorja meriton nje pergezim te vecante per perfshirjen e te gjitha ketyre pikave dhe formulimin e qarte te pyetjeve studimore, sic i ka hije nje vepre te mirefillte shkencore. Kapitulli “hyrja” sqaron lexuesin me tej mbi aspektet e ndryshme te temes studimore dhe permbajtjes se librit, duke perfshire edhe terminologjine. Kreu 1 ofron nje historik te debimit dhe internimit dhe nder te tjera ofron edhe nje krahasim te vlefshem te ketij ndeshkimi ne periudhen e Zogut dhe ne ate komuniste. Me tej analizohet ne menyre kronologjike legjislacioni dhe praktika e zbatimit te tij. Nje kapitull mjaft interesant dhe i vlefshem eshte “qendrimi ndërkombëtar ndaj shkeljes së të drejtave të individit në Shqipëri”, i cili ofron nje analize impresionuese. Kreu 2 hulumton kushtet e jeteses ne vendet e internimit dhe ne kete kuader evidenton shkeljet e autoriteteve në legjislacionin e kohës. Hulumtimi eshte i miredokumentuar, duke prezantuar fakte te nxjerra nga dokumentet arkivore. Kapitulli “Kategorizimi i kampeve të internimit” prek nje teme shume te rendesishme dhe te komentuar shpesh ne Shqiperi, por rrallehere ne nje forme shkencore. Autorja ofron pikerisht nje analize shkencore te kesaj ceshtjeje duke shfrytezuar edhe literaturen e huaj. Kapitujt “Kampet e internimit me tela me gjemba” dhe “Kampi i Tepelenës në sytë e fëmijëve” shfrytezojne mire edhe burimet gojore, “jetesa në fshatrat e internimit” nderthur ne menyre profesionale te dhenat nga intervistat gojore me ato te nxjerra nga dokumentet arkivore. Kreu 3 ofron te dhena statistikore qe do te sherbejne si baze e rendesishme edhe per shume studime te tjera ne te ardhmen. Ne baze te ketyre te dhenave autorja ka perpiluar edhe grafike qe vizualizojne mire zhvillimet ne kete fushe. Ne fund autorja permbledh perfundimet e studimet, ndersa shtojca permban sekuenca mjaft interesante dokumentesh.




4.1.4

TITULLI	Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit/ Një histori e shkurtër e Sigurimit të Shtetit në fillimet e tij (Dhjetor 1944 - Prill 1946)
AUTORI	Florin Zyberaj
ABSTRAKTI	Libri i studimor i Florin Zyberajt merr në shqyrtim Sigurimin e Shtetit në vitet e para në Shqipëri (1944-1946). Autori në hulumtimin e tij, është bazuar në materialet arkivore mbi fillimet e Sigurimit të Shtetit duke iu referuar këtyre arkivave: Arkivin e Ministrisë së Brendshme, në Fondin e Drejtorisë së Parë të Sigurimit të Shtetit (F. 4), Divizionit të Mbrojtjes së Popullit (F. Degën e Punëve të Brendshme Shkodër (F. 59), Degën e Punëve të Brendshme Korçë (F. 62), Degën e Punëve të Brendshme Berat (F. 64), Operativ (140) etj, si dhe në Arkivin Qendror të shtetit, në Fondin e Arkivit të Partisë/ Struktura e Komitetit Qendror të PPSH (F. 14/Ap-Str), Arkivin e Partisë Lufta/Shtabi i Përgjithshëm (F. 41/APL), Gjykata e Lartë Ushtarake (F. 516), Arkivi i


Partisë (Komisioni i posaçëm hetimor në lidhje me gjykimin e grupit “trockist” të Koçi Xoxes), (F. 411), Gjyqi Politik i Kriminelëve të Luftës (Komisioni Qendror), (F. 558) etj.

Referenca ndaj këtyre arkivave, marrin rëndësi në këtë studim, por vlerë e këtij studimi është edhe shfrytëzimi i dokumentacionit të arkivit të MEPJ, Arkivit Jugosllav, dhe të raporteve dokumentare të CIA-së. Nëpër kapituj studimi në shqyrtim dhe analizon atmosferën politike në prag të themelimit të Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit; krijimin e drejtorisë; mënyrën e shtrirjes, organizimin dhe kuadrin drejtues; detyrat e drejtorisë në formë përshkrimi etj. Analizë e hollësishme bëhet mbi ngritjen dhe shtrirjen e rrjetit informativ në të gjithë Shqipërinë, veprimtarinë e KQKL, survejimi i misioneve të huaja, represioni ndaj kundërshtarëve politikë, internimet, si dhe shtjellon drejtësinë e paligjshme të bërë përmes Drejtorisë të MP. Ndërsa kapitulli i fundit trajton raportet e Drejtorisë me organet e tjera të diktaturës që kanë funksionuar në këtë periudhë, si Ushtria, Policia, Gjykatat ushtarake etj. Studimi mbyllet me disa konkluzione të arritura gjatë trajtesave të çdo çështjeje, bibliografinë e plotë përfundimtare të shfrytëzuar për këtë punim, si dhe jepen të dhëna të një ankete të zhvilluar mbi sigurimin e shtetit. Botimi i këtij studimi ka një rëndësi të veçantë, pasi studiuesit nga vendi dhe jo vetëm, pajisen me informacione të shumta rreth veprimtarisë së Sigurimit të Shtetit të Shqipërisë, me një pjesë të madhe të dokumentacionit që publikohet për herë të parë.




TITULLI	Institucionalizimi i shkencave në Shqipërinë komuniste, mes represionit politik dhe imponimit ideologjik
AUTORI	Armanda Hysa dhe Kolë Kamsi
ABSTRAKTI	Kjo përmbledhje dokumnetesh trajton nje teme te rëndësishme qe përputhet tërësisht me objektivin e studimit te ISKPK. Ai jep një kontribut te rëndësishëm për njohjen dhe dokumentimin e demeve te komunizmit ne Shqiperi. Sic permendet edhe ne titull, vepra hedh drite mbi represionin politik dhe imponimin ideologjik ne fushën e shkencës. Hyrja paraqet se pari qarte objektin e studimit dhe përmbajtjen e librit, duke argumentuar bindshëm rëndësinë dhe kompleksitetin e temës si dhe qasjen e autoreve ndaj saj. Se dyti, hyrja ofron nje tablo te shkurtër historike te institucionalizimit te shkencave në periudhën 1945-72 si dhe cek stadin i hulumtimit ose se paku qasjes ndaj kesaj teme pas rënies se komunizmit. Se treti, hyrja komenton disa probleme te natyrës metodologjike-teorike. Ne vijim vepra paraqet dokumente te përzgjedhura nga Fondi 490 (Këshilli i Ministrave) dhe Fondi 14 APOU (Arkivi i PPSH Organet Udhëheqëse). Dokumentet paraprihen nga nje hyrje e shkurtër komentuese dhe kontekstualizuese. 

4.1.6

TITULLI	Përmbledhje e legjislacionit dhe e akteve represive gjatë komunizmit në Shqipëri; 1945 – 1990, Vëllimi i parë
AUTORI	Leka Ndoja
ABSTRAKTI	Libri i Leka Ndojës sjell një përmbledje dokumentare të zgjedhur në periudhën 10 vjeçare të parë të diktaturës komuniste. Kjo përmbledhje përbën një risi dhe një ndihmë të madhe në studimin e diktaturës veçanërisht fillimet e saj represive. Autori ka përmbledhur dokumente të dorës së parë të institucioneve kryesore të regjimit të cilat u angazhuan në hartimin dhe miratimin e legjislacionit gjatë diktaturës komuniste, e që dhanë një efekt të drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve. Përmbledhja përmban dokumente të botuara në Fleroren Zyrtare të kohës, Gazetës Bashkimi, Këshillit Anti-fashist, Kodet Penale, etj, duke dhënë një tablo të plotë mbi të gjithë legjislacionin represiv të diktaturës komuniste. INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT  PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT DHE E AKTEVE REPRESIVE GJATË KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI Vëllimi i parë 1944-1945 Tiranë, 2024

4.1.7

TITULLI	Ngjarje të viteve 1990-1991
AUTORI	Kastriot Dervishi
ABSTRAKTI	Libri i Kastriot Dervishit sjell një përmbledhje dokumentare dhe një analizë për çdo dokument të diktaturës në fundin e saj, në vitet 1990-1991. Përmes një kërkimi të gjerë si asnjëherë më parë, autori sjell një gamë të gjerë dokumentesh, të dhjetëra institucioneve të kohës, mbi veprimtarinë e tyre represive në kohën e nisjes së ndryshimeve të mëdha. Autori sjell edhe dokumente dhe ngjarje për personazhe të kohës të cilët u persekutuan nga organet e dikaturës. Libri nxjerr në pah përmes dokumenteve të disa prej ngjarjeve që shënjuan 2 vitet e fundit të dikttaurës si ; Demonstrata e heshtur e 14 janarit 1990 në Shkodër; demonstrata e heshtur e Tiranës më 28 janar 1990; demonstratat e 25-26 marsit në Kavajë; eksplozivi kundër përmendores së Stalinit më 28 mars 1990 në Tiranë; eksplozivi ndaj bustit të Enver Hoxhës më 16 prill 1990 në Shkodër; demonstrata e 16 qershorit 1990 në Shkodër; ngjarjet e ambasadave në korrik 1990; demonstratat e datave 4-10 korrik 1990 në Kavajë; demonstrata e Korçës më 25 gusht 1990; ngjarjet e dhjetorit 1990; demonstrata e Kavajës më 11 dhjetor 1990; demonstrata e Shkodrës më 13 dhjetor 1990; demonstrata antikomuniste e Durrësit më 13 dhjetor 1990; demonstrata e Elbasanit më 14 dhjetor 1990; rrëzimet e shtatoreve të Enver Hoxhës më 20 shkurt 1991 dhe ngjarjet përkatëse; eksodi i marsit 1991; ngjarjet e 2 prillit 1991 në Shkodër.



4.1.8

TITULLI	Një jetë që s'e jetuam
AUTORI	Musa Çapani
	Drafti me kujtime të Musa Çëpanit është një narrative mjaft origjinale e cila tenton të japë një këndvështrim mjaft original për fillimet e diktaturës parë nën syrin e një djali të ri që dëshmon se si niste persekutimi. Kjo përpjekje e autorit është mjaft interesante pasi tregon brengat e një fëmije të rritur në diktaturë, pamundësitë dhe frikën që përjetonte në mënyrë të përditshme. Ai tregon me mjeshtëri për traumën e një fëmije për shkak të persekutimit por edhe gjithë përpjekjen për të mos u dorëzuar, falë ndihmës të të afërmeve apo dëshirës për t'ia dalë në jetë.



4.1.9

TITULLI	Zhgënjimi - Histori e vërtetë
AUTORI	Vasil Nikolla Rista
ABSTRAKTI	Libri “Zhgënjimi – histori e vërtetë” me autor Vasil Nikolla Rista është një biografi e veçantë, që tregon si funksionte regjimi komunist nga ana juridike; mbi vuajtjen në diktaturë të autorit dhe të familjarëve të tij, duke na dhënë të detajuar si shkeleshin të Drejtat e Njeriut në Shqipëri; si projektohej përndjekja, skema, nga gjendja e lirë deri në arrestimin, dhe dënimin e viktimës. Duke qenë me formim juridik, po ashtu ka punuar edhe si funksionar në organet e hetuesisë, autori jep informacion shterues mbi çështjen e dënimit të tij, një kërkim dhe përjetim, ku, me një rrëfim solid nga ana juridike, ai zbërthen gjithë mekanizmin e funksionimit të sistemit. Përmes detajeve, sipas skemës juridike, autori nis rrëfimin nga jashtë, deri në dënimin e tij duke zbardhur me detaje si zbatohet ligji, referencat juridike, si dhe proceset hetimore të regjimit dhe kontradiksionit të tij nga zbatuesit, ekzekutuesit dhe xhelatët. Për më tepër, autori ofron dëshmi autentike të

	përvojës së tij duke ballafaquar ligjshmërinë e regjimit, vuajtjet në burg, dhe realitetin para se të dënohej, kur ai u përball fillimisht me sigurimin e shtetit. Përveç tyre, një dëshmi interesante e autorit është edhe përpjekja e tij e vazhdueshme për të treguar ngjarjet nga ana ligjore, se regjimi, vete shteti komunist shkeli në mënyrë arbitrare ligjet e saj, në dënimin e njerëzve të pafajshëm, shkeljen e të Drejtave të Njeriut. 
--	---


4.1.10

TITULLI	Uan Filipi, politikan dhe luftëtar i çështjes kombëtare
AUTORI	Enver Lepenica
ABSTRAKTI	Emri i patriotit të shquar Uan Filipi (1901 – 1948), politikanit atdhetar dhe luftëtarit deri në frymën e fundit i çështjes kombëtare ishte bërë shumë i dashur për mua, pasi e kisha dëgjuar për herë të parë në familjen time, në fshatin tim dhe në krahinën time, por kur fillova të hulumtoj në fushën e historisë jo vetëm që mu rrit vlerësimi për të por ndjeva detyrën të shkruaja për veprën e tij patriotike, për jetën që ia kishte

kushtuar popullit të tij. Kujtimet e të afërmeve të mi por edhe të fshatarëve të mi që e kishin njohur Uanin, në vendlindjen time Lepenicë dhe në qarkun e Vlorës gjatë Luftës Antifashiste përsëriteshin e ripërsëriteshin në kujtesën time. Një vend të veçantë në nxitjen për të shkruar këtë libër pati edhe çifti bukur vlonjat Pandeli dhe Tefta Mërkuri - Janina. Pandeli Mërkuri ishte nipi i Uan Filipit, pasi babi tij, Koli ishte kushëri i parë i Uan Filipit.


Sidoqoftë në këtë libër jam munduar të paraqes jetën dhe veprimtarinë atdhetare të Uan Filipit patrioti që e lidhi fatin e tij me fatin e atdheut dhe që punoi e luftoi për lirinë dhe përparimin e vendit të tij, me guxim e trimëri, pa u dorëzuar nga burgimet dhe dënimet me vdekje, pa u tërhequr, duke lënë shembullin e një luftëtari demokrat revolucionar, luftëtari antifashist dhe antikomunist.

Komunistët terroristë e torturuan dhe e pushkatuan pa pasur prova dhe fakte juridike dhe më pas u munduan të mbulonin kujtimin e tij me heshtje, por nuk ia arritën qëllimit mizor të tyre. Veprimtaria e Uan Filipit ishte shkruar në historinë dhe ndërgjegjen e popullit të tij.



4.1.11

TITULLI	Baba Ali Tomorri: Apostull i bektashizmit dhe martir i demokracisë
---------	---

AUTORI	Xhezo Cana
ABSTRAKTI	Studimi trajton jetën dhe veprën e një personaliteti të rëndësishëm të klerit bektashian gjatë periudhës së shtetndërtimit shqiptar, veprimtar i lëvizjes kombëtare dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, i cili u dënua me pushkatim nga regjimi komunist për arsye të veprimtarisë së tij në shërbim të demokracisë gjatë periudhës së pasluftës. Studimi “Baba Ali Tomorri: Apostull i bektashizmit dhe martir i demokracisë” i autorit Xhezo Cana na sjell një biografi të detajuar të një prej klerikëve më të njohur të komunitetet bektashi gjatë shekullit XX. Ai ka qenë një klerik, poet, autor, publicist, historian dhe veprimtar i lëvizjes antifashiste nacionalçlirimtare duke mbajtur edhe pozicionin e anëtarit të KNÇ për qarkun e Beratit, si dhe një prej antarëve themelues të kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve. Veprimtaria e Baba Ali Tomorrit nis që në fillimet e shekullit XX me përpjekjet për autonominë e pavarësinë e Shqipërisë, me kongreset bektashiane që sjellin qendrën e bektarishmizmit botëror në Shqipëri, përhapjen e dijeve dhe kulturës nëpërmjet botimeve të tij, veçanërisht në periodikët e Kryegjyshitës Bektashiane, krahas aktivitetit të tij vijues si klerik. Veprimtaria e tij gjatë Luftës Nacional Çlirimtare do të pasohet me mosdakordësinë e tij me vendosjen e regjimit komunist dhe organizimin e një opozite ndaj këtij regjimi, që do t’i kushtonte edhe jetën, pasi u dënua padrejtësisht nga regjimi komunist me vdekje dhe u ekzekutua në vitin 1948. Autori na sjell një biografi të plotë, të bazuar në të gjitha burimet ekzistuese mbi veprimtarinë e Baba Tomorrit. 

4.1.12

TITULLI	Revolta e Qaf Barit, ashtu siç e pashë
AUTORI	Bedri Blloshmi
ABSTRAKTI	Botimi dokumentar “Revolta e Qaf Barit, ashtu siç e pashë” me autor Bedri Blloshmin na jep një pamje të plotë mbi ngjarjen tjetër më tronditëse në diktaturë; revoltën e të të burgosurve politikë në burgun e Qaf Barit. Kjo ishte revolta e dytë, më tronditëse, brenda burgjeve të diktaturës, pas atij të Spaçit. Në burgun e Qaf Barit ndodheshin rreth 500 të burgosur politikë, të dënuar me mbi 25 vite burg. Si pasojë e kushteve të këqija dhe dhunës së ushtruar, të dënuarit shpërthyen në revolta më 22 maj 1984. Revolta nisi në formë rezistence kundër punës së detyruar, mëngjesin e 22 majit. 24 të burgosur politikë në burgun komunist, u ngritën në një protestë të pazakontë dhe luftuan me gardianët kundër barbarisë së tyre. Ata u ngritën në revoltë duke përsëritur atë që kishte ndodhur më shumë se një dekadë më parë në burgun e Spaçit, në të njëjtën datë, në të njëjtin muaj, ku shpërthyen kërkesa të ngjashme për liri. Blloshmi është dëshmitar okular i ngjarjes, ku përmes dokumenteve arkivore, dëshmimeve të policisë por edhe të disa të dënuarve, na jep në botimin e tij “ashtu siç e ka parë” revoltën. Sipas kujtimeve të tij, për të shtypur revoltën: “...mbërritën një numër i madh civilësh të armatosur, policë dhe çeta vullnetare, gra të veshura me uniformë ushtarake që zunë pozicionet rrëzë pishave përballë kampit. Në kthesën e xhadesë përpara kampit u dukën tufatufat ushtarët me armë në dorë të cilët u përzien me civilët e armatosur buzë përroit, shumë afër kampit.” Një vend të posaçëm në libër zënë dhe përpjekjet që Blloshmi ka bërë, së bashku me familjarët e të të ekzekutuarve, për t’ju gjetur eshtrat, Trupat e Sokol Sokolit dhe Tomë Ndojas u gjetën në vitin 2011, në kohën kur u inventarizua skema e varrimit, ndër të rrallat e trashëguara në arkivat e kohës. Pas shumë kërkimesh nga familjarët, trupat e tyre u gjetën të groposura në mjediset e ish antenave të Radio Shkodrës, rreth 4 kilometra nga qyteti, që dyshohet se është një nga vendekzekutimet e shumta, ku fshiheshin gjurmët e krimeve të komunizmit. Libri ka vlerë historike për dëshminë mbi ngjarjen por dhe sa i takon rëndësisë që merr publikimi i plotë i dosjes së Revoltës së Qaf Barit, me dokumente mbi arrestimet, dëshmitë, “gjykimet” si dhe ekzekutimin e protagonistëve të ngjarjes.



5. MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera dëshmon shprehjen e vullnetit të mirë të ISKK për të bashkëpunuar me ato institucione, mundësuar nga pika dh e nenit 13 e Ligjit nr. 10242, 25.2.2010, “Për institutin e studimeve për krimet dhe pasojat e komunizmit në Shqipëri”, me qëllim përmbushjen e detyrave të ISKK, parashikuar nga neni 5 i të njëjtit ligj, dhe veçanërisht pikat i, j, dhe k, të këtij neni, të cilat parashikojnë bashkëpunimin e ISKK me institucionet e tjera, vendase ose të huaja.

Këto marreveshje (memorandume) janë instrumente me vlerë etike që krijojnë strukturat dhe mekanizmat për bashkëpunim te ndersjellte në fusha të ndryshme si kultura, arsimi, informimi publik i brezave të rinj, studimi etj. Duke përcaktuar rolin dhe kontributin e secilës palë në realizimin e qëllimeve të përbashkëta, sigurohet koordinimi i veprimeve dhe shkëmbimi i përvojave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të bërë të mundur hedhjen dritë tek të gjitha veprimtarite që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist. Gjatë vitit 2024 ISKK ka nënshkruar një numër marrëveshjes, me institucione shqiptare ose të huaja. Disa marrëveshje janë në proces.

1. Marrëveshja midis ISKK dhe Institute for the Study of Totalitarian Regimes, Czech Republic, Nr. prot. 62/2, datë 22.02.2024
2. Marrëveshja midis ISKK dhe Instituti i Historisë “Nikolae Iorga”, Akademia Rumune e Shkencave, Nr.119.Prot, datë 11.04.2024.
3. Marrëveshja midis ISKK dhe Muzeun e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, Nr. prot. 193/12, datë 13.08.2024.

4. Marrëveshja midis ISKK dhe Bibliotekës Kombëtare, Nr. prot. 230, datë 11.09.2024, me afat 6-mujor, dhe të drejtë ripërsëritje. Kjo është marrëveshje me objektiv specifik, për një veprimtari të caktuar.
5. Marrëveshja midis ISKK dhe Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë, Nr. prot. 262, datë 24.10.2024.
6. Marrëveshja midis ISKK dhe Bashkisë Mirditë, Nr. prot. 258/2, datë 01.11.2024.
7. Marrëveshja me Universitetin Peter Andrei, Rumani, Nr. prot. 269/4, datë 12.11.2024.
8. Marrëveshja midis ISKK dhe Federata Panshqiptare Vatra, Nr. prot. 107/17, datë 08.12.2024.
9. Marrëveshja midis ISKK dhe Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Nr. prot. 306, datë 19.12.2024.

6. PARTNERITETE

Gjatë vitit 2024, ISKK ka bashkëpunuar me një numër institucionesh dhe organizatash vendase dhe ndërkombëtare.

Ministria e Arsimit ka qenë një partner i rëndësishëm për ISKK, duke e bërë marrëveshjen e përbashkët detyruese për të gjitha Drejtorisë Arsimore. Në Udhëzimin e përbashkët mes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, d.t 13/07/2024, për vitin shkollor 2024-2025, në sistemin arsimor parauniversitar, në Nenin 16, pika “a”, theksohet zbatimi nga Drejtoritë Arsimore i Marrëveshjes së lidhur mes Ministrisë së Arsimit dhe ISKK më 15/02/2023 “Për kordinimin e veprimtarive të përbashkëta institucionale për informimin e nxënësve mbi krimet e komunizimit të kryera në Shqipëri në periudhën 1944-1990”. Sipas kësaj marrëveshjeje janë kryer 11 takime në shkolla të ndryshme, ku janë hapur ekspozita, janë shfaqur filma të ideuara dhe prodhuara nga ISKK si dhe leksione të hapura. Gjatë vitit të shkuar ISKK ka shtuar ndjeshëm bashkëpunimin me institucione të huaja. Në vazhde të punës së nisur vitin e kaluar, gjatë vitit 2024 ISKK ka realizuar 5 marrëveshje me institucione ndërkombëtare, si dhe përgatiti 3 marrëveshje të tjera, të parashikuara për nënshkrim gjatë vitit 2025.

Gjatë vitit 2024 Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit dhe Instituti për Hetimin e Krimeve të Komunizmit dhe Memories së Ekzilit Rumun (IICCMER) organizuan konferencën e përbashkët ndërkombëtare “35 vite pas rënies së regjimeve komuniste në Evropë”, e cila mbahet në Bukuresht, Rumani, nga datat 3-4 tetor.

Në konferencë morën pjesë studiues dhe historianë nga ish vendet komuniste të Lindjes, ndërsa Shqipëria u përfaqësua nga drejtori ekzekutiv i ISKK, Dr. Çelo Hoxha, zv. drejtoresha e ISKK Dr. Armanda Hysa dhe Përgjegjësjë e Sektorit të Kërkimit Shkencor Dr. Brisejda Lala. Të ftuar nga ISKK, për të referuar, ishin edhe historianët Prof. As. Enriketa Papa, Departamenti i Historisë, Universiteti i Tiranës, Prof. As. Klejdi Këllici, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës dhe Dr. Mentor Beqa, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës. Në këtë konferencë u shfaq filmi shqiptar “Vdekja e Kalit”, me regji të Saimir Kumbaros, produksion i

vitit 1992, si dhe u libri i historianit Uran Butka, “Bomba në ambasadën sovjetike”, përkthyer në gjuhën rumune. Të dy këto produksione u prezantuan nga drejtori ekzekutiv i ISKK, Dr. Çelo Hoxha. Përkthimi dhe botimi i librit të z. Butka u realizua nga IICCMER në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me ISKK, nënshkruar në vitin 2023.

Në muajin maj 2024 ISKK në bashkëpunim me Ambasadën e Hungarisë në Shqipëri hapën në Tiranë, në mjediset e ambasadës, ekspozitën "European Gulag" shoqëruar me një panel diskutimi me temë “Përballja me diktaturën komuniste,” ku ishin të ftuar, Rajmund Fekete, drejtor i Institutit Kërkimor për Komunizmin në Hungari, Jonila Godole, drejtoreshë e IDMC dhe anëtare e bordit të Platform of European Memory and Conscience (PEMC) dhe Çelo Hoxha, drejtor ekzekutiv i ISKK.

Këtë vit një grup pune i ISKK zhvilloi një vizitë pune në SHBA, më datat 4-9 dhjetor 2024. Grupi përbëhej nga Drejtori Ekzekutiv, Çelo Hoxha; Përgjegjësjë e Sektorit të Kërkimit shkencor, Brisejda Lala, dhe Specialistja e Projekteve Audiovizuale, Juliana Uznova (Kurti). Qëllimi i vizitës ishte nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi me Federatën “Vatra”, me synimin e bashkëpunimit të dy palëve për mbledhjen e dëshmive nga ish-të persektuarve politikë të regjimit komunist që jetojnë në SHBA, dhe bashkëpunimin në aktivitete të tjera, që kanë lidhje me historinë e komunizimit.

ISKK mori pjesë edhe në Konferencën Ndërkombëtare me temë “Krimet e Totalitarizmit- Drejtësia dhe Kujtesa në shek XXI” në kuadër të takimit të përvitshëm të Platformës Europiane të Kujtesës dhe Ndërgjegjes. Në këtë konferencë morrën pjesë shumë studiues të njohur nga vende të ndryshme, të cilët kanë në fokus regjimet totalitare.

Së fundi, në kuadër të Shpalljes së 22 Nëntorit festë kombëtare, ISKK në bashkëpunim me “Muzeun e Alfabetit të gjuhës Shqipe - Manastir” hapi një ekspozitë mbi persekutimin e figurave që organizuan Kongresin nga regjimi Komunist, në qytetin e Manastirit.

Më 11 nëntor 2024, ISKK u vizitua nga një delegacion i Universitetit Petre Adrei, Rumani, dhe më 12 nëntor 2024, të dy institucionet nënshkruan një memorandum bashkëpunimi. Delegacioni përbëhej nga:

1. Prof. Dr. Teodora Prelipcean, Rector e Universitetit;
2. Ms. Prof. Dr. Georgeta Condur, Zv/rektore;
3. Mr. Prof. Dr. Sorin Bocancea, Zv/rektor;
4. Mr. Prof. Dr. Cristian Bocancea, anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit;
5. Mr. Prof. Dr. Sabin Drăgulin;
6. Mr. Professor Constantin Ilaș
7. Mioara Anton, Drejtoreshë e Institutit të Historisë "Nicolae Iorga", Akademia Rumune;
8. Daniel Sandru, Drejtor i IICCMER dhe lektor në univesitetin Petre Andrei.

6.1 Partnerë vendas

- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
- Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencave të Shqipërisë
- Muzeu historik “Shtëpia e gjetheve”
- Instituti për Demokraci, Media dhe Komunikim
- Universiteti i Tiranës, Departamenti i Historisë
- Arkivit Qendror Shtetëror i Filmit
- Shoqata Antikomuniste e Ish të Përndjekurve Politikë
- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentimin e Ish-Sigurimit të Shtetit
- Biblioteka publike Marin Barleti, Shkodër
- Organizata social kulturore “Tek Bunkeri”
- Universitetin European të Tiranës
- Bashkia Mirditë
- Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
- Biblioteka Kombëtare

6.2 Partnerë ndërkombëtarë

- Fondacioni “Konrad Adenauer”, në Tiranë (partner kryesor)
- The Platform of European Memory and Conscience
- Instituti për Hetimin e Krimeve të Komunizmit dhe Kujtimin e të Internuarve Rumunë në Bukuresht, Rumani (IICCMER).
- Cultural Heritage without Borders Albania
- The Institute for the Study of Totalitarian Regimes, Çeki
- Institute for the Research of Communism, Hungari (Instituti për Studimin e Komunizmit)
- Instituti i Historisë “Nikolae Iorga”, Akademia Rumune e Shkencave
- Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë
- Federata Panshqiptare Vatra
- Muzeu i Alfabetit të Gjuhës Shqipe, Manastir
- Universiteti Petre Andrei, Rumani

III. MENAXHIMI BUXHETOR

3.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Për vitin 2024 Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit është strukturuar në 3 drejtori përkatësisht: Drejtoria e Arkivës dhe Bibliotekës, Drejtoria e Studimeve dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Struktura, marrëdhëniet dhe detyrat e këtyre drejtorive, rregullohen përveç legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi, edhe nga rregullorja e brendshme e institucionit, e cila ka përcaktuar

në mënyrë të detajuar funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat për kryerjen e veprimtarisë së secilës prej këtyre drejtorive dhe sektorëve.

Emërimi i personelit të institucionit, është bërë në zbatim të ligjit nr.10242 datë 25.02.2010 “Për krijimin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” i ndryshuar, dhe neni 13 i tij i ndryshuar, si dhe në bazë të Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë Nr. 11/2021, datë 01.02.2021, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të ISKK në Shqipëri”, i ndryshuar.

Organika dhe Struktura e institucionit për vitin 2024 nuk ka pasur ndryshime.

Gjatë vitit 2024 janë evidentuar zhvillimet e mëposhtme sa i përket burimeve njerëzore.

Bazuar në pozicionet vakante në fillim dhe gjatë vitit 2024, si dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të legjislacionit të shërbimit civil, u krye procesi i rekrutimit dhe emërimit në pozicionet:

- *Drejtor Drejtorie*, Drejtoria e Studimeve.
- *Specialist Studiues*, Sektori i Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Studimeve.
- *Specialist – Koordinator i Edukimit*, Sektori i Edukimit dhe Informimit Publik, Drejtoria e Studimeve.

Për sa më sipër dhe në zbatim të ligjit nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, numri i punonjësve të ISKK për vitin 2024, ka qenë 22 punonjës.

Struktura e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit 2024

POZICIONI		Numri
<i>I</i>	DREJTORI EKZEKUTIV	(1)
<i>II</i>	DREJTORIA E ARKIVËS DHE BIBLIOTEKËS	(5)
	<i>Zv/Drejtor Ekzekutiv dhe Drejtor i Arkivës dhe Bibliotekës</i>	1
	Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumentave)	1
	Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumentave)	1
	Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumentave)	1
	Specialist Biblioteke (katalogim, Inventarizim i Fondit të Bibliotekës)	1
<i>III</i>	DREJTORIA E STUDIMEVE	(10)
	<i>Drejtor Drejtorie</i>	1
	<i>Sektori i Kërkimit Shkencor</i>	(5)
	Përgjigjes Sektori – Studiues	1
	Specialist Studiues	1
	Specialist Studiues	1

	Specialist Studiues	1
	Specialist i botimeve dhe redaktor letrar	1
	<i>Sektori i Edukimit dhe Informimit Publik</i>	(4)
	Përgjëgjës Sektori – Studiues	1
	Specialist i Projekteve Audiovizuale	1
	Specialist i Mardhenieve me Publikun	1
	Specialist – koordinator i edukimit	1
	DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	(6)
	<i>Drejtor Drejtorie</i>	1
	Specialist i Financës dhe Buxhetit	1
	Specialist i Burimeve Njerëzore dhe sekretari/protokoll	1
	Specialist jurist dhe i shërbimeve me gjyqësorin	1
	Specialist IT (database iskk/arkiva elektronike)	1
IV	Shofer	1
	PUNONJËS GJITHSEJ	22

Formularët e vlerësimeve të punës për vitin 2024 për nëpunësit janë bërë dhe janë dorëzuar nga të gjitha drejtoritë përkatëse.

Gjithashtu gjatë vitit 2024, ISKK në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji **Nr.9049, datë 10.4.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë”** i ndryshuar, si dhe nga ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, janë njoftuar dhe janë asistuar për plotësimin e Deklaratave të Interesave Private nëpunësit me detyrim deklarimi si dhe anëtarët e Bordit Drejtues. Të gjithë nëpunësit i kanë plotësuar dhe dorëzuar në kohë këto deklarata brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Gjatë vitit 2024 janë kryer veprimet për pranimin, evidentimin dhe shpërndarjen e korrespondencës, është bërë protokollimi i dokumentave të brendshme që prodhon instituti dhe dokumentat të cilat hyjnë në institucion.

Gjatë vitit 2024 sipas kërkesave të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” i ndryshuar, si dhe sipas *Normave Tekniko-Profesional dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë* ka filluar përpunimi i dokumentave të prapambetura për vitin 2013 dhe ka filluar dorëzimi i dokumentave me ruajtje të përhershme në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave. Janë zhvilluar 6 mbledhje Bordi. Janë bërë njoftimet sipas kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv dhe kërkesës së Kryetarit dhe Z/Kryetarit të Bordit, ku janë mbajtur procesverbalet e mbledhjeve dhe

janë bërë zbardhjet dhe protokollimi i tyre. Janë zbardhur vendimet e mbledhjeve të Bordit dhe janë publikuar online në faqen ëeb të ISKK-së.

Janë zhvilluar 6 mbledhje të Këshillit Shkencor ku janë mbajtur procesverbalet e mbledhjeve dhe janë bërë zbardhjet dhe protokollimi i tyre.

Për vitin 2024 është hartuar Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike, duke evidentuar në të gjithsej 29 elementë, i cili është dërguar për miratim në Degën e Thesarit. Nga këta elemente të sipër përmendur janë realizuar me sukses 8 procedura prokurimi me vlerë të vogël online në sistemin e APP (SPE).

Gjatë vitit kalendarik 2024 ISKK ka realizuar edhe procedura nën vlerën 100.000 lekë, shoqëruar me faturat fiskale përkatëse sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Për vitin 2024 ISKK likujdoi ekzekutimin e detyrimit bazuar në Vendimin nr. 4313 regj. Them., dt. 08.08.2019, me Vendimin nr. 3706, dt. 29.10.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me Vendimin nr. 11752 (31154-00081-86-2020) regj. Them., dt. 15.01.2020, me Vendimin nr. 314 (86-2024-346), dt. 07.03.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Për vitin 2024 pranë ISKK-së janë paraqitur thirrje për gjykatë si më poshtë:

- Nga Gjykata Administrative e shkallës së parë Tiranë me nr.Akti 6684 me nr.150 Prot. datë 09.05.2024

- Nga Gjykata Administrative e shkallës së parë Tiranë me nr.Akti 8192 dt 07.05.2024.

- Rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. çështje 30002-00292-00-2024 regjistruar me datë 10/06/2024.

Për vitin 2024 pranë DFSHMB janë përpiluar dhe hartuar 10 marrëveshje e bashkëpunimi me persona fizikë dhe juridikë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Po në këtë vit në mbështetje të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” neni 49 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, ISKK ka realizuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël objekt “*Shtypshkrimi i kolanës së librave për vitin 2024*” e cila është realizuar me sukses sipas parashikimeve të bëra dhe sipas procesverbalit nr.22/36 datë 12.11.2024 i Komisionit të marrjes në Dorëzim të librave të Kolanës për vitin 2024.

Procedurë e prokurimi e cila mbeti e parealizuar gjatë kohëzgjatjes së vitit 2024 është procedura “*Blerje pajisje zyre*” në vlerën 500.000 lek, e cila nuk është realizuar për shkak të restaurimit të godinës aktuale të ISKK-së dhe lëvizjen e zyrave të ISKK në një vendodhje tjetër për një kohë afërsisht 10 -12 muaj kjo sipas kërkesës për restaurimin e godinës së ISKK sipas shkresës me nr 1762 prot. datë 29.03.2022 ”Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të Programit EU4Culture” e Ministrisë së Kulturës. ISKK nuk shkoj te këto zyra ne afatin e caktuar nga Ministria, afersisht Tetor 2023 edhe pse ato janë përfunduar së restauruari dhe MEKI akoma dhe sot nuk i ka kthyer përgjigje kërkesave të ISKK për tu kthyer në zyrat e restauruara në zbatim VKM Nr.189, datë 09.03.2011 “*Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të katit të 1, të Vilës dy*

katëshe në Rrugën “George ë.Bush”, nga Instituti integritetit të të Përndjekurve Politikë, tek Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.

GJENDJA FINANCIARE E ISKK PËR VITIN 2024

Në mbështetje të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit plotësues të MFE nr.1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024” si dhe situatave buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, për periudhën Janar - Dhjetor 2024, gjendja financiare paraqitet si në tabelën më poshtë:

Nr	Emërtimi	Plan vjetor 2024	Plani i rishikuar 2024	Fakt 12 mujori	Në %
1	Shpenzime për Paga	35,330,000	32,030,000	31,587,474	99%
2	Sigurime shoqërore	4,990,000	5,190,000	5,008,564	97%
3	Mallra e Shërbime	15,720,000	18,820,000	15,794,909	84%
4	Trans për Buxhet.Fam&Individ	120,000	220,000	132,152	60%
5	Shpenzime kapitale	1,000,000	1,000,000	173,520	17%
	Totali i Shpenzimeve	57,160,000	57,260,000	52,696,619	92%

Në buxhetin e vitit 2024, ka patur rishikim buxheti gjatë vitit.

Kjo ka ardhur si rezultat:

- ✓ Transferim fondesh sipas shkresës së ISKK nr.12948/1 Prot., dt.07.10.2024 në zërin 602 shpenzime operative në shumën 3,100,000 lekë, në zërin 601 Sigurime Shoqërore dhe Shendetësore ne Shumen 200,000 lekë nga zeri 600 Paga ne Shumen 3,300,000 leke
- ✓ Shtesë fondesh sipas shkresës së MFE-së nr.3185 Prot., dt.08.03.2024 në zërin 606 shpenzime operative ne shumën 100.000 lekë në zbatim të ligjit 97/2023 “Për buxhetin e të vitit 2024” .

Në fund të vitit 2024 të ardhurat totale nga buxheti i shtetit ishin 57,260,000 lekë, dhe shpenzimet totale në vlerën 52,696,619 lekë, duke u realizuar në masën 92% të planit vjetor të ISKK. Ndër treguesit kryesor të shpenzimeve, pjesën qendrore e përbëjnë pagat, realizuar në vlerën 31,587,474 lekë ose 99% dhe kontributet për sigurimet shoqërore/shendetësore, realizuar në vlerën 5,008,564 lekë ose 97%. Shpenzimet korente u realizuan në vlerën 15,794,909 lekë ose 84%, ndërsa investimet në vlerën 173,520 lekë ose 17%.

Në tabelën e mëposhtme, evidentohet pesha e shpenzimeve sipas artikujve në raport me totalin e shpenzimeve:

Në

Artikulli	Emërtimi	Realizimi vjetor 2024	Stuktura në %
600	Shpenzime për Paga	31,587,474	59.9
601	Sigurime shoqërore	5,008,564	9.5
602	Mallra e Shërbime	15,794,909	30
606	Trans për Buxhet.Fam&Individ	132,152	0.2
231	Shpenzime për Investime	173,520	0.4
	Totali i Shpenzimeve	52,696,619	100

buxhetin e vitit 2024, ka patur mos realizim buxheti gjatë vitit.

Kjo ka ardhur si rezultat:

- ✓ Shpenzimet në fondet e buxhetit në zërin “paga dhe sigurime shoqërore” rezultojnë me realizim vjetor prej 36,596,038 lekë, nga 37,220,000 lekë që ishin planifikuar me një mospërdorim të fondit prej 623,962 lekë, kjo si pasojë e mosplotësimit të 3 vendeve vakante deri në mars të vitit 2024.
- ✓ Shpenzimet në fondet e buxhetit në zërin “shpenzime për mallra e shërbime” rezultojnë me realizim vjetor prej 15,927,061 lekë, nga 19,040,000 lekë që ishin planifikuar me një mospërdorim të fondit prej 3,112,939 lekë. Kjo ka ardhur si pasojë e mos realizimit të disa shpenzimeve për arsye se në disa procedura të prokurimit ofertat e paraqitura fituese kanë rezultuar më të ulta se fondi limit i parashikuar si dhe arsye të tjera të pa parashikuara gjatë vitit 2024.
- ✓ Shpenzimet në fondet e buxhetit në zërin “shpenzime kapitale” rezultojnë me realizim vjetor prej 173,520 lekë, nga 1,000,000 lekë që ishin planifikuar me një mospërdorim të fondit prej 826,480 lekë, kjo si pasojë e lëvizjes me zyra për shkak të ristrukturimit të godinës së ISKK gjatë vitit 2023 dhe si rezultat investimi nuk u realizua sepse ISKK nuk mundi të kthehet në zyrat e rikonstutkuara dhe të kishte mundësinë e mobilimit të këtyre zyrave sipas planifikimit për shkaqe dhe arsye që nuk varen nga ISKK.

Të gjitha shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe për shpenzimet kapitale për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, rakorduar dhe me faturat përkatëse janë realizuar sipas planifikimit në buxhet brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së tyre në sistemin e fiskalizimit (fatura elektronike) dhe janë likuajduar me vlerën e plotë të tyre.

Në fillim të vitit 2024 është dërguar pranë MFE-së raportimi vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plotësimi i pyetësorit të rishikuar të vetvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2023 të institucionit të ISKK-së. Është realizuar në kohë përgatitja, raportimi dhe dërgimi i pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023 pranë Degës së Thesarit Tiranë. Janë përgatitur dhe dërguar në kohë kërkesat buxhetore për fazën *strategjike* të PBA 2025-2027 pranë MF-ve. Janë përgatitur dhe dërguar në kohë kërkesat buxhetore për fazën *teknike* të PBA 2025-2027 pranë MFE-së. Janë hedhur brenda afatit të dhënat e përditësuara në

sistemin AFMIS për fazën e tretë të PBA 2025-2027, si dhe është bërë dërgimi në kohë i Formatit 2 të përditësuar të të dhënave në sistemin AFMIS të PBA 2025-2027 pranë MFE-së. Përgjatë gjithë vitit 2024 është realizuar dhe përdorimi i arkivës elektronike (sistemi AFMIS) për ekzekutimin e shpenzimeve të buxhetit, duke bërë të mundur dërgimin dhe arkivimin në formë elektronike të dokumentacionit mbështetës për likuidim të shpenzimeve brenda rregullave dhe afateve të përcaktuara me ligj si dhe nënshkrimi elektronik i urdhër shpenzimeve.

ISKK ka bërë të mundur gjenerimin automatikisht të pagës për punonjësit "Paga" në sistemin e HRMIS deri në muajin Maj të vitit 2023 dhe mbas kësaj periudhe gjenerimi i formatit të pagave është bërë nga programi Exel sipas legjislacionit në fuqi kjo në zbatim të Udhëzimeve nga DAP-ke .

Është hartuar rregjistri i Riskut i Drejtorisë së Financës i cili ka për qëllim menaxhimin e riskut identifikimin, analizimin dhe marrjen e masave për minimizimin e risqeve që vlerësohet se kanë rëndësi për arritjen e objektivave të ISKK-së, zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të ISKK-së, përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangien e shpërdorimit dhe keqpërdorimit të fondeve.

Nga sa më sipër rezulton se, në përgjithësi buxheti është realizuar në kohë dhe me cilësi duke respektuar zërat e buxhetit, afatin e realizimit dhe fondet e parashikuara për shpenzime sipas zërave.

IV. BORDI DREJTUES

1. Vendime të Bordit Drejtues

Bordi drejtues është organi drejtues më i lartë i ISKK, i cili drejton veprimtarinë e ISKK me vendimet që merr dhe sugjerimet që bën në mbledhjet periodike të tij. Gjatë vitit 2024 Bordi realizoi 5 mbledhje, në të cilat mori një sërë vendimesh. Vendimet gjenden të pasqyruara dhe në faqen zyrtare të ISKK.

Vendimet janë:

1. Miratimin e Planit Vjetor të Punës së ISKK për vitin 2024 dhe miratimin e mbështetjes financiare të punonjësve që studiojnë në nivel studimi "Doktorature" me vlerën e gjysmës së tarifës së përcaktuar për këtë nivel studimi Miratimi i lanit vjetor të punës për vitin 2024 dhe miratimi i ndryshimeve të strukturës dhe organikës së ISKK.(Vendim nr. 1. Datë 09.02.2024)
2. Miratimin e Raportit Vjetor të Punës për vitin 2024 të ISKK.(Vendim nr.2. Datë 02.04.2024)
3. Miratimin e listës së librave që do të botohen si Kolanë e vitit 2024 dhe zgjedhjen e znj. Fatmiroshe Xhemalaj anëtare të Këshillit Shkencor.(Vendim nr.3. Datë 25.06.2024)

Baza ligjore:

Ligji nr. 10242, 25.02.2010, Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, neni 10, 11.

V. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN/ PROBLEMATIKAT

V.1. Problematikat

V.1.1. MJEDISE TË PAPËRSHTATSHME për të punuar

ISKK ndodhet në zyra me qera, që prej 15 Korrik 2022, Ministria Kulturës nisi restaurimin e zyrave të ISKK, Vila 2 katëshe nr.7 në rrugën “George W. Bush”, Tiranë. Planifikimi i punimeve ishte bërë për 8 muaj, por në të vërtetë ka zgjatur 15 muaj. Nga komunikimet e vazhdueshme të ISKK me UNOPS, kompania që bëri restaurimin, godina e restauruar ka kaluar në proces kolaudimi që në muajin Tetor 2023.

ISKK ka në administrim këto ambiente sipas Vendimit Nr.189, datë 09.03.2011 “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të katit të 1, të Vilës dy katëshe në rrugën “George W.Bush”, nga Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë, tek Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, por si nga UNOPS si nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk ka asnjë përgjigje për kthimin e ISKK në zyrat e restauruara të saj.

Për një periudhë prej 32 muajsh ISKK (deri më 10 mars 2025) e ushtron aktivitetin e saj në një ambient prej afërsisht 190 m², në kushte jo të përshtatshme si për nga sipërfaqja (foto b/ngjitur më poshtë) por edhe nga numri i punonjesve sepse ISKK u vendos në këto zyra në kushte emergjente (të lironte sa më shpejt godinën për restaurim) dhe me një fond modest të dhënë nga Kuvendi dhe MF (240.000 lek/muaj). ISKK e detyruar të shtynte shumë here afatin e kontratës së qerasë përsëri e përsëri sepse vazhdonte heshtja si nga MEKI dhe UNOPS për kthimin e ISKK në zyrat e restauruara.

Megjithë ndihmën dhe mbështetjen e përhershme nga Kuvendi, çështja nuk është zgjidhur. Zhvillimi i aktivitetit dhe realizimi i objektivave të ISKK në zyrat aktuale me qera është e pamundur për shkak të problemeve të listuara më lart, dhe nevojë e menjëhershme është kthimi i ISKK në zyrat e administruara prej saj dhe të restauruara tashmë. Nëse ISKK do të ketë një përgjigje negative nga bashkëpunetoret dhe nuk do të të kthehet në zyrat e administruara prej saj atëherë del nevojë urgjente që ISKK të lëvizë në ambiente me qera ku të ketë sipërfaqe së paku deri në 400 m².

Mjediset e punës ku gjendemi janë dhe një prezantim i keq për imazhin e institucioneve, sepse ISKK vizitohet vazhdimisht nga institucione vendase dhe të huaja, dhe nuk kemi minimalisht as një zyrë ku të presim një delegacion 4-5 vetë.

Në vijin janë disa foto të zyrave të papërshtatshme ku ushtron aktivitetin ISKK







V.1.2. PAGESA E ULËT mujore e Bordit Drejtues dhe Këshillit Shkencor të ISKK

Për periudhën 2011-2024 anëtarët e Bordit dhe Këshillit Shkencor të ISKK-së kanë përfituar masën e shpërblimit si më poshtë:

- Prill 2011 – Qershor 2012 në zbatim të Nenit 5 të Ligjit Nr. 9584 datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve te pavarura kushtetuese dhe te institucioneve të tjera të krijuara me ligj”.
- Korrik 2012 – Shtator 2014 në zbatim të Lidhjes nr.1, të VKM “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtareve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të njësive të Qeverisjes Qëndrore”.
- Tetor 2014 – Dhjetor 2024 në zbatim të Lidhjes nr.1, të VKM Nr. 621 datë 24.09.2014 “Për disa ndryshime në vendimin Nr. 418, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtareve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të njësive të Qeverisjes Qëndrore”.

Në mendimin dhe interpretimin tonë të akteve ligjore dhe nënligjore të paraqitura më lart përcaktimi i masës së shpërblimit të anëtarëve të Bordit dhe Këshillit Shkencor të ISKK-së sipas VKM nr.418, i ndryshuar, është i gabuar dhe për këtë kërkojmë të rishikohet dhe kjo masë të jetë sipas përcaktimeve të Nenit 5 të Ligjit Nr. 9584 datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve te pavarura kushtetuese dhe te institucioneve të tjera të krijuara

me ligj” sepse Anëtarët e Bordit si organ drejtues i ISKK-së, i cili është institucion i pavarur, i krijuar me ligj, të cilët nuk e ushtrojnë mandatin me kohë të plotë dhe nuk përmenden në lidhjen nr.1, të këtij Ligji shpërblehen në masën 30 për qind dhe 20 për qind të pagës së drejtuesit ekzekutiv të institucionit.

V.1.3. NEVOJË për punonjës shtesë

ISKK e ka zgjeruar punën e tij kërkimore, studimore dhe promovuese, si brenda Shqipërisë edhe jashtë saj. Studiuesit e ISKK tashmë janë të pranishën në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Vitin e kaluar janë nënshkruar 9 marrëveshje bashkëpunimi, 6 prej tyre me jashtë, një vit më herët janë nënshkruar 10 marrëveshje, dhe procesi i nënshkrimit vazhdon. Kjo ka rritur dhe volumin e punës së ISKK sa që e bën të papërballueshme që t’u përgjigjemi gjithë bashkëpunimeve në kohë, sepse studiuesit mund të përballojnë një vëllim pune të caktuar që të ruajnë cilësinë e saj. Gjithashtu, pas nënshkrimit të marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit është rritur angazhimi i ISKK në fushën e edukimit. Ky realitet na dikton të kemi nevojë për një numër shtesë të specialistëve të studimeve, promovimit por dhe të burimeve njerëzore. ISKK mendojmë se ka nevojë për 8 punonjës shtesë, të ndarë nëpër 3 drejtoritë e tij.

1 specialist sekretar

Personi që aktualisht bën detyrën e sekretarit bën dhe detyrën e burimeve njerëzore, me ngarkesë dyfishe. Këto dy pozicione mendojmë se duhen ndarë, për një punë më efektive.

1 specialist për kurrikulat

Në të ardhmen do të përqëndrohemi shumë të çështjet arsimore. Aktualisht për çështjet e arsimit kemi një koordinator, i cili rregullon takimet me shkollat për aktivitete që kryejmë, por mendojmë se duhet të kemi një person shtesë që ka njohje për kurrikat, dhe do të organizojë trajnimet e mësuesve për mësimdhënien e historisë.

5 specialistë kërkues-shkencorë

Deri tani kemi 4 studiues. Për studimin e 50 viteve histori. Mendojmë se është e domosdoshme të rritet numri i kërkuesve, me qëllim që ISKK të ketë burime të mjaftueshme për të botuar çdo vit të botojë revistën shkencore me artikuj të krijuar nga studiuesit e ISKK, të organizojë një konferencë shkencore dhe të jetë në gjendje të botojë monografi në mënyrë të përvitshme. Për analogji, Instituti i studimeve totalitare i Republikës Çeke, me të cilin ISKK ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi, ka 70 specialistë kërkues shkencorë, pa llogaritur nëpunësit e tjerë. E llogaritur kjo në bazë të popullsisë, ISKK duhet të ketë, me standardin çek, rreth 18-20 specialistë kërkues shkencorë.

1 specialist për design

ISKK parashikon që në të ardhmen të përgatitë paketa didaktike në ndihmë të mësuesve, në të cilat përfshihet: literaturë, udhëzues didaktikë, materiale audiovizuale (riprodhim filmash, fotografi, prodhime të tjera multi-media). Përgatitja e materialeve audovizuale kërkon një specialist diizjani, i cili do të punojë në vazhdimësi për këto projekte por dhe për çështje të tjera. Ai do të ndihmojë për përgatitjen e materialeve promovuese, për përgatitjen e ekspozitave, për përgatitjen e materialeve për shkollat, për worshope, për leksione online, etj. Gjatë vitit ISKK kryen një numër të konsiderueshëm aktivitetesh në shkolla, aktivitete të ndryshme promovimi si botimet, ekspozita, dokumentarë etj. Veç kësaj, rinia është grupi kryesor i targetuar për informim mbi historinë e komunizmit, por duke qenë se ajo përdor shumë teknologjinë dhe rrjetet sociale, atëherë jemi të detyruar që të jemi prezenent me materiale informuese në këto fusha, të cilat kanë nevojë për dizjan, siç janë video, *reels*, *shorts*, *podcast*, etj.

V.1.4. Organizimi i një takimi ndërkombëtar i platformës Evropiane të Kujtesës.

(Kjo kërkesë është bërë dhe mmë 2024 në momentin e dhënies së kërkesave shtesë të buxhetit të Komisioni i Edukimit)

PEMC është një organizatë që bashkon institucionet shtetërore dhe OJF që merren me çështjet e kujtesës dhe krimeve të regjimeve totalitare. Ajo ka 68 anëtarë. ISKK është një prej tyre.

PEMC organizon një takim të përvitshëm të të gjithë pjesëmarrësve të tij. Ky takim organizohet përvit në vende të ndryshme. Vendi organizator është dhe financuesi i takimit.

ISKK mendon se do të ishte një investim i dobishëm organizimi i këtij takimi në Shqipëri, nën kujdesin e ISKK, kur kemi parasysh për punën e shtuar që është bërë në fushën e kujtesës në vitet e fundit. Ky do të ishte një rast i mirë i prezantimi të Shqipërisë, dhe në veçanti në punën e institucioneve në raport me të shkuarën, te 68 vendeve anëtare të PEMC. Gjatë takimit do të organizohen simpoziume, vizita në muzeumet e kujtesës, në vendet e kujtesës, etj.

Nëse ky takim organizohet në Shqipëri nën kujdesin e ISKK, konferenca ndërkombëtare do të përfshihet në ditët e këtij takimi.

V.1.5. Për gradat dhe titujt shkencorë në ISKK

1.

ISKK është një insitucion studimor, por, për shkak se nuk funksionon me ligjin e arsimit, gradat dhe titujt shkencorë nuk njihen, kjo do të thotë që zotëtimi ose marrja e tyre nuk ka efekte financiare në dobi të nëpunësve që i zotërojnë ose që studiojnë për t'i marrë.

Qëllimi i gradave dhe titujve shkencorë është motivimi i nëpunësve për të rritur cilësinë dhe sasinë e punës. Për këtë arsye mendojmë se duhet gjetur një mekanizëm ligjor, që mund të përfshihet në ligjin nr. 10242, 25.10.2010, “Për institutin e studimeve për krimet dhe pasojat e krimeve të komunizmit në Shqipëri”, që të mundësojë shpërblimin financiar shtesë në përputhje me gradat dhe titujt shkencorë. ISKK është një institut kërkimor-shkencor, i cili “kryen veprimtari kërkimore-shkencore, zhvillimi dhe inovacioni,” njëlloj si institutet kërkimore-shkencorre pranë institucioneve të arsimit të lartë, parashikuar nga neni 24 i Ligjit nr. 80/2015,

“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

2.

Ligji për arsimin parashikon që për të marrë tituj shkencorë (Profesor i Asociuar, Profesor) aplikantët duhet të ketë një sasi të caktuar orësh mësimdhënie. ISKK nuk ka statusin e një institucioni arsimor dhe nuk ka mundësi që t'i angazhojë studiuesit e tij në punës mësimore. Institucionet arsimore kanë planet e tyre dhe i shpërndajnë orët e mësimdhënies sipas planeve të tyre, kështu që studiuesit e ISKK nuk kanë mundësi të kenë përvojë mësimdhënie, dhe, për rrjedhojë, janë të përjashtuar nga progresi në karrierën e tyre shkencore.

Për këto arsye, kërkojmë aprovimin dhe ndihmën e Kuvendit që të përgatisim ndryshimet e nevojshme në ligjin nr. 10242, 25.10.2010, “Për institutin e studimeve për krimet dhe pasojat e krimeve të komunizmit në Shqipëri”, me qëllim që:

- a) Studiuesit e ISKK të përfitojnë shpërblimin për gradat dhe titujt shkencorë sipas parashikimeve ligjore për institucionet arsimore;
- b) Titujt shkencorë për nëpunësit e ISKK të jepen bazuar në punën e tyre shkencore, botime monografish, artikujsh shkencorë dhe pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Numri orëve të mësimdhënies që kërkohet për studiuesit e institucioneve të arsimit të kompesohet me studime, artikuj dhe konferenca shtesë për studiuesit e ISKK.

V.1.6 Çështja e pagesës së ekspertëve në fushën e edukimit

ISKK ka planifikuar ngritjen e grupeve të ekspertizës shkencore të teksteve shkollore (me ekspertë të ISKK dhe të jashtëm); hartimin e teksteve mbështetës për historinë e komunizmit për nxënësit e nivelit parauniversitar; hartimin e një udhëzuesi praktik për mësuesit, me orientime didaktike për qasjen ndaj historisë së komunizmit; hartimin e metodologjisë mbi qasjen e komunizmit në shkolla, bazuar mbi udhëzuesin praktik (ku përfshihen dhe ekspertë të jashtëm); përgatitjen e paketës didaktike në ndihmë të mësuesve, në të cilat përfshihet: literaturë, udhëzues didaktikë, materiale audiovizuale (riprodhim filmash, fotografi, prodhime të tjera multi-media). ISKK deri tani në punësimin e ekspertëve të jashtëm ka zbatuar dhe ndjekur Ligjin nr 162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar. Por natyra e ekspertizës që kërkohet në fushën e arsimit bën që ISKK të mos i afrojë dot në bashkëpunim nivelin e ekspertëve për shkak të përcaktimit të nivelit të pagesës sa pagesa e një specialisti në organikën e ISKK-së. Në fushën e çështjeve arsimore ISKK synon të bashkëpunojë me specialistë që zotërojnë gradat më të larta shkencore në fushën e arsimit dhe mendojmë, ndërkohë që pagesa që mund të ofrojë ligjërisht bazohet në pagesën e specialistit me pagën më të ulët. Kjo përbën një paradoks, sepse ekspertiza që kërkohet është e nivelit më të lartë, ndërsa kompesimi financiar që ofrohet si shkëmbim është i nivelit më të ulët.

Mendojmë se kjo lloj pagese nuk është e dinjitetshme për ekspertët e nivelit më të lartë që kërkon ISKK dhe as nuk përputhet me parimin e pagesës të drejtë. Ne mendojmë se pagesa më e

drejtë në këtë rast do të ishte që si referencë të merrej paga më e lartë në institucion që është ajo e Drejtorit Ekzekutiv.

Për këtë ISKK kërkon të amendohet Ligji nr. 10242 datë 25.02.2010 “Për krijimin e ISKK”, i ndryshuar, që të na mundësojë të kërkojmë eksperimentizim më të mirë në fushën e edukimit kundrejt një shërbimi të drejtë. Me miratimin nga ana e Kuvendit të amendimit të kësaj kërkesë të ISKK-së në ligjin e saj, ISKK të përgatisë një udhëzim i cili të përmbajë rregullat dhe procedurat e përzgjedhjes, kontraktimit dhe pagesës së eksperteve të përkohshme të jashtëm të ISKK-së të miratuar nga Bordi i ISKK.

V.1.7. Kërkesë për ndërmjetësimin e Kuvendit në raport me institucione të tjera

ISKK e ka informuar çdo vit Kuvendin për marrëdhëniet e tij me institucionet arkivore, përfshi AIDSSH. Në vitet e kaluara vlerësimi i ISKK ka qenë se AIDSSH “nuk funksionon si institucion në shërbim të kërkimit shkencor” (raport, 2022), “shërbimi vonohet ose nuk jepet fare” (raport, 2023), ndërsa në raportin e vitit 2024 kemi dhënë një vlerësim më të plotë, ku kemi informuar për kushtet që i vihen ISKK për kërkimin shkencor dhe arsyet pse ato kushte duhet të hiqen, të cilat pengojnë seriozisht punën për realizimin e misionit të tij.

Vitin e kaluar, Kuvendi i rekomandoi ISKK që “të konkretizojë bashkëpunimin me Autoritetin për Informimin mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit për pasurimin e databazës me të dhëna statistikore të viktimave të komunizmit në Shqipëri në të tria kategoritë: ekzekutim, burgim dhe internim, si dhe t’i bëjë sa më parë të aksesueshme për qytetarët.” Siç e kemi shpjeguar në këtë raport, te pjesa “Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për ISKK, 5 qershor 2024”, bashkëpunimi me AIDSSH nuk është përmirësuar.

Mungesa e aksesit të ISKK në dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit pendon ISKK të përmbushë detyrën e tij sipas parashikimeve të pikës e, neni 5, i Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për institutin e studimeve të krimeve dhe pasojat e komunizmit në Shqipëri”, i cili sanksionon që ISKK “grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist.”

Mënyra më e mirë për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor është akses i pakufizuar në arkivin e ish-Sigurimit të Shtetit, të cilin e ka nën administrim AIDSSH, por që i mungon vullneti për të lejuar këtë akses. Për këto arsye kërkojmë ndërmjetësimin në Kuvendit, për zgjidhjen e këtij ngërçi.

V. 2. Shpërndarja e botimeve

Gjatë vitit 2024, ISKK i ka shpërndarë botimet e tij (kolanën e vitit 2021) në 38 biblioteka bashkishe dhe universitetesh në gjithë Shqipërinë dhe ua ka dhuruar disa universiteteve të huaja.

Bibliotekat e bashkive

(1) Shkodër, (2) Pukë, (3) Kukës, (4) Peshkopi, (5) Rrëshen, (6) Rubik, (7) Elbasan, (8) Berat, (9) Ersekë, (10) Vlorë, (11) Korçë, (12) Lezhë, (13) Fier, (14) Lushnjë, (15) Pogradec, (16) Kavajë, (17) Burrel, (18) Kamëz, (19) Krujë, (20) Gjirokastrë, (21) Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës Shkodër, (22) Memaliaj, (23) Kuvendi.

Bibliotekat e universiteteve

(24) Fakulteti Histori- Filologji Tiranë, (25) Fakulteti i Shkencave Sociale Tiranë, (26) Fakulteti i Drejtësisë Tiranë, (27) UET, (28) Universiteti Mesdhetar, (29) Universiteti Marin Barleti, (30) Canadian Institute of Technology, (31) Albanian University, (32) Universiteti Luarasi, (33) Universiteti i Shkodrës, (34) Universiteti i Elbasanit, (35) Universiteti i Durrësit, (36) Universiteti i Korçës, (37) Universiteti i Gjirokastrës, (38) Universiteti i Vlorës.

Po ashtu e ka dhuruar libra nga botimet e viteve pararendëse si vijon: Shkolla 9- Vjeçare Ismail Klosi Ballsh, Gjimnazi “Oso Kuka” Shkodër, Burgu Peqinit, Z. Zait Aliu Drejtorit të “Muzeut të alfabetit të gjuhës shqipe” Manastir , Gjimnazi Faik Konica, Institutit të Krimeve të kryera Gjatë Luftës në Kosovë, Muzeu i alfabetit të gjuhës shqipe” Manastir, Qendra Kulturore e fëmijëve, Rrëshen, Shkolla Ahmet Dakli Elbasan, Shkolla 9- vjeçare Faik Konica, Shkolla Gjergj Kastrioti (Lezhë), Shkolla Hydajet Lezha (Lezhë), Shkolla Mihal Grameno, Shkolla Nënë Tereza (Rrëshen), Shkolla Qemal Stafa, Shkolla Sinan Tafaj, Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjetheve”, Shkollës 9- vjeçare “Xheladin Fishta”, Gjimnazi “Dervish Hekali” Ballsh

V. 3. ISKK dhe mediat

V.3.1 Faqja e ISKK në rrjete sociale

Gjatë vitit 2024, faqja e ISKK-së ka bërë mbi 200 *publikime* në rrjetet sociale në tërësi të cilat mund ti ndajmë në disa kategori të përgjithshme.

Rreth 150 *publikime* kanë paraqitur lajme, njoftime dhe pasqyrime të aktiviteteve të ISKK-së.

Rreth 25 *publikime* kanë pasur përmbajtje materialesh përkujtimore, fragmente dëshmish, materiale arkivore apo shënime sensibilizuese që trajtojnë ngjarje, fenomene të së kaluarës të cilat i vlejné publikut sot.

Ndërsa rreth 32 *publike* kanë qenë paqyrim i mediave mbi aktivitetet e ISKK-së.

V.3.2 Monitorimi i Medias

1. Agjensia Telegrafike Shqiptare: “Kërkimi shkencor, Instituti i Historisë marrëveshje bashkëpunimi me ISKK-në”, 5.1.2024: <https://ata.gov.al/2024/01/05/kerkimi-shkencor-instituti-i-historise-marreveshje-bashkepunimi-me-iskk-ne/>

2. Reporter.al: “Studimi i periudhës komuniste: Hapje drejt edukimit demokratik”, 16.1.2024: https://www.reporter.al/2024/01/16/studimi-i-periudhes-komuniste-hapje-drejt-edukimit-emokratik/?fbclid=IwAR1ITCPnVDdvë4f1i_qMqFBAFYb9EoJz4d250MHn_Sq_GUcTAbëAc0Klmcë
3. Report-tv.al: Instituti i Krimeve të Komunizmit, promovohet kolana studimore! Te Muzeu performanca ‘Musine, njësoj si ne’! Në Shtëpinë e Evropës dokumentari ‘Ngjyra në errësirë’!, 22.2.2024: <https://www.report-tv.al/lajm/instituti-i-krimeve-te-komunizmit-promovohet-kolana-studimore-te-muzeu-performanca-musine-njesoj-si-ne-ne-shtepine-e-evropes-dokumentari-ngjyra-ne-erresire>
4. RD.al: Instituti i Krimeve të Komunizmit, promovohet kolana studimore! Te Muzeu performanca ‘Musine, njësoj si ne’! Në Shtëpinë e Evropës dokumentari ‘Ngjyra në errësirë’!, 22.2.2024: <https://rd.al/instituti-i-krimeve-te-komunizmit-promovohet-kolana-studimore-te-muzeu-performanca-musine-njesoj-si-ne-ne-shtepine-e-evropes-dokumentari-ngjyra-ne-erresire/>
5. MCNtv.al: Fjalori enciklopedik për viktimat e komunizmit/ Prezantohet kolana e re e botimeve të ISKK-së (VIDEO), 22.2.2024: <https://www.mcntv.al/2024/02/22/fjalori-enciklopedik-p-r-viktimat-e-komunizmit-prezantohet-kolana-e-re-e-botimeve-t-iskk>
6. RTSH.al: Prezantimi i kolanës 2023 - Instituti i studimeve për krimet e komunizmit boton 10 libra, 22.2.2024: <https://lajme.rtsh.al/artikull/prezantimi-i-kolanes-2023-instituti-i-studimeve-per-krimet-e-komunizmit-boton-10-libra>
7. Top-Channel.tv: Enciklopedi viktimave të komunizmit/ Botohet nga Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, 23.2.2024: <https://top-channel.tv/2024/02/23/enciklopedi-viktimave-te-komunizmit-botohet-nga-instituti-i-studimeve-per-krimet-dhe-pasojat-e-komunizmit/>
8. Top Channel: Revolta e Qafë Barit/ 500 të burgosur politikë reagues ndaj trajtimit çnjerëzor, 22.5.2024: <https://top-channel.tv/2024/05/21/revolta-e-qafe-barit-me-22-maj-te-vitit-1984-500-te-burgosur-politike-reaguan-ndaj-trajtimit-cnjerezor/>
<https://top-channel.tv/video/top-CHANNE-revolta-e-qafe-barit-maj-1984-500-te-burgosur-politike-reaguan-ndaj-trajtimit-cnjerezor/>
9. MCN: Ekspozitë për revoltën e Qafë-Barit. 40-vjetori i kryengritjes së ish-të burgosurve politikë, 21.5.2024: <https://www.mcntv.al/node/196298>
<https://www.youtube.com/watch?vwybQNYIoAyMc>
10. Syri.tv: Përkujtohen 40 vite nga revolta e Qafë Barit, Tufa: Çnjerëzore, më shurdhuan veshin e majtë, 21.5.2024: <https://www.youtube.com/watch?vë8N6FVN3xtII>
11. Instituti i Studimeve për Krimet e Pasojat e Komunizmit, pelegrinazh në Qafë Bari, 23.5.2024: <https://ata.gov.al/2024/05/23/instituti-i-studimeve-per-krimet-e-pasojat-e-komunizmit-pelegrinazh-ne-qafe-bari/>

12. Instituti i Studimeve për Krimet e Pasojat e Komunizmit, pelegrinazh në Qafë Bari, 23.5.2024: <https://www.kultplus.com/lajme/instituti-i-studimeve-per-krimet-e-pasojat-e-komunizmit-pelegrinazh-ne-qafe-bari/>
13. Kanali shtatë: REVOLTA E QAFË BARIT, PROTAGONISTËT RRËFEJNË NGJARJET E VITIT 1984, 21.5.2024: https://www.youtube.com/watch?vwZoBPAB_uz-M
14. News24: Çelet ekspozita “Gulagu European”, kur Europa Lindore mbushej me kampe, 21.04.2024: <https://www.youtube.com/watch?vw-jOkAz8k0ik>
15. RTSH, Dokumentari “Në tempull”, nga Anisa Ymeri: Kampi i Qafë-Barit, 40 vjet nga revolta, 24.5.2024: https://www.youtube.com/watch?v=n1pwK1G_fJs
16. Euro News Albania - Revolta e Qafë – Barit, përse nuk duhet harruar, 25.5.2024: <https://www.youtube.com/watch?v=SX0XtWtlqnI>
17. EuroNews Albania: Ekspozita "Gulagu Evropian" ISKK dhe homologët hungarezë sjellin "fytirën e diktaturës", 31.5.2024: <https://www.youtube.com/ëatch?vë7ncQ9k8avKQ>
18. Ora News: Ekspozitë në ambasadën e Hungarisë ku pasqyrohen momente të diktaturës komuniste, 12.5.2024: <https://www.oraneës.tv/kultura/ekspozite-ne-ambasaden-e-hungarise-ku-pasqyrohen-momente-te-diktatures-k-i1159372>
19. Klan News: Hapet ekspozita “Letra nga Ferri”: https://www.youtube.com/ëatch?app=desktop&v=K-5khdq11Xk&fbclid=IëY2xjaëIa7TxleHRuA2FlbQIxMQABHaB-3NnorM2CLCo3ILxtMyFëiNmBibhzB3S29lefS--brEeoZ5u-ESdLëA_aem_km7qskOf9OD0uAYkoYRVQQ
20. Syri tv: 'Letra nga Ferri', ‘flasin’ të dënuarit politik, publikohen letrat e Zorbës për të ëmën: https://www.youtube.com/ëatch?app=desktop&v=nd1UaTxaGH0&fbclid=IëY2xjaëIa7iFleHRuA2FlbQIxMQABHKSzL8v4LB3-BPëKsqCZqCëKZCGeH_gHj-X5HuCLVDSJnfsQRcuux-YdeQ_aem_ezY4BiBivh5d-Ju5ioDv8A
21. Report Tv: 'Letra nga Ferri', ekspozitë rrëqethëse për ish të burgosurit. Dëshmi e terrorit, torturës në biruca: https://www.youtube.com/ëatch?v=GSLXi2ZqQ_s
22. Top Channel, Shqipëria Live: "Letër nga Ferri" "Ja çfarë shkroi gjyshi im përpara se ta vriste Enver Hoxha: https://www.youtube.com/ëatch?app=desktop&v=QG8ho8FKODg&fbclid=IëY2xjaëIa709leHRuA2FlbQIxMQABHVTt6nxFejëA0gKBhV54BmTGFhF58dTgbcAkXitr4saZeQë7ë46RmKvdkA_aem_5oë40JFATntEoNU90ëqOPA
23. ATSH: Ekspozitë me letrat e të burgosurve politikë gjatë komunizmit: https://ata.gov.al/2024/10/29/ekspozite-me-letrat-e-te-burgosurve-politike-gjate-komunizmit/?amp=1&fbclid=IëY2xjaëIa7-9leHRuA2FlbQIxMQABHRmnkId5YOBIptxyvxp9jëBvë1fZoV_GJ-21fzbE-BJcn7k2z3jëVYG2dA_aem_ZkQEëZJS7T8yXAhtkCm5Yg

24. Reporter.al: Ekspozita e letrave të të burgosurve hedh dritë mbi burgjet e epokës komuniste të Shqipërisë: https://www.reporter.al/2024/10/30/ekspozita-e-letrave-te-te-burgosurve-hedh-drite-mbi-burgjet-e-epokes-komuniste-te-shqiperise/?fbclid=IëY2xjaëIa8E9leHRuA2FlbQIxMQABHfCrMzdRm0LirpkBFtNnUyV4UMla8AIBTgxY4IXxËlaO4crëFcPc0UgeEA_aem_CCaKzb6uës230ËBOPyYxËë
25. Vizion Plus: “Letra nga ferri”, ekspozita me dorëshkrimet e atyre që vuajtën në burgjet e diktaturës: https://www.youtube.com/ëatch?app=desktop&v=bTIVCB014Io&fbclid=IëY2xjaëIa8JlleHRuA2FlbQIxMQABHZsFSIA67zc3nO4y_iUXHZx4p1MX9Zg5n_nb19zomJoO4OkB2_xoXjGjpA_aem_4TbJmNozzZF_Z7U-dmGmkA
26. Tv Klan: Publikohen “letrat nga ferri”, u përkasin të burgosurve të diktaturës: <https://www.facebook.com/profile.php?id=100079130634490>
RTSH 24: Ekspozita “Letra nga ferri”- Publikohen letrat e ish-të burgosurve politikë, drejtuar familjarëve dhe institucioneve: https://lajme.rtsh.al/artikull/ekspozita-letra-nga-ferri-publikohen-letrat-e-ish-te-burgosurvepolitike-drejtuar-familjareve-dhe-institucioneve?fbclid=IëY2xjaëIa8XlleHRuA2FlbQIxMQABHËvx1SDDh6JQyBrsP0Mt_h5vË6b3nRUsMgr-urzDBYVTBMNYppxh1ËRL1Qg_aem_9u6cmSëGMG3hT0SFnlCEJA
27. vna.al: “Letra nga ferri”, dëshmitë tronditëse të ish të burgosurve të dikaturës: https://vna.al/letra-nga-ferri-deshmite-tronditese-te-ish-te-burgosurve-te-dikatures/?fbclid=IëY2xjaëIa8yBleHRuA2FlbQIxMQABHSRAËx75NNII2BEaQGIpRëLPxz74liYV0LnN7ei8ZJy9srckYP1lCtDm6Q_aem_FrmZfj5HVqibHnV3CCx3zA
28. Gazeta Ekspres: Ekspozita me letra autentike të ish të burgosurve politik, “Letra nga ferri”: <https://www.gazetaexpress.com/ekspozita-me-letra-autentike-te-ish-te-burgosurve-politik-letra-nga-ferri/>
29. RTSH: "Letra nga ferri" - Ekspozita me dokumente origjinale e ISKK: <https://www.youtube.com/ëatch?v=ll9tqtB4rXA>
30. Shqiptarja.com: ‘Letra nga ferri’, Parajsa e Purgatori fshehur në rreshta: https://shqiptarja.com/lajm/speciale-letra-nga-ferri-parajsa-e-purgatori-fshehur-ne-rreshta?fbclid=IëY2xjaëIa9HRleHRuA2FlbQIxMQABHbQzxbrCFQu-SEVFb8XT6rFËrsOVvujMQYUJxikPXv6oI2E1XpKMAqQfMë_aem_xIZë_Peaë8-PJVlczmj2Yg
31. Panorama: Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit hapi këto ditë ekspozitën “Letra nga Ferri”, tek Piramida e Tiranës: https://www.panorama.com.al/shkroi-libretin-e-operes-teuta-cfare-kerkoi-nexhmija-per-zef-zorben-pas-daljes-nga-burgu-nga-njohja-me-terezina-pali-tek-arrestimi-i-te-dyve-me-46-en/?fbclid=IëY2xjaëIa9O5leHRuA2FlbQIxMQABHYUILoB3Ë5YëxVQYB-AfYE-CzpA16gRsZT4t8kcJ2MikN4zIJS9iEL7J-g_aem_OXpmDYO9HtshPofOBIOc5Q
32. Lajm TV: Studjuesit nga Shqipëria, ekspozitë në Manastir për Ditën e Alfabetit <https://www.youtube.com/ëatch?v=BBCQvviXX3Q>

VI. REKOMANDIME

6.1.Rekomandime për Kuvendin e Shqipërisë

Gjatë vitit 2024, ISKK i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë dy raporte informuese shoqëruar me disa rekomandime.

1. Raporti i parë është dërguar me shkresën nr. prot 277, datë 19.11.2024, “Raport informues për identifikimin e viktimave të regjimit komunist në *Fjalorin Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist*, botim i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.” Objekti i këtij raporti është evdientimi i numrit të përgjithshëm të viktimave të regjimit komunist dhe numri i përgjithshëm i të vrarëve nga komunistët në periudhën 1 janar 1942 – 29 nëntor 1944. Ky raport ka për qëllim informimin e Kuvendit të Shqipërisë për disa nga rezultatet e dala nga botimi i plotë të *Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist në Shqipëri*, një vepër studimore, enciklopedike. Raporti është i shoqëruar me katër rekomandime për Kuvendin.
2. Raporti i dytë është dërguar me shkresën nr. prot 289, datë 26.11.2025, “Raport informues për përdorimin propagandistik të dëshmorëve nga ana e Partisë së Punës së Shqipërisë dhe mbrojtja që i bëhet kësaj propagande me Ligjin nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut.” Objekti i këtij raporti janë politikat e regjimit komunist lidhur me konceptin e dëshmorit të atdheut dhe Ligji Nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”. Raporti ka për qëllim informimin e Kuvendit të Shqipërisë për përdorimin propagandistik nga regjimi komunist të konceptit të dëshmorit të atdheut dhe mbrotjen që i bëhet kësaj propagande me Ligjin Nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”. Raporti është i shoqëruar me shtatë rekomandime për Kuvendin.

Për përgatitjen e këtyre raporteve jemi bazuar në vepra të botuara nga ISKK, dokumente arkivore, ose burime të tjera, të cilat përfshijnë një larmi gjinish: monografi, artikuj shkencorë, përmbledhje dokumentesh të botuara, enciklopedi të ndryshme, etj. Raportet janë përgatitur bazuar në metodat bazë që përdoren në punime të këtij lloji: hulumtimi, përshkrimi, krahasimi, sinteza dhe analiza. Metoda mbizotëruese e përdorur është analiza dhe ka qenë parësore përpjekja për ta ruajtur atë nga subjektiviteti dhe qëndrimet emocionale, me synim realizimin e një analize sa më të paanshme, në respektim të etikës dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga neni 5, i Ligjit nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar.

VII. VIZIONI PËR VITIN 2025

- Një detyrat e ISKK parashikuar në ligj është grumbullimi të dhënave, dokumenteve dhe dëshmime për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist. Deri tani lidhur për plotësimin e këtij detyrimi ligjor ISKK ka botuar rregulloret sipas të cilës zhvillohej veprimtaria e Sigurimit të Shtetit, ka botuar gjithashtu dëshmi që kanë dhënë të përndjekurit politikë, por, pjesa më e madhe e historisë së Sigurimit të Shtetit është e kyçur ende në arkiva dhe në kujtesën e protagonistëve.

Kuvendi i Shqipërisë e ka hapur rrugën ligjore për aksesin e plotë të ISKK dhe entiteteve të tjera në dokumentet e Sigurimit të Shtetit me ligjin nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, neni 22, pika 4, që thotë: *“Përrjashtimisht, konsiderohen të deklasifikuara dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë. Nga zbatimi i kësaj dispozite, përrjashtohen dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit që lidhen me marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe sigurinë kombëtare.”*

Duke hyrë në arkivin e Sigurimit të Shtetit mund të mësojmë gjejmë të dhëna për vrasjet në kufi gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist, mund të zbulojmë metodologjinë e punës së Sigurimit në ushtrimin e detyrës së tij si një polici politike, veç asaj që është përshkruar në manualët e botuar, mund të zbardhim mekanizimin e ndjekjes për arsye politike, mund të zbardhim metodologjinë e rekrutimit të bashkëpunëtorëve, mund të zbulojmë informacion për strukturën, personelin, marrëdhëniet financiare, etj.

Realizimi i kësaj pike kërkon bashkëpunimin e ISKK me AIDSSH, që deri tani nuk ka qenë optimal.

- ISKK ka përgatitur një numër raportesh informuese për institucione të ndryshme, të cilët informohen në zbatim të pikës j, të ligjit nr. 10242, 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, që thotë: “[Instituti] bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit.” Mendojmë se ka ardhur koha që të kemi një debat kombëtar për çështje të caktuara të historisë komuniste, mes institucioneve që merren me shkrimin e historisë dhe të edukimit, dhe kjo realizohet përmes tyreave të rrumbullakëta, simpoziumeve, konferencave shkencore dhe botimeve të përbashkëta. Ky bashkëpunim duhet të përfshijë historinë e komunizmit shqiptar nga origjina e tij deri në rënien e regjimit komunist. Nuk është në të mirën e shoqërisë shqiptare që të ketë këndvështrime diametralisht të kundërta për çështje të njëjta nga institucionet shtetërore. Regjimi komunist shqiptar është përkufizuar nga Kuvendi i Shqipërisë – me rezoluta dhe ligje – si një regjim kriminal dhe ISKK dhe kërkimet arkivore e kanë vërtetuar këtë, kështu që nuk ka asnjë arsye që institucionet shtetërore të mbrojnë ende narrativën historike të krijuar gjatë regjimit komunist. Historia e komunizmit, përfshi atë të luftës, u shkruan nën kontrollin e

PPSH dhe në përshtatje me interesat ideologjike, prandaj gjithë historia e komunizmit në Shqipëri ka nevojë për rishikim rrënjësor. Ne mendojmë gjithashtu se institucionet që kanë kontribuar në shkrimin e historisë së komunizmit në Shqipëri gjatë regjimit komunist duhet të reflektojnë në mënyrë publike për të shkuarën e tyre dhe nuk duhte të vazhdojnë të mbrojnë me fanatizëm veprat e shkruara nën diktatin e PPSH.

- ISKK ka në fokusin e tij, me vëmendje të shtuar, punën me brezin e ri. Vitin e kaluar nisi puna për kryerjen e një studimi/sondazhi mbi informimin dhe sensibilizimin e të rinjve lidhur me të shkuarën totalitare. Këtë vit parashikojmë të përfundojë puna teorike e tij, të hartohet pyetësi dhe plani i zbatimit të tij dhe në vitet e ardhshme të bëhet zbatimi në terren i projektit. Ky studim do të na ndihmojë të njohim dhe kuptojmë më mirë dhe në mënyrë profesionale problemet e të rinjve dhe, bazuar në informacionin e mbledhur, do të jemi në gjendje të hartojmë një strategji efektive për adresimin e problemeve.
- ISKK e ka pjesë të vizionit të tij ndërkombëtarizimin e punës së tij. Për këtë qëllim synon, nëse siguron mbështetjen financiare të nevojshme, që në dy vitet e ardhshme të organizojë një takim të gjithë anëtarëve të Platformës Europiane të Kujtesës dhe Ndërgjegjjes (PEMC) në Tiranë. Kjo do të ishte një mundësi e mirë e gjithë vendeve anëtare (mbi 60) që merren me të shkuarën komuniste/totalitare të njiheshin me të shkuarën komuniste dhe me punën e institucioneve shqiptare për zbardhjen e saj. Kjo do të ishte një mundësi e mirë për shkëmbim përvojë me vendet e tjera në mënyrën e trajtimit të së shkuarës, qoftë në zbardhjen e saj, qoftë në organizimin e vendeve të kujtesës, me qëllim që të mos harrojmë dhe që e shkuara totalitare të mos përsëritet më. Kjo është një ambicje që ka nevojë për mbështetjen e Kuvendit, sepse ka një kosto financiare shtesë në buxhetin e ISKK, siç e kemi shpjeguar te kapitulli “MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN/ PROBLEMATIKAT”.

Përgatiti raportin:

Drejtori Ekzekutiv i ISKK

Çelo HOXHA

Tiranë, 20 mars 2025